



REPUBLIKA E SHOIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



RAPORT PËR VEPRIMTARINË VJETORE 2023

TIRANË 2024

RAPORTI NË FORMAT ELEKTRONIK



SKANO



KQZshqiperi



KQZshqiperi



KQZshqiperi



KQZshqiperi



KQZshqiperi



kqz.gov.al



KQZ



Përmbajtja

Pjesa I: HYRJE	2
Pjesa II: ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME TË DATËS 14 MAJ 2023	3
Kreu I: Përgatitja e zgjedhjeve	3
Kreu II: Dita e Zgjedhjeve dhe numërimi i votave	86
Kreu III: Ankimimet Zgjedhore	99
Kreu IV: Shpallja e Rezultatit	103
Kreu V: Verifikimi paszgjedhor.....	104
Pjesa III: ZGJEDHJET E PJESËSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS TË DATËS 24 SHTATOR 2023	114
Kreu I: Përgatitja e zgjedhjeve	114
Kreu II: Dita e Zgjedhjeve	119
Kreu III: Shpallja e Rezultatit	120
Kreu IV: Ankimimet Zgjedhore.....	120
Kreu V: Verifikimi paszgjedhor.....	121
Pjesa IV: VEPRIMTARI TË TJERA	121
Kreu 1: Financimi për vitin kalendarik	121
Kreu 2: Votimi nga jashtë vendit	123
Kreu 3: Procesi i dekriminalizimit	124
Kreu 5: Analiza paszgjedhore	127
Kreu 6: Planifikimi, Prokurim, Monitorimi i buxhetit te institucionit.....	127
Kreu 7 : Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Aktivitetet	132
Kreu 8: Statistike për procedimet penale në kuadër të zgjedhjeve vendore të vitit 2023	136
Pjesa V: REKOMANDIME.....	138

Pjesa I: HYRJE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ushtron funksionet e tij në zbatim të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

Zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 ishin kryefjala e aktiviteve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2023. Për KQZ pritshmëritë ishin të larta ndaj edhe angazhimi për të administruar me efikasitet dhe ligjshmëri këtë proces ishte edhe më i madh. Këto zgjedhje shënuan një proces ku rezultati paraprak i zgjedhjeve u shpall në përputhje me parashikimet ligjore, pavarësisht vështirësive që has ky proces për zgjedhjet vendore. Viti 2023 do të shënojë pilotimin me sukses të PEVN-së në 3 bashki të vendit, si dhe konsolidimin e implementimit të pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve. Ndonëse KQZ mori të gjitha masat¹ për të hartuar aktet nënligjore për zbatimin e Kodit Zgjedhor lidhur me mundësimin e votimit të shtetasve që jetojnë jashtë republikës së shqipërisë, vendimi nr. 38 datë 09.12.2022 i Gjykatës Kushtetuese për konstatimin e boshllëkut ligjor pezulloi këto nisma deri në plotësimin e kuadrit ligjor nga Kuvendi i Shqipërisë në përputhje me vendimin e gjykatës kushtetuese. KQZ në vitin 2023 administroi përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetarin e bashkisë Rrogozhinë me 23 korrik 2023 si dhe zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës të mbajtura më 24 shtator 2023.

Ky vit do të shënojë njëkohësisht edhe fillimin e procesit të digjitalizimit të proceseve të punës së KQZ-së të cilat synojnë përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit të administrimit zgjedhor.

Në këtë raport të nderuar deputetë, siç është kërkuar në rezolutën e Kuvendit 21.7.2022 për vitin 2022², do të gjeni të dhëna të detajuara për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor të datës 14.5.2023 duke përfshirë procesin e votimit elektronik, identifikimin elektronik si dhe gjithë infrastrukturën teknologjike të përdorur në këto zgjedhje.

Gjithashtu, raportet financiare vjetore të partive dhe raportet për financimin e partive politike³ për fushatat zgjedhore i janë dërguar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë, në Korrik të vitit 2023, në përmbushje të rezolutën e Kuvendit 21.7.2022 për vitin 2022.

¹ Rekomandimi nr. 3 – Rezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së KQZ-së për vitin 2022”

² Rekomandimi nr. 2 – Rezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së KQZ-së për vitin 2022”

³ Rekomandimi nr. 4 - Rezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së KQZ-së për vitin 2022”

Pjesa II: ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME TË DATËS 14 MAJ 2023

Kreu I: Përgatitja e zgjedhjeve

Seksioni 1: Aktet rregullatore

Në funksion të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar vendimin nr. 207, datë 3.11.2022 “Për miratimin e planit të veprimit 2022 – 2023 për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” dhe vendimin nr. 209, datë 25.11.2022, “Për miratimin e programit analitik të akteve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Gjatë vitit 2023, u hartuan aktet nënligjore të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve sikurse dhe të Komisionit Rregullator, të cilat në kuadër të zgjedhjeve të organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, rregulluan sipas objektivit të tyre, çështjet e organizimit dhe funksionimit të procesit zgjedhor që lidheshin me komisionet zgjedhore (KZAZ, KQV, GNV), detyrat, proceset e punës, dokumentacionin e përgjegjësitë e komisionerëve.

Në lidhje me teknologjinë në zgjedhje, u hartuan aktet e Komisionit Rregullator për procedurat e administrimit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit (PEI, kamerave në QV, pajisjeve PEVN), proces i cili përfshiu analizimin, hartimin dhe harmonizimin e tyre; për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet.

U miratuan aktet nënligjore për akreditimin e vëzhguesve si dhe u akredituan ata.

Në funksion të transparencës, procesi i hartimit të projektakteve nënligjore iu nënshtrua konsultimit të tyre me grupet e interesit përfshirë partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile. Sugjerimet dhe propozimet e tyre iu nënshtruan procesit të vlerësimit nga ana e stafit të KQZ-së, duke ripunuar projektaktet dhe relacionet shpjeguese.

Procesi i miratimit të akteve nënligjore u zhvillua në seanca publike të transmetuara në kohë reale dhe me pjesëmarrjen e grupeve të interesit, të cilët patën mundësi të shprehin opinionet e tyre edhe gjatë shqyrtimit. Pas miratimit, projektaktet u zbardhën dhe u publikuan në faqen zyrtare elektronike të KQZ-së, brenda 24 orëve nga miratimi i tyre.

Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, përgjatë vitit 2023 ka miratuar 852 (tetëqind e pesëdhjetë e dy) akte nënligjore nga të cilat 825 (tetëqind e njëzet e pesë) janë vendime, 5 (pesë) udhëzime dhe 22 (njëzet e dy) urdhra, të grupuara si vijon:

- 2 (dy) akte për miratimin e planit të punës dhe programit analitik;
- 167 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) akte në funksion të organizimit të zgjedhjeve dhe punës së administratës zgjedhore;
- 37 (tridhjetë e shtatë) akte për akreditimin e vëzhguesve për procesin zgjedhor;
- 151 (njëqind e pesëdhjetë e një) akte për shqyrtimin administrativ të denoncimeve dhe raportimeve;
- 2 (dy) akte për shqyrtim kërkesë për nismën ligjvënëse për propozim projektligjesh;
- 25 (njëzet e pesë) akte për përdorimin e PEI, kamerave në QV dhe PEVN;
- 16 (gjashtëmbëdhjetë) akte për miratim tabelash përmbledhëse për kryetar bashkie dhe këshill bashkiak;
- 8 (tetë) akte për miratimin e strukturës buxhetore për zgjedhjet vendore të vitit 2023;
- 144 (njëqind e dyzet e katër) akte për plotësime vakancash dhe dhënie mandate për deputet;
- 26 (njëzet e gjashtë) akte për financimin, monitorimin dhe auditimin,
- 18 (tetëmbëdhjetë) akte për hetim administrativ për shqyrtimin e rezultateve të verifikimeve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe denoncimeve për afishimin e materialeve propagandistike;
- 58 (pesëdhjetë e tetë) akte për miratim listash shumëmemërore;
- 2 (dy) akte për kthim për korigjim të dokumentacionit të listave shumëmemërore;
- 71 (shtatëdhjetë e një) akte për regjistrimin e partive politike, komiteteve nismëtare, kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit dhe koalicionëve;
- 125 (njëqind e njëzet e pesë) akte për shpërndarjen e mandateve për këshill bashkiak dhe kryetar bashkie.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në bashkëushtim të kompetencave me Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, ka miratuar në total 16 (gjashtëmbëdhjetë) akte nënligjore, nga të cilat 6 (gjashtë) vendime dhe 10 (dhjetë) urdhra, të grupuara si vijon:

- 1 (një) vendim për miratimin e procedurave operacionale për shkatërrimin e të dhënave personale në pajisjen elektronike të identifikimit (PEI) dhe sistemin elektronik të identifikimit të votuesve (SEIV) në KQZ;
- 3 (tre) vendime për përcaktimin e masës së shpërblimit për operatorët teknikë dhe trajnerët e operatorëve teknikë për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI), në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 dhe në zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023;
- 1 (një) vendim për miratimin e programit të temave të trajnimit që do të përdoren për trajnimin e operatorëve të pajisjes PEI, në zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023;

- 1 (një) vendim për verifikimin e të dhënave daktiloskopike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023;
- 1 (një) urdhër për shkatërrimin e të dhënave të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022;
- 3 (tre) urdhra për emërimin e teknikëve të suportit në terren ditën e zgjedhjeve;
- 3 (tre) urdhra për emërimin e operatorëve për përdorimin e pajisjes PEI dhe kamerave në QV;
- 1 (një) urdhër për dorëzimin e Pajisjes së Identifikimit Elektronik të Zgjedhësve (PEI) dhe të kamerës për video regjistrim në qendrën e votimit, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023;
- 1 (një) urdhër për paraqitjen në detyrë pranë qendrës së votimit, të operatorëve të pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023;
- 1 (një) urdhër për verifikimin e shkaqeve të mosfunksionimit të pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve (PEI) në disa qendra votimi në zgjedhjet e datës 14 maj 2023;
- 1 (një) urdhër për evidentimin e punonjësve të KQZ, apo dhe të tretë të tjerë, të kontraktuar me detyra për përgatitjen e pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI) dhe dorëzimin e tyre nga KQZ në KQV dhe anasjelltas, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023;
- 1 (një) urdhër mbi administrimin e pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI), të të dhënave që ato mbartin, si dhe mbi marrjen dhe administrimin e çdo informacioni tjetër që lidhet me përdorimin e PEI në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Komisioni Rregullator ka miratuar 33 (tridhjetë e tre) vendime. Vendimmarrja e Komisionit Rregullator përgjatë kësaj periudhe është e grupuar si më poshtë vijon:

- 9 (nëntë) vendime rregulluan sipas objektit të tyre çështjet e organizmit dhe funksionimit të procesit zgjedhor e lidheshin me komisionet zgjedhore (KZAZ, KQV, GNV), detyrat, proceset e punës, dokumentacionin e përgjegjësitë e komisionerëve në qendrat e votimit;
- 3 (tre) vendime për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, dhe për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023;
- 2 (dy) vendime për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore;
- 2 (dy) vendime për miratimin e afateve procedurale që lidhen me përsëritjen e zgjedhjeve për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë dhe zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Kukës;

- 1 (një) vendim për një ndryshim në vendimin nr. 3, datë 6.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”;
- 1 (një) vendim për miratimin e orarit të votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës;
- 1 (një) vendim për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023;
- 12 (dymbëdhjetë) vendime që lidhen me procedurat e administrimit të pajisjeve të teknologjisë së informacioni (PEI, kamerave në QV, pajisjeve PEVN), proces i cili përfshiu analizimin, hartimin dhe harmonizimin e tyre;
- 2 (dy) vendime për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në funksion të organizimit dhe administrimit të procesit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, ka miratuar 695 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) akte nënligjore, nga të cilat:

- 692 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy) janë vendime dhe
- 3 (tre) udhëzime.

Nga këto, 498 (katërqind e nëntëdhjetë e tetë) akte janë miratuar para datës së zgjedhjeve dhe 197 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) akte janë miratuar pas datës 14 maj.

Në funksion të nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve, janë miratuar 141 (njëqind e dyzet e një) akte, nga të cilat:

- 16 akte për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetarin e Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë,
- 63 (gjashtëdhjetë e tre) akte për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë, dhe
- 62 (gjashtëdhjetë e dy) akte për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë.

Seksioni 2: Planifikimi buxhetor i programit të zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përmbushje të objektivave të tij, me qëllim zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, planifikoi, hartoi dhe përgatiti koston e zgjedhjeve e cila u konceptua në dy faza kryesore për manaxhimin e buxhetit:

Faza e parë “Planifikim i buxhetit të zgjedhjeve”.

Faza e dytë “Zbatimi dhe Monitorimi i Buxhetit të zgjedhjeve”.

I. Planifikim i buxhetit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023

KQZ filloi me procesin e planifikimit në muajin shkurt 2022.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në datën 1 maj 2022 dërgoi dokumentin e fazës së parë (strategjike) të kërkesave për Buxhetin Afatmesëm, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Këshilli i Ministrave, në muajin qershor 2022, miratoi projekt buxhetin afatmesëm dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve. Pas këtij miratimi në korrik 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë u dërgoi të gjithave institucioneve udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit. Të gjitha drejtoritë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përgatitën dhe dërguan kërkesat buxhetore, brenda afateve të përcaktuara në legjislacion.

Në datën 1 shtator 2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dërgoi dokumentin e fazës së dytë (teknike) të kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Buxheti vjetor u miratua nga Kuvendi në datë 15 dhjetor 2022. Fondet për zgjedhjet vendore në ligjin e buxhetit nr. 84/2022 u parashikuan në shkronjën “b”, të nenit 14 të ligjit “Për buxhetin e vitit 2023” në vlerën 1.8 (një miliard e tetëqind milionë) lekë, për përballimin e kostos së zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 2, datë 09.01.2023, në zbatim të “Kodit Zgjedhor”, miratoi strukturën e shpenzimeve buxhetore për këto zgjedhje.

Përshkrimi i shpenzimit	Shuma
Shpenzime për Paga	325,365,637
Shpenzime për Mallra	530,332,409
Shpenzime për Shërbime	870,120,887
Investime	74,181,067
Totali	1,800,000,000

Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.38, datë 27.01.2023, vendosi në dispozicion për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 “Një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023”, në shumën 800 milion lekë, efekti financiar i të cilit u përballua pëkatësisht:

- 1.8 miliardë lekë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për përballimin e kostos së zgjedhjeve, miratuar për vitin 2023,

- 800 milion lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministratve për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme (për realizimin e votimit elektronik në rreth 350 qendra votimi).

Plani i Buxhetit të KQZ-së prej 2.6 miliardë lekë për shpenzime korrente dhe kapitale për vitin 2023 në tabelë dhe grafikisht paraqitet:

Programi “Zgjedhje të Përgjithshme dhe Lokale	<u>në/lekë</u>
Shpenzime Korrente	1,993,610,933
Shpenzime Kapitale	606,389,067
Totali	2,600,000,000

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 83, datë 02.03.2023, në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “l”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, miratoi strukturën e shpenzimeve buxhetore për këto zgjedhje.

ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME DHE LOKALE 01620	Shuma	Shprehur në % Struktura e shpenzimeve në raport me totalin
Shpenzime Paga 600	333,780,720	13
Mallra 6002	419,959,847	16
Shërbime 602	1,239,870,366	48
Investime231	606,389,067	23
Totali	2,600,000,000	100

II. Zbatimi dhe monitorimi i buxhetit vjetor për vitin 2023

Realizimi i Buxhetit për zgjedhjet e vitit 2023 në lekë dhe % është:

Lloji i shpenzimeve	Buxheti 2023	Realizuar janar-dhjetor 2023	Shprehur në % e Realizimit
Shpenzime Korente	1,993,610,93	1,922,130,325	96
Shpenzime për Investime (Kapitale)	606,389,067	599,521,876	99
Totali	2,600,000,000	2,521,652,201	97

A. Shpenzimet korrente

Struktura e shpenzimeve korrente të institucionit të KQZ-së është e përbërë:

1. Paga, sigurime shoqërore/shëndetësore (përfshin punonjësit me kontratë të përkohshme si dhe pagesat e komisionerëve të KZAZ, QV e GNV, dhe e trajnerëve), etj.
2. Mallra
3. Shërbime

Shpenzime Korrente	Buxheti 2023	Realizimi financiar 2023	Në %
Shpenzime për Paga	333,780,720	309,594,514	93
Shpenzime për Mallra	419,959,847	410,000,000	98
Shpenzime për Shërbime	1,239,870,366	1,202,535,811	97
Totali	1,993,610,933	1,922,130,325	97

Analiza e detajuar sipas zërave të miratuar paraqitet:

1. Shpenzime për paga.

Shpenzime për paga/sigurime dhe shpërblime komisionerë realizuan në masën 93%.

Me vendimin nr. 75, datë 22.09.2022, Kuvendi i Shqipërisë miratoi 352 punonjës me kohë të pjesshme. Me vendimin nr. 09, datë 16.02.2023, Kuvendi i Shqipërisë i shtoi numrit të mësipërm edhe 38 punonjës me kohë të pjesshme. Në total numri i punonjësve me kohë të pjesshme shkoi në 390 persona.

Paga dhe sigurime shoqërore/shëndetësore për punonjësit me kontratë të përkohshme (390 persona) si dhe pagesa për trajnerë afatgjatë dhe afatshkurtër:

- a) Fondi planifikuar 123.3 milion lekë,
- b) Realizuar 111 milion lekë ose 90 %.

Pagesat lidhur me komisionerët dhe anëtarët e KZAZ-ve, qendrave të votimit në të gjithë vendin, dhe GNV-ve:

- a) Fondi planifikuar për komisionerët 210.4 milion lekë,
- b) Realizuar 198 milion lekë ose 94%.

Fondi prej 12.4 milion lekë (5% i fondit total) nuk u realizua për arsye :

- a) planifikimi i fondeve për shpërblimin e komisionerëve u bë për 5500 qendra votimi; faktikisht u ngritën 5213 Qendra Votimi në të gjithë vendin. Pagesa për një QV është 25.000* 287 QV=7.1 milion lekë të papërdorura të disponueshme.
- b) Numri total faktik i anëtarëve QV dhe GNV ishte më i vogël në krahasim me planin e tyre, konkretisht 5.3 milion lekë të papërdorura ose të disponueshme.

2. Shpenzime për mallra.

Mallra u planifikuan në shumën 419.9 milion lekë.

- a. Fondi dhe kontrata të lidhura nga KQZ lidhur me mallrat domosdoshmëri për realizimin e zgjedhjeve janë në shumën rreth 410 milion lekë dhe u realizuan të gjitha pagesat e kontratave të lidhura.
- b. Shpenzimet për Mallra u realizuan në masën 98%.

3. Shpenzime për shërbime

Shërbimet u planifikuan në shumën 1,149 milion lekë. Kontrata të lidhura nga KQZ lidhur me shërbimet domosdoshmëri për realizimin e zgjedhjeve ishin në shumën rreth 1,124 milion lekë për të cilat u kryen të gjitha pagesat e kontratave të lidhura, janë në proces pagesat e kontratave vjetore me shërbim mujor për 12 muaj si; (vodafon, shërbim roje dhe siguri etj). Shërbimet u realizuan në masën 97%.

Analiza sipas zërave të shërbimeve dhe kontratave kryesore realizimi në përqindje dhe vlerë të shërbimeve është:

- Shërbime të ndryshme planifikuar 89,5 milion lekë ose 7% e buxhetit për të cilat u lidhën kontratat dhe u realizuan 81,2 milion lekë ose në masën 90 %.
 - a. 42 % e këtij zëri ose 33.8 milion lekë - Shërbim dhe materiale për përgatitje të kamerave për QV (Shërbim për kolaudimin, riparim kamerat e vëzhgimit në QV),
 - b. 11 % ose 8.6 milion lekë - Transmetimi/Publikimi në Media Sociale,
 - c. 6 % ose 4.8 milion lekë - Shërbim për "Kompani/eksperte për verifikimin e shkaqeve të mosfunksionimit të PEI-t në disa QV në zgjedhjet e 14 maj 2023.
- Shërbime të teknologjisë së informacionit ishin planifikuar rreth 893,7 milion lekë ose 77% e buxhetit të shërbimeve. Janë lidhur kontratat dhe u realizuan 854.7 milion lekë dhe realizuar në masën 100%.
 - a. 33 % e këtij zëri ose 368.9 milion lekë - Shërbim logjistike dhe shërbim soft për pajisjen PEI.
 - b. 25% ose 275.1 milion lekë - Shërbime suporti dhe konfigurimi teknik të pajisjeve dhe të fletës së votimit PEVN.
 - c. 14% ose 152.1 milion lekë - Shërbim për sistemin e regjistrimit dhe transmetimit on-line të procesit të numërimit të votave;
 - d. 2 % ose 20.1 milion lekë - Shërbime TIK Live Vote 2023.
- Shërbime qiramarrje 34,2 milion lekë ose 2% e buxhetit të shërbimeve. Ky zë është realizuar në masën 52 %. Kontratat u lidhen për vlerën 17.7 milion lekë dhe u realizuan në masën 100%.
 - a. 42 % e këtij zëri ose 7.4 milion lekë - Ambiente me Qira për pajisjet PEVN,

- b. 30 % e këtij zëri ose 5.1 milion lekë - Qira për magazina alternative për përpunim Kamera në QV,
- c. 24 % e këtij zëri ose 4.1 milion lekë - Ambiente me qira për QV,
- Shërbime transporti 29,9 milion lekë ose 2% e buxhetit të shërbimeve, ky zë është realizuar në masën 74%. Lidhur kontrata për vlerën 22.1 milion lekë dhe u realizuan në masën 100%.
 - a. 79 % e këtij zëri ose 17.5 milion lekë - Transport i bazës materiale ZAZ-QV-ZAZ, si dhe ZAZ-KQZ (fondet për komisionet e zonave të administrimit zgjedhor),
 - b. 21 % ose 4.6 milion lekë – Shërbime të ndryshme transporti,
 - c. Shërbime, udhëtime e dieta 15.2 milion lekë dhe realizuar në masën 100%.
- Shërbime për fushatën edukuese dhe sensibilizuese (edukim, informim, sensibilizim) 87 milion lekë ose 8 % e buxhetit të shërbimeve.

Lidhur kontrata 87 milion lekë dhe u realizuan në masën 100%

- a. 81% e këtij zëri ose 70 milion lekë – Transmetimi i spoteve dhe titrave për fushatën në televizione.
- b. 19% e këtij zëri ose 17 milion lekë – Shërbime për fushatën edukuese, informuese dhe sensibilizuese.
- Shpërblimi i operatoreve 90.9 milion lekë ose 7.4 % e buxhetit të shërbimeve, për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë në QV për përdorimin e pajisjes PEI dhe PEVN, në ditën e votimit + kamerat në QV, teknikë suporti në terren. Ky zë u realizua 70%.

B. Shpenzime kapitale për investime me financim të brendshëm

Realizimi i investimeve në këtë program 01620 është 599.5 milion lekë ose në masën 99%, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023.

Në mënyrë të detajuar projektet paraqiten sipas shumës dhe % që zënë ndaj totalit të investimeve 2023:

- a. 79 % e investimeve është – Blerja e pajisjeve (hardware) për 352 Qendra Votimi, për të cilat u blenë 760 makina PEVN në shumën 479.1 milion lekë, realizuar 100%.
- b. Në këtë sasi u parashikuan 2 makina votimi për çdo qendër si dhe 5% rezervë e detyrueshme e parashikuar në Kodin Zgjedhor.
- c. 11 % e investimeve është - Infrastruktura TIK Qendrore KQZ në shumën 65 milion lekë realizuar 97%.
- d. 8 % e investimeve është - Licenca për software për 760 PEVN dhe përmirësimi i SEMVR në shumën 49,3 milion lekë realizuar 100%.
- e. 0.6 % e investimeve është - Modem për transmetimin e të dhënave në shumën 3,8 milion lekë realizuar 100%.
- f. 0.4 % e investimeve është - Restaurim i magazinës Nr.4 (magazina e pajisjeve PEI) në shumën 2.2 milion lekë realizuar 100%.

Në mënyrë të përmbledhur buxheti total për zgjedhjet 2023, realizimi i tij 10 mujor si dhe % e realizimit, paraqitet si vijon:

Në lekë

Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Lokale	01620		
	Buxheti 2023	Realizuar	Realizimi në %
Paga	333,780,720	309,594,514	93
Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,659,830,213	1,612,535,811	97
Total Shpenzime Korente	1,993,610,933	1,922,130,325	96
Totali Shpenzime për Investime	606,389,067	599,521,876	99
Totali i Buxhetit të Programit	2,600,000,000	2,521,652,201	97

Seksioni 3: Prokurimet

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për vitin kalendarik 2023 si dhe në funksion të procesit zgjedhor për vitin 2023, ka realizuar 42 procedura prokurimi. Lloji i procedurave të përdorura është si më poshtë vijon:

- 17 procedura të hapura;
- 8 procedura prokurime me vlerë të vogël;
- 25 procedura me negociim pa njoftim.

Në total kemi pasur 14 ankime në Komisionin e Prokurimit Publik dhe njëkohësisht në KQZ.

Nisur nga tipologjia e ankimit ndahen në 6 procedura ankim në fazën e parë mbi kriteret e vendosura dhe 8 procedura në fazën e dytë ankim mbi vlerësimin e KVO.

Komisioni i Prokurimit Publik nga 8 procedura mbi vlerësimin e KVO-së, ka pranuar dhe ndryshuar fituesin për 4 procedura dhe ka lënë në fuqi vendimin e autoritetit kontraktor për 4 procedura të tjera.

Risia e autoritetit tonë kontraktor këtë vit ishte realizimi i procedurave të prokurimit me mjetin e prokurimit marrëveshje kuadër. Janë lidhur 7 marrëveshje kuadër me një afat 36 mujor (3 vjeçar).

Seksioni 4: Menaxhimi i burimeve njerëzore të KQZ-së

Pas analizës vjetore në përfundim të zgjedhjeve për Kuvend, në përmbushje të detyrave dhe objektivave të Institucionit, një proces i rëndësishëm ishte dhe riorganizimi i strukturë organikës së administratës me kohë të plotë pune. Ky proces kishte si qëllim sigurimin dhe menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore duke balancuar kërkesat e punonjësve me nevojat e Institucionit.

Me vendimin nr. 74/2022 të Kuvendit të Shqipërisë u miratua strukturë organika e re e KQZ me 95 (nëntëdhjetë e pesë) pozicione pune, e cila u pasua me shtim të numrit të organikës dhe krijimin e një njësie të re organizative, Drejtoria për Votimin nga Jashtë.

Procesi i Ristrukturimit

Komisioni i Ristrukturimit zhvilloi procesin e riorganizimit duke kryer një rishpërndarje të burimeve me qëllim kryerjen e funksioneve dhe sistemimin e çdo nëpunësi civil.

Procesi përfundoi brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin për nëpunësin civil sipas fazave të mëposhtme:

- Njoftimi individual i çdo nëpunësi civil;
- Ngritja e komisionit të restrukturimit;
- Vendimi i komisionit të restrukturimit;
- Vendimi i njësisë përgjegjëse;
- Vendimin individual të njësisë përgjegjëse;
- Urdhri për fillimin e marrëdhënieve financiare sipas organikës së restrukturuar.

Njësia përgjegjëse, me vendim nr. 234 prot., datë 18.01.2023 vendosi sistemimin e 61 nëpunësve civilë në institucion.

Rekrutimi dhe përzgjedhja e personelit

Në fillim të çdo viti kalendarik përcaktohet në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil numri i vendeve vakante. Në zbatim të ligjit për nëpunësin civil janë kryer gjithsej 29 (njëzet e nëntë) procedura testimi nga të cilat:

- *15 procedura "Pranim në shërbimin civil" në kategorinë ekzekutive:*
Drejtorja për Votimin nga Jashtë 4 (katër) specialistë; Drejtorja e Komunikimit dhe Koordinimit 3 specialistë; Drejtorja e Ligjshmërisë 2 (dy) specialistë; Drejtorja e Administrimit të Zgjedhjeve 2 specialistë; Drejtorja e Burimeve Njerëzore 1 (një) specialist; Drejtorja e Menaxhimit të Buxhetit 1 (një) specialist; Drejtorja e Logjistikës dhe Digjitalizimit 1 (një) specialist; Sektori i Auditit të Brendshëm 1 (një).
- *4 procedura "Ngritje në detyrë" në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese:*
Drejtorja për Votimin nga Jashtë 1 (një) drejtor, Sektori i Burimeve Njerëzore 1 (një) shef sektori, Sektori i Ankimeve dhe Sanksioneve 1 (një) shef sektori, Sektori i Administrimit të Dënave 1 (një) shef sektori.
- *5 procedura lëvizje paralele;*
Drejtorja e Menaxhimit të Buxhetit 1 (një) specialist, Sektori i Dokumentacionit Zgjedhor dhe Trajnimeve 1 (një) specialist; Sektori i Materialeve Zgjedhore 1 (një) shef sektori, Sektori i Koordinimit dhe Informimit 1 (një) shef sektori; Sektori i Shërbimeve Mbështetëse 1 (një) shef sektori,
- *1 procedurë "Ngritje në detyrë nga jashtë shërbimit civil" Rregulli përjashtues 20%"*
Sektori i Materialeve Zgjedhore 1 (një) shef sektori,
- *4 procedura të mbyllura pa kandidatë*

Sektori i Dokumentacionit Zgjedhor 1 (një) specialist, Sektori i Zhvillimeve Digjitale 1 (një) specialist; Sektori i Zhvillimeve Digjitale 1 (një) shef Sektori, Sektori i Hartimit të Akteve 1 (një) shef sektori.

Për procedurat e shpallura për vende të lira pune në shërbimin civil gjatë 2023 kanë aplikuar gjithsej 46 kandidatë.


Procedura të tjera në shërbimin civil:

- Dorëheqje 3 (tre),
- Pezullim nga shërbimi civil 2 (dy),
- Dalje në pension 1 (një).

○ Zhvillimi i karrierës në institucion

Zhvillimi i karrierës në shërbimin civil është një proces i rëndësishëm që siguron punonjësit të kenë mundësi për të rritur njohuritë dhe aftësitë, për të avancuar në postet e tyre dhe për të kontribuar në mënyrë më efektive në detyrat që u ngarkohen.

- 4 (katër) nga 10 (dhjetë), vende të shpallura janë plotësuar brenda institucionit me anë të procedurës ngritje në detyrë.
- 5 (pesë) nga 29 (njëzet e nëntë), vende të shpallura janë plotësuar brenda institucionit me anë të procedurës lëvizje paralele.



○ Përmirësimi i performancës

Ky është një proces i vazhdueshëm që ndihmon dhe përgatit punonjësit të përmirësojnë aftësitë dhe performancën e tyre në punë.

Për këtë arsye, DBNJ në bashkëpunim dhe koordinim me të gjitha drejtoritë dhe ASPA-n ka përcaktuar zhvillimin e trajnimeve sipas tematikave të përcaktuara nga vetë nëpunësit:

Disa nga hapat e kryera nga njësia përgjegjëse janë:

- Identifikimi i nevojave për trajnime,
- Përcaktimi i buxhetit për trajnime,
- Përshtatja e orarit të trajnimit,

- Krijimi i mjedisit, infrastrukturës dhe teknologjisë së nevojshme,
- Monitorimi dhe raportimi.

Përgjatë kësaj periudhe janë ndjekur disa programe trajnimi brenda dhe jashtë vendit:


65 punonjës kanë plotësuar planin e trajnimit të ASPA me tema trajnimi;

17 punonjës, kanë kryer 1 (një) temë trajnimi pranë ASPA-s;

11 punonjës, kanë kryer trajnimin e detyrueshëm pranë ASPA-s;

15 punonjës, kanë kryer trajnimin Bridge;

4 punonjës, kanë kryer trajnimin jashtë vendit.



Programi Kombëtar i Praktikave të Punës

KQZ ka implemtuar programin kombëtar të praktikave të punës për të rinjtë. Përmes këtij programi në institucion janë angazhuar 3 të rinj me synimin për t'i mbështetur dhe përgatitur profesionalisht për proceset e punës në të ardhmen.

Regjistri elektronik i menaxhimit të burimeve njerëzore HRMIS

Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka kryer plotësimin dhe përditësimin e sistemit informatik të menaxhimit të burimeve njerëzore me të dhënat e punonjësve të Institucionit sipas dosjes personale të secilit nëpunës. Ky përditësim kryhet me qëllim krijimin e një bazë unike të dhënash shtetërore (RQP) i cili ruhet e përpunohet elektronikisht.

Rekrutimi dhe menaxhimi i personelit me kohë jo të plotë pune

Realizimi i detyrave për procesin zgjedhor si implementimi i teknologjisë në zgjedhje, kontrolli i financave të partive politike, keqpërdorimi i aseteve publike, monitorimi i fushatës, organizimi dhe funksionimi i komisioneve zgjedhore (KZAZ, KQV, GNV), infrastruktura e KZAZ, QV dhe GNV, që burojnë nga Kodi Zgjedhor dhe aktet ligjore në fuqi kërkon kapacitete njerëzore të mjaftueshme dhe të kualifikuara.

KQZ, duke marrë në konsideratë punën intensive për një periudhë të shkurtër kohore në procesin zgjedhor, rekruton punonjës me kohë jo të plotë pune.

Pas një procesi analizues dhe konsultativ me secilën nga njësitë organizative me qëllim përmbushjen e detyrave për mirëorganizimin e procesit zgjedhor, Komisioneri përgatit dhe i përcjell Kuvendit për miratim strukturën dhe organikën e administratës së KQZ-së me kohë jo të plotë.

- Me vendimin nr. 75/2022, të Kuvendit u miratuan 352 punonjës me afate kohore punësimi 3 deri në 9 muaj.
- Me vendimin nr. 9/2023, të Kuvendit u miratuan 38 punonjës me afat kohor punësimi 3 muaj.

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për implementimin e strukturës dhe organikës u ndoqën këto faza:

1. Thirrja për aplikim është publikuar në faqen zyrtare të internetit, në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit”, si dhe në rrjetet sociale të institucionit. Në njoftimin për publikim ishin të mirëpërcaktuara pozicionet e punës, afati kohor, kategoria e pagës, kriteret e punësimit, detyrat kryesore si dhe mënyra e aplikimit e cila mund të kryhej:

- Online, në linkun përkatës të publikuar nga KQZ ose;
- pranë zyrës së protokollit.


Gjithsej në total për punësim janë paraqitur 668 kërkesa nga këto 175 online dhe 493 me anë të protokollit, nga këto aplikime u punësuan 539 punonjës me kohë jo të plotë pune.

2. Vlerësimi i aplikimeve

Dosjet e aplikantëve, kandidatë për punonjës *part-time*, shqyrtohen nga DBNJ dhe drejtoritë përkatëse. Kandidatët që përmbushin kriteret kualifikohen dhe njoftohen për një intervistë të strukturuar me gojë.

3. Rekrutimi i stafit

Për herë të parë gjatë lidhjes së kontratave individuale të punës për pozicione të caktuara të tilla si redaktorë, stenografë, përkthyes, grafik designer, u aplikua si risi telepuna.



4. Trajnimi i punonjësve me kohë jo të plotë pune

Është konsideruar si faza e fundit dhe më e rëndësishme e procesit të rekrutimit. Trajnimi i punonjësve u realizua në dy sesione informimi.

Programi i trajnimit në sesionin e parë që u realizua nga burimet njerëzore përbërë:

- Njohjen me bazën ligjore që rregullon veprimtarinë e KQZ,
- Prezantim mbi strukturë organikën dhe organet drejtuese të KQZ,
- Përbërja dhe organizimi i komisioneve të nivelit të dytë dhe të tretë,
- Etika dhe disiplina në punë.

Programi i trajnimit në sesionin e dytë që u realizua nga drejtoritë përkatëse përbërë tematika bazuar kryesisht në detyra dhe objektiva specifike që ato kanë. U organizuan gjithsej (7) shtatë sesione trajnimi në grupe me nga 35 punonjës.

5. Administrimi i të dhënave

Spektori i Burimeve Njerëzore këtë informacion e ka përmbledhur dhe e menaxhon në një database, e cila përmban të dhëna të detajuara për çdo aplikant: *(datëlindje, ID, email, celular, kategori page, afatin e kontratës, vjetërsi, pozicionin e punës, arsimin)*.

Seksioni 5: Lista e Zgjedhësve

1. Përgatitja e listës së zgjedhësve.

Kodi Zgjedhor i ka caktuar KQZ-së rolin mbikëqyrës në procesin e hartimit të listave të zgjedhësve. Këtë rol KQZ-ja e ka realizuar duke i kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore gjatë procesit të përgatitjes së listave të zgjedhësve.

Për realizimin e Zgjedhjeve Vendore 2023, KQZ-ja mbikëqyri drejtpërdrejt veprimet në bazën e të dhënave të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile për hartimin e listave të zgjedhësve nëpërmjet dy auditëve teknikienë të emëruar sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor. Veprimtaria e auditëve teknikienë është rregulluar me një akt normativ të miratuar nga KQZ.

2. Lista përfundimtare e zgjedhësve.

Raportet periodike mujore të auditëve teknikien u dorëzuan dhe publikuan në web-in e KQZ si dhe problematikat e konstatuara u janë adresuar për zgjidhje institucioneve përkatës si Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, Njësive përkatëse Vendore.

Sipas konkluzioneve të auditëve teknikienë:

- Ekstraktet janë gjeneruar brenda afateve ligjore në zbatim të pikave 5 dhe 7, të nenit 51 të Kodit Zgjedhor;
- Ekstrakti i fundit kishte 3.650,550 zgjedhës dhe numri i QV-ve ishte 5212;

- Nga ekstrakti i parë në ekstraktin e fundit numri i zgjedhësve mbi 100 vjeç të pa përfshirë në listat e zgjedhësve ishte 3717;
- Të gjitha ZGJC, kishin printuar listat e zgjedhësve, në përputhje me nenin 51 të kodit Zgjedhor;
- Pasqyrimi në web i listës së zgjedhësve u realizua në bashkëpunim me DPGJC dhe “e-albania”.

Seksioni 6: Veprimtaria e institucioneve publike

1. Raportimi i institucioneve publike.

Në zbatim të nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, Institucionet publike qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore mbartin detyrimin për raportimin e të gjitha veprimtarive publike të planifikuara për të zhvilluar në periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve, në ndërfaqen elektronike të KQZ-së.

Raportimi në ndërfaqe kryhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë ose të aktivitetit publik. Raportimi në ndërfaqe, në emër dhe për llogari të subjekteve, bëhet nga sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore dhe vendore (monokratike ose kolegjiale), drejtorët e përgjithshëm apo drejtuesit më të lartë administrativë për agjencitë dhe institucionet nën varësinë e Kryeministrit, drejtuesit ekzekutivë të shoqërive tregtare në të cilat shteti ka pjesëmarrje në kapitale, kuota e aksione më shumë se 50 për qind të aksioneve, drejtuesit ekzekutivë të ndërmarrjeve shtetërore, enteve publike, si dhe Administratorët e Njësisve Administrative. Subjektet, kur e kanë të pamundur teknikisht të aksesojnë ndërfaqen, e dërgojnë raportimin nëpërmjet *e-mail*-it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar.

Për zgjedhjet e organeve të njësisve të qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, që prej datës 13 Janar 2023 filloi detyrimi për organet publike për të raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve mbi veprimtaritë e tyre publike, për periudhën 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.

KQZ-ja administroi në mënyrë dinamike të gjithë procesin zgjedhor përmes mekanizmave të veçantë për të lehtësuar aksesin e institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, në raportimin e veprimtarive publike, nëpërmjet ndërfaqes së dedikuar në faqen elektronike zyrtare të KQZ-së, postës elektronike dhe adresës postare zyrtare. Ndërfaqja “Veprimtari Publike” ka qenë lehtësisht e aksesueshme nga publiku, media, shoqëria civile dhe çdo i interesuar për të marrë informacion mbi veprimtaritë e raportuara dhe ato të ndaluara nga KQZ.

Ndërfaqja e raportimeve ndoqi hapat si vijon:

- Identifikimi dhe njoftimi i institucioneve përgjegjëse për raportimin e veprimtarive publike,
- Hapja e llogarive për personin e kontaktit me KQZ, (koordinuar nëpërmjet postës zyrtare elektronike dhe me shkresë, nga Sektori i Hartimit të Akteve, Drejtoria e Logjistikës dhe Digjitalizimit dhe Institucioni përkatës),
- Krijimi i një database me personat e kontaktit
- Monitorimi i raportimeve në ndërfaqe,
- Hedhja në një database manualisht, në kohë reale,
- Vlerësimi i veprimtarive,
- Identifikimi i mosrespektimit të afatit 5 (pesë) ditor për raportim,
- Vendimmarrje e Komisionerit.

Numri total i raportimeve në ndërfaqe, gjatë periudhës zgjedhore 13 janar - 14 maj 2023 për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, është **3811 veprimtari nga 147** institucione publike.

Në ndërfaqen e raportimeve rezultojnë të regjistruara **716 institucione publike**, me një diferencë prej 361 institucione të reja, në raport me zgjedhjet parlamentare, të vitit 2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve u tërhoqi vëmendjen institucioneve publike dhe organeve të tyre të varësisë, që të respektojnë Kodin Zgjedhor dhe dispozitat e vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator për raportimin e aktiviteteve me karakter publik.

Me Kujtesën e datës 10.1.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve solli në vëmendjen e të gjithë institucioneve publike qendrore dhe vendore, detyrimin për të raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të gjitha veprimtaritë publike të paktën 5 (pesë) ditë përpara datës së parashikuar për zhvillimin e tyre. Raportimi kryhet në ndërfaqen përkatëse të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve <https://aktivitete.kqz.gov.al/> nga personi përgjegjës duke specifikuar të dhënat për organin publik që organizon veprimtarinë, datën dhe orën e veprimtarisë, tematikën e veprimtarisë, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin ose jo të veprimtarisë. Në këtë Kujtesë janë parashikuar edhe ndalimet përkatëse si vijon: përdorimi i shenjave, logove, sloganeve, pankartave, posterave të lëvizshëm ose jo, materialeve propagandistike që identifikojnë drejtpërsëdrejti, apo tërthorazi një parti politike/subjekt zgjedhor apo kandidat në zgjedhje, thirrjet, apo fjalimet me përmbajtje partiake ose zgjedhore në favor të një subjekti zgjedhor apo të një kandidati, promovimi i investimeve me pjesëmarrjen e zgjedhësve/elektoratit, përfaqësuesve të partisë politike, shpërndarja publike e lejeve të legalizimit dhe/ose çdo titulli pronësie dhe promovimi i projekteve të ndryshëm në investime, shërbime, për të cilat fondet janë planifikuar pas datës 13 Janar dhe jashtë programit vjetor buxhetor të miratuar në fillim të viti, të cilat konsiderohen si veprimtari politike zgjedhore.

Gjithashtu, ndalohet pjesëmarrja e punonjësve të administratës brenda orarit zyrtar të punës në këto lloj veprimtarish. Këto lloj veprimtarish nuk lejohet të zhvillohen në selitë dhe oborret e shkollave, spitale, selitë e organeve publike qendrore dhe vendore, të tilla si ministri, bashki, agjenci të ndryshme e të tilla të ngjashme, biblioteka, qendrat kulturore përveç kur këto janë përcaktuar me vendim/udhëzim nga institucioni që i ka në varësi, si qendra multifunkionale.

Me Kujtesën e datës 31.3.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve risolli dhe njëherë në vëmendjen e të gjithë institucioneve publike qendrore dhe vendore detyrimin për të respektuar dispozitat ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator. Kjo kujtesë u hartua për të pasur një qasje/kuptim sa më të drejtë të raportimit të veprimtarive publike dhe trajtimin e tyre në raport me veprimtaritë që konsiderohen të ndaluara, në kuptim të Kodit Zgjedhor, të përmendura dhe në kujtesën e parë. Veprimtaritë politike/elektorale të subjekteve zgjedhore (qoftë dhe të kandidatëve, të cilët, njëkohësisht mbajnë dhe statusin e drejtuesit të një institucioni apo funksionari publik) nuk mbartin detyrim për raportim, dhe nuk lejohen të kryhen me pjesëmarrjen e tyre gjatë orarit zyrtar, apo të pasqyrohen në rrjetet sociale të institucioneve publike. Në to ndalohen të marrin pjesë parti politike, subjekte zgjedhor përfaqësues, mbështetës apo simpatizantë të tyre, ndalohen deklaratimet politike dhe/ose elektorale, ftesa për të mbështetur një subjekt zgjedhor, apo një program politik/elektoral të caktuar, stigmatizime të forcave politike, apo të subjekteve zgjedhore, përdorimi i burimeve publike për zhvillimin e kësaj lloj veprimtarie dhe përdorimi i simboleve, logove, apo të tjera të ngjashme, të institucioneve publike.

Për sa më lart, u është kërkuar institucioneve të merren masa dhe të zbatohen me kujdes parashikimet ligjore dhe përcaktimet, në kujtesat e mësipërme me qëllim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe partive politike, që marrin pjesë në procesin zgjedhore si dhe mospërdorimin e fondeve dhe burimeve publike për qëllime partiake.

2. Vlerësimi i veprimtarive publike dhe shqyrtimi i denoncimeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka nisur një hetim administrativ për 516 veprimtari të raportuara, në shkelje të afatit të raportimit, për të cilat është pushuar hetimi administrativ për 496 raste dhe për 20 raste të tjera, është vijuar procedimi administrativ. Për 20 aktivitete, raportuar nga 4 institucione publike, nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i është kërkuar Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, vendosja e sanksioneve administrative. Për 18 aktivitete, KAS vendosi pranimin e kërkesës dhe vendosje sanksioni ndaj personave përgjegjës, kurse për 2 aktivitete rrëzimin e saj.

Gjatë të njëjtës periudhë janë ndaluar me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shkelje të afatit të raportimit dhe/ose pjesëmarrje të përfaqësuesve politikë (të cilat përbëjnë shpërdorim të burimeve njerëzore nga ana e institucioneve publike) **37 veprimtari publike**, prej të cilave **18** kanë qenë në **shkelje të afatit** të raportimit dhe **19** për **pjesëmarrje të përfaqësuesve politikë**.

Në çdo rast ku ka pasur dyshime për zhvillimin e veprimtarive me pjesëmarrje të përfaqësuesve politikë, të cilat mund të përbënin rast për shpërdorim të burimeve njerëzore nga ana e institucioneve publike, ose rastet kur ka pasur vendime ndalimi për zhvillimin e veprimtarisë për mosrespektim të afatit të raportimit, është dërguar kërkesë për caktimin e monitoruesit, me qëllim vëzhgimin nëse këto aktivitete do të zhvillohen ose jo në përputhje me dispozitat ligjore të Kodit Zgjedhor.

Hetimi administrativ vijoi me marrjen e masave për shkeljet e konstatuara, duke sanksionuar mosrespektimin e detyrimeve ligjore, të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit

Nga monitorimi i ndërfaqes së raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për veprimtaritë publike të institucioneve gjatë periudhës 13 janar-14 maj janë konstatuar këto problematika:

- Aktivitetet, të cilat do të kryheshin nga institucionet, nuk janë raportuar në kohë duke mos respektuar afatin 5 (pesë) ditor për raportim, të sanksionuar në nenin 92, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Tematika e Veprimtarisë së kryer nga institucioni raportues ka qenë jo e plotë dhe e përgjithshme. Mungesa e detajuar e informacionit mbi tematikën e veprimtarisë kufizon mundësinë e KQZ-së dhe të palëve të treta (publiku, shoqëria civile, partitë politikë) të verifikojnë plotësimin e kriterëve dhe kushteve ligjore dhe rrjedhimisht ndalimin e veprimtarive nga ana e KQZ-së në rast të shkeljes së tyre.
- Gjatë vitit 2023, faqet zyrtare të institucioneve kanë hasur vështirësi në aksesimin e ndërfaqes së KQZ-së dhe raportimin e veprimtarive, për shkaqe të kufizimeve teknike që vendosi ofruesi i shërbimit, pas sulmit kibernetik të gushtit të vitit 2022.
- Një tjetër problem i hasur gjatë raportimeve ka qenë pamundësia në ndryshimin e të dhënave të raportimeve, (moszhvillimi, shtyrja, vendndodhja, etj.) duke mos ndryshuar dot elementët e saj, çka sjell nevojën për të kryer një raportim të ri, në raste të veçanta në shkelje të afatit të raportimit të kryer së fundmi.

Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, ka pasur një ndërgjegjësim të shtuar të institucioneve publike, të cilat kanë marrë akses në ndërfaqe, për të raportuar të gjitha veprimtaritë, si ato të organizuara prej tyre, dhe rastet kur kanë qenë në cilësinë e të ftuarit ose pjesëmarrësit, në veprimtari të organizuara nga institucione të tjera. U vu re një numër i lartë raportimesh krahasuar me zgjedhjet pararendëse, trefish më i lartë.

Gjatë këtyre zgjedhjeve kemi pasur shtim të numrit të monitorimeve të kryera nga KQZ nëpërmjet monitoruesve në terren si dhe monitorim të vazhdueshëm në ndërfaqe dhe përpunimi statistikor të këtyre të dhënave.

Në kuadër të rritjes së standardit të administrimit të procesit zgjedhor, të integritetit dhe të ndershmërisë së tij, ka disa çështje të cilat duhet të adresohen, në përputhje edhe me konstatimet dhe rekomandimet e OSBE-ODIHR.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u tërhoqi vëmendjen institucioneve publike dhe organeve të tyre të varësisë, që të respektojnë Kodin Zgjedhor dhe dispozitat e vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator për raportimin e aktiviteteve me karakter publik.

Shqyrtimi i denoncimeve

Në zbatim të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, vendimit nr. 9, datë 09.03..2021, të Komisionit Rregullator “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrative të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, janë përcaktuar rregulla në funksion të marrjes së masave për monitorimin dhe parandalimin e veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve shtetërore, gjatë periudhës zgjedhore.

Në zbatim të udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, janë përcaktuar kriteret e vendndodhjes së zyrave zgjedhore, kriteret për përdorimin e materialeve propagandistike/edukuese dhe përcaktimi i listës së sendeve apo materialeve të lejuara për fushatë me vlerat maksimale për secilin prej tyre.

Gjatë periudhës 13 janar – 13 maj 2023 janë administruar në total 449 denoncime nga të cilat janë vendosur 76 sanksione si rrjedhojë e shkeljeve administrative referuar parashikimeve të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor”, i ndryshuar, Vendimi nr. 9, datë 24.10.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimeve të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” dhe Udhëzimi nr. 6, datë 23.4.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

- 86 raste nga subjekte politike, nga të cilat:

- 11 raste - Për afishim materiali propagandistik;
- 1 rast - Për publikim sondazhi;

- 3 raste - Për hapje zyre zgjedhore në kundërshtim me udhëzimin nr. 6/2021;
- 11 raste - Për detyrim për pjesëmarrje në fushatë elektorale;
- 1 rast - Për fillimin e procedurave të largim/emërim;
- 1 rast – Për keqinformim nga ana e subjekteve mediatike;
- 2 raste - Për lançim aplikacioni;
- 3 raste - Për miratim aktesh nënligjore;
- 3 raste - Për mosraportim të veprimtarive publike institucionale;
- 2 raste - Për mosraportim veprimtarie publike dhe prani e elementëve elektorale;
- 2 rast - Për postim me përmbajtje elektorale në rrjetin social personal;
- 2 raste - Për postim me përmbajtje elektorale në rrjetin social të faqes zyrtare të Kryetarit të Bashkisë;
- 42 raste - Për shpërdorim të burimeve publike;
- 1 rast - Për zhvillim aktiviteti të ndaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- 1 rast - Për shpërndarje certifikatash elektorale.
- **19 raste nga Qendra “Qëndresa Qytetare”, nga të cilat:**
 - 1 rast - Për mosraportim të veprimtarisë publike institucionale;
 - 9 raste - Për shpërdorim të burimeve publike;
 - 7 raste - Për postim me përmbajtje elektorale në rrjetin social të institucionit;
 - 1 rast - Për mosraportim dhe përdorim i burimeve publike;
 - 1 rast - Për miratim akti nënligjor.
- **1 rast është përcjellë nga Organizata “Drejtësi Sociale”, me objekt:**
 - 1 rast - Për mosraportim të veprimtarive publike institucionale
- **5 raste nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, nga të cilat:**
 - 3 raste - Për shpërdorim të burimeve publike;
 - 1 rast - Për thyerje të heshtjes zgjedhore;
 - 1 rast - Për afishim materiali propagandistik.
- **8 raste nga monitorues të kontraktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nga të cilat:**
 - 3 raste - Për shpërdorim të burimeve publike;
 - 3 raste - Për mosraportim të veprimtarive publike institucionale;
 - 1 rast - Për afishim materiali propagandistik;
 - 1 rast - Për hapje zyre zgjedhore në kundërshtim me udhëzimin nr. 6/2021.
- **10 raste nga Sinjalizues, për të cilat:**
 - 1 rast - Për fillimin e procedurave të largim/emërim;
 - 1 rast - Për fillim procedure prokurimi;
 - 1 rast - Për postim me përmbajtje elektorale;
 - 1 rast - Për shpërdorim detyre;
 - 2 raste - Për mosraportim të veprimtarive publike institucionale;
 - 1 rast - Për hapje zyre zgjedhore në kundërshtim me udhëzimin nr. 6/2021;

- 3 raste Për për shpërdorim të burimeve publike.
- **320 raste nga Organizata "Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara KRIIK", për të cilat:**
 - 2 raste - Për afishim materiali propagandistik;
 - 12 raste - Për kryerje aktiviteti me përmbajtje elektorale;
 - 19 raste - Për kryerje aktiviteti me praninë e përfaqësuesve politik;
 - 219 raste - Për mosraportim të veprimtarive publike institucionale;
 - 4 raste - Për mosraportim veprimtarie publike dhe prani e elementëve elektorale;
 - 2 raste - Për mosraportim/ Shpërndarje tituj pronësie;
 - 8 raste -Për përdorim hashtag rrjetet sociale të faqes zyrtare të Ministrisë/Ministres, Bashkisë, Kryetarit të Bashkisë;
 - 8 raste - Për postim me përmbajtje elektorale në rrjetin social të faqes zyrtare të Bashkisë;
 - 20 raste - Për postim me përmbajtje elektorale në rrjetin social të faqes zyrtare të Kryetarit të Bashkisë;
 - 4 raste - Për shpërdorim të burimeve publike;
 - 2 raste - Për kryerje aktiviteti elektorale;
 - 2 rast - Për thyerje të heshtjes zgjedhore
 - 1 rast - Për publikim sondazhi;
 - 11 raste - Për zhvillim aktiviteti përpara datës së raportuar;
 - 6 raste - Për zhvillim aktiviteti të ndaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, për 449 denoncimet e administruara është kryer hetimi administrativ i cili vijoi me marrjen e vendimeve për shkeljet e konstatuara në bazë javore, duke krijuar një dinamikë shqyrtimi javore pavarësisht periudhës 60 ditore të parashikuar në ligj. Lidhur me denoncimet e administruara, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur 64 sanksione administrative me objekt:

- 7 sanksione për “Mosdorëzimin e vendimit për përcaktimin e vendeve publike në territorin e bashkive përkatëse për afishimin prej subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike”;
- 18 sanksione për “Mosraportimin e veprimtarive publike”;
- 31 sanksione për shpërdorimin e burimeve publike dhe përdorimin e hashtagjeve;
- 4 sanksione për zhvillimin e aktiviteteve të ndaluar nga KQZ;
- 4 sanksione për tejkallim minutazhi televiziv nga mediat audivizive.

KQZ ka marrë masa administrative për 60 funksionarë, nga të cilët 1 ministër, 27 kryetarë bashkie (në 19 raste në cilësinë e tyre si subjekte zgjedhore), 24 persona përgjegjës për raportimin e

veprimtarive publike, 5 sekretarë të përgjithshëm (3 nga të cilët janë proceduar edhe si persona përgjegjës, edhe si sekretarë të përgjithshëm), si dhe 1 drejtues agjencie shtetërore, 3 drejtues shkollash dhe 1 drejtues qendre kulturore.

Gjithashtu, janë marrë masa administrative për 4 media audio-vizive si vijon:

- Gold TV
- Channel 7
- TV 1 Channel
- Saranda TV

Seksioni 7: Komisionet Zgjedhore dhe administrimi zgjedhor

Administrata Zgjedhore është përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve dhe procesit zgjedhor. Ajo është e strukturuar në administratë zgjedhore të nivelit të dytë e të tretë, respektivisht Komisionet e Zonave të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ-të ose të njohura si administrata e nivelit të dytë) dhe Komisionet e Qendrave të Votimit dhe Grupet e Numërimit të Votave (KQV dhe GNV ose të njohura si administrata e nivelit të tretë).

KZAZ-të janë përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve në Zonën e Administrimit të Zgjedhjeve/ Zonën Zgjedhore. Në zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore këto komisione kanë një rol të rëndësishëm për arsye se administrojnë kërkesat e subjekteve për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie dhe këshillat bashkiak në zonat zgjedhore juridiksioni i të cilave shtrihet në një bashki të vetme, marrin vendime për regjistrimin e kandidatëve dhe shpalljen fitues të kandidatit për kryetar të bashkisë.

Në zgjedhjet e datës 14 maj 2023, 50 KZAZ që mbulonin njësinë e qeverisjes vendore përkatëse (juridiksioni i të cilave përkonte me një bashki), administruan dhe morën vendime për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie dhe listat e kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiak në 50 bashki.

1. Emërimi i komisionerëve dhe konstituimi i KZAZ-ve

KQZ është angazhuar në të gjitha etapat e emërimit, konstituimit dhe funksionimit të Komisioneve të Zonave të Administrimit të Zgjedhjeve për shkak të rëndësisë që kanë në administrimin e procesit të zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- me vendimin nr. 6, datë 09.01.2023, përcaktoi partitë politike që do të propozonin anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve, që do të ngriheshin për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
- me vendim nr. 11, datë 12.01.2023, sipas shortit të hedhur caktoi anëtarin e shtatë të KZAZ-ve:
 - Në KZAZ-të e renditura me numër tek anëtari i 7 u propozua nga PD;
 - Në KZAZ-të e renditura me numër çift anëtari i 7 u propozua nga PS.

Brenda afatit ligjor paraqitën propozimet për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia e Lirisë. Partia Socialdemokrate paraqiti propozime për anëtarë në 73 KZAZ ndërsa për vakancat e krijuara në 19 KZAZ për shkak të mos propozimit nga PSD u plotësuan nga PS.

Partia Demokratike paraqiti propozime për anëtarë dhe sekretarë KZAZ të paplota ose me mungesa në dokumentacion shoqërues të cilat u plotësuan në tejkalim të afateve ligjore.

Me vendimin nr. 49, datë 10.02.2023, Komisioneri caktoi zhvillimin e mbledhjes së parë të KZAZ-ve me datë 13 shkurt 2023.

Në konstituimin e KZAZ-ve, në mbledhjen e parë të zhvilluar me prezencë të përfaqësuesve të KQZ, përbërja e KZAZ-ve ishte me 5 ose 4 anëtarë, pasi PD nuk kishte ende anëtarë të emëruar në KZAZ.

Në ditën e konstituimit të KZAZ-ve numri i administratës zgjedhore të nivelit të dytë të emëruar ishin 460 anëtar në total prej të cilëve 32% gra dhe 68% burra.

1. Në 46 KZAZ me numër çift përbërja ishte:
 - a. 1 Kryetar
 - b. 4 anëtarë
2. Në 46 KZAZ me numër tek përbërja ishte:
 - a. 1 zëvendëskryetar
 - b. 3 anëtarë
 - c. 1 sekretar

KQZ administroi një numër shumë të vogël kërkesash nga shoqëria civile/ individë për t'u zgjedhur anëtarë kryesisht të KZAZ-ve, që e bënte të papërshtatshme ndërmarrjen e një vendimi për miratimin e listës nga Komisioneri deri në ditën e konstituimit të KZAZ-ve.

Më datë 10 mars 2023, Komisioneri emëroi 220 anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve të propozuar nga subjekti Partia Demokratike.


Propozimet e PD nuk respektonin kërkesat e Kodit Zgjedhor për plotësimin e kuotës gjinore, ndërkohë që 15% e anëtarëve të emëruar fillimisht refuzuan të merrnin detyrën.

Nga konstituimi dhe deri në përfundimin e procesit zgjedhor (nxjerrjes së rezultateve), me vendimin të KSHZ janë marrë 32 vendime lirim emërimi për zëvendësimin e 293 anëtarëve të KZAZ-ve ku konkretisht:

- PS ka zëvendësuar 76 anëtarë ose 26% të propozimeve të saj, nga të cilët 42 meshkuj dhe 34 femra
- PD ka zëvendësuar 111 anëtarë ose 43% të propozimeve të saj, nga të cilët 82 meshkuj dhe 29 femra.
- PL ka zëvendësuar 67 anëtarë ose 63% të propozimeve të saj, nga të cilët 54 meshkuj dhe 13 femra.
- PSD ka zëvendësuar 39 anëtarë ose 54% të propozimeve të saj, nga të cilët 29 meshkuj dhe 10 femra.


Komisioneri mori vendim shkarkimi për katër anëtarë të KZAZ-ve të cilët nuk u paraqitën në detyrë (3 anëtarë të propozuar nga PD dhe 1 nga PL).

Partia Demokratike, për 7 (shtatë) ZAZ, nuk paraqiti kandidatura për anëtarë të KZAZ-ve dhe një kandidaturë sekretari për KZAZ-në 82, Bashkia Dropull.



40% e administratës zgjedhore e nivelit të dytë, KZAZ, ka pësuar ndryshime përgjatë gjithë periudhës së funksionimit të tyre. Këto zëvendësime kanë krijuar vështirësi në trajnimin e tyre dhe kuptohet në performancën e tyre.

96% e KZAZ-ve (88 nga 92) u prekën nga ndryshimet e partive politike duke dëmtuar stabilitetin dhe performancën e tyre.



KQZ mori masat për të siguruar plotësimin e detyrimeve të udhëzimit nr. 2, datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullator “Për përcaktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe në KQV”, i ndryshuar.

Brenda afatit 10 ditor të vënë në dispozicion në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi numri i kandidaturave ishte shumë i ulët. Njoftimi dhe linku për administrimin e kërkesave online qëndroi i hapur deri në ditën e zgjedhjeve.

Në total aplikuan 54 shtetas për të qenë anëtarë të emëruar kryesisht në KZAZ. Pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve të secilit aplikant, me vendim të Komisionerit u miratuan shtetasit të cilët plotësonin kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Nga 54 aplikime u miratuan 23 kërkesa që plotësonin kërkesat ligjore.

Gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për administratë zgjedhore që mund të emëroheshin kryesisht nga KQZ, u evidentua ulje e shprehjes së interesit, mungesa e sensibilizimit dhe afatet tejet të ngushta të cilat pamundësojnë jo vetëm njohjen me kërkesën për pjesëmarrje, verifikimin e duhur dhe te përshtatshëm te kandidaturave por edhe përzgjedhjen dhe trajnimin e tyre.

Përgjatë procesit të rekrutimit të anëtarëve të KZAZ-ve u konstatuan këto problematika:

- Mungesa kandidaturash nga partitë politike për pozicionin e sekretarit për shkak të kërkesës ligjore për arsimin juridik (kryesisht zonat rurale) dhe mungesë aplikimesh për përzgjedhjen kryesisht të tyre;
- Propozimi i kandidaturave nga ana e subjekteve pa pëlqimin e kandidatit;

- Propozimi i disa anëtarëve të KZAZ-ve në listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore për kandidatë të këshillave.

2. Emërimi i anëtarëve të KQV-ve dhe GNV

Krijimi i Komisioneve të Qendrave të Votimit është një nga fazat kyçe të vendimmarrjes së KZAZ-ve. Sipas Kodit Zgjedhor subjektet politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë duhet të paraqesin propozimet e tyre jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve për anëtarët e KQV dhe 12 ditë para datës së zgjedhjeve për anëtarët e Grupeve të Numërimit (GNV). KZAZ krijon KQV-të jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve KQV-të dhe jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve ngre grupet e numërimit të votave.

KZAZ-të nga ana e tyre, respektuan formalisht afatet ligjore për emërimin e anëtarëve të KQV dhe GN.

Sipas të dhënave të dërguara nga KZAZ-të rezultojnë se deri ditën e zgjedhjeve janë ndryshuar 30% e anëtarëve të KQV nga listat fillestare të subjekteve politike. I njëjti trend vërehej edhe në emërimet e anëtarëve të GNV, të cilët u emëruan dhe trajnuan ditën e numërimit të votave. Ndryshimet kanë ndodhur në periudhën 7 ditë para datës së zgjedhjeve duke cënuar trajnimin dhe performancën e tyre.

1. Krijimi i KQV-ve

- a. Formalisht KZAZ-të kanë administruar propozimet e partive për anëtarë të KQV-ve brenda afatit ligjor (Afati për propozimin e kandidaturave ishte data 14.4.2023).
- b. Përgjatë komunikimit me KZAZ-të në kohe reale është raportuar se subjekti Partia Demokratike, Partia e Lirisë, Partia Social Demokrate, Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet nuk kanë paraqitur kandidatura apo dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për anëtarët e KQV-ve dhe GN.

30 (tridhjetë) KZAZ kanë raportuar problematika lidhur me mangësitë apo mosplotësimin e dokumentacionit nga ana e subjekteve kryesisht PD, PL dhe PSD.

Një ditë para Ditës së Zgjedhjeve nga KZAZ-të janë raportuar:

1. Mungesa, zëvendësime, shkarkime, emërimet për shkak të vakancës së krijuar nga mosparaqitja në kohë e anëtarëve të subjekteve PD, PL dhe PSD.
2. 204 QV me 4-5 anëtarë.
3. 32 QV pa kuorum.

KQZ, me qëllim minimizimin e situatave ku qendrat e votimit të ishin nën kuorum, ka mbajtur në faqen e saj elektronik njoftimin për aplikime nga shtetas që mund të caktohen si anëtar kryesisht në qendrat e votimit.


Shtetasit të cilët kanë aplikuar për të qenë anëtarë kryesisht të KQV, ishin në total 739 shtetas.

Pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve të secilit aplikant, me vendim Komisionerit u miratuan shtetasit të cilët plotësonin kriteret e KZ, konkretisht :

- Me vendimin nr.518/2023 të KSHZ u miratua lista me 559 shtetas.
- Me vendimin nr.519/2023 të KSHZ (për një ndryshim në vendimin nr.518/2023) u vendos që listës me 559 shtetas t'i shtohen edhe 2 shtetas të tjerë, duke çuar në total numrin e shtetasve të përzgjedhur për anëtarë të administratës zgjedhore që mund të caktohen kryesisht nga KZAZ-të në 561 persona.

Në total aplikuan 739 shtetas, prej të cilëve u miratuan 561 kërkesa.

Në përfundim të administrimit të të dhënave (nga KZAZ-të në përfundim të procesit) rezultoi se janë emëruar nga 36,491 pozicione anëtarë të KQV-ve, u emëruan 35,485 komisionerë (pra 98% e pozicioneve). Raporti gjinor në administratën e nivelit të tretë ishte 79% burra dhe 21% gra.



Problematikat e evidentuara gjatë procesit të rekrutimit të KQV-ve:

- mungesa kandidaturash nga partitë politike për pozicionin e sekretarit për shkak të kërkesës ligjore për arsimin të lartë apo të mesëm në disa zona (kryesisht zonat rurale) dhe mungesë aplikimesh për përzgjedhjen kryesisht të tyre;
- pretendime për anëtarë KQV që ishin nëpunës të administratës së bashkive apo lidhje me kandidatët;
- mospjesëmarrja në trajnime.

Krijimi i Grupeve të Numërimit

Komisioneri, më datë 24.4.2023 miratoi vendimin nr. 404 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Sipas vendimit, i cili u la në fuqi si nga KAS ashtu dhe nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, u caktua që partia politike e shumicës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të Grupeve të Numërimit të Votave është Partia Socialiste e Shqipërisë.

Ndërsa partitë politike të opozitës parlamentare, që propozuan anëtarin e katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, në bazë të rezultatit të shortit, janë:

- a. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet,
- b. Partia e Lirisë.

Në total: Për 85 KZAZ u vendosën 393 tavolina për numërimin e votave dhe u ngritën 786 grupe numërimi (prej të cilave 393 grupe të para numërimi dhe 393 grupe të dyta numërimi) ndërsa në 7 KZAZ nuk u ngritën GN për shkak të pilotimit të PEVN-së.

Nga 3,144 anëtarë të GN janë emëruar 2,983 anëtarë. Mungesa prej 5% e pozicioneve vijnë kryesisht për shkak të mungesës së propozimeve të subjektit PDIU dhe PD.

Seksioni 8: Trajnimi i administratës zgjedhore dhe grupeve të interesit

1. Trajnimi i komisionerëve

Neni 19 i Kodit Zgjedhor parashikon se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencë të drejtë procesin e trajnimit dhe kualifikimit të administratës zgjedhore. Bazuar në këtë përcaktim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi me vendimin nr. 218, datë 01.12.2022 programin për trajnimin dhe monitorimin e administratës zgjedhore dhe të disa aktorëve të tjerë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore.

Miratimi në kohë përpara zgjedhjeve për të mundësuar një administrim efektiv të zgjedhjeve për çështjen e trajnimeve duke mundësuar hapjen në kohë të thirrjeve për aplikime dhe mundësinë e trajtimit të aplikantëve sipas kriterëve të mirë përcaktuara.

Për zgjedhjet e datës 14 maj 2023 u parashikua angazhimi i tre kategorive trajnerësh:

- Trajnerët profesionistë të përzgjedhur nga KQZ realizuan trajnimin e kandidatëve për trajnerë. Skema e trajnimeve e miratuar nga KQZ, parashikonte nevojën për 78 trajnerë.
- 39 trajnerë afatgjatë të cilët trajnuan monitoruesit e fushatës zgjedhore, KZAZ-të, KQV-të dhe GNV-të, dhe
- 39 trajnerë afatshkurtër të cilët trajnuan KQV-të dhe GNV-të.

Përzgjedhja e trajnerëve u bë bazuar në kritere të përcaktuara qartë dhe që bazoheshin në kriterin arsimor dhe atë profesional.

Përsa i përket ciklit të studimeve që kishin mbaruar rezultoni se:

- a. 13% trajnerëve ishin me doktoraturë,
- b. 56% të tyre me MSC,
- c. 17% me Master profesional dhe
- d. 14 % me Bachelor.

53% e tyre kishin edukimin në shkencat sociale, 20% në shkencat juridike dhe 27% në ato ekzakte.

Duke qenë se një nga kriteret për përzgjedhjen e tyre ishte përvoja në mësimdhënie rezultoi se 58% e tyre kishin një përvojë në mësimdhënie mbi 15 vjet, 13% me një përvojë 10-15 vjet dhe 11% nga 1-5 vjet.

Me qëllim krijimin e një trupe trajnerësh profesionistë, KQZ preferonte individë të cilët kishin përvoja më mëparshme në procese zgjedhore. Rezulton se 32 nga trajnerët kanë përvojë në mbi 6 procese zgjedhore, 7 trajnerë kanë qenë të përfshirë si të tillë në 5 procese zgjedhore, të tjerët dy ose tri procese zgjedhore dhe 13 trajnerë e kishin angazhim për herë të parë në proces zgjedhor.

Trajnimi i trajnerëve

Trajnerët afatgjatë u trajnuan përmes një programi 4 ditor në të cilën u shteruan temat mbi detyra dhe funksionet e administratës zgjedhore si dhe mbi monitorimin e fushatës zgjedhore. Këta trajnerë u angazhuan që në momentin e rekrutimit të monitoruesve të fushatës zgjedhore. Trajnerët afatshkurtër u trajnuan përmes një programi trajnimi 2 ditor lidhur me detyrat e funksionet e komisioneve të qendrave të votimit dhe grupet e numërimit të votave. Gjithashtu trajnerët u trajnuan edhe mbi rolin e tyre monitorues si dhe mbi mënyrën e raportimit të tyre në kohë reale për zhvillimin e trajnimeve apo mbi procesin e monitorimit.

Trajnimi i administratës zgjedhore (KZAZ/ KQV/ GNV)

Trajnerët afatgjatë fillimisht u angazhuan në trajnimin e monitoruesve të fushatës zgjedhore. Në këtë proces trajnimi u trajnuan të gjithë monitoruesit e përzgjedhur nga KQZ.

Trajnerët afatgjatë kryen trajnimet e KZAZ që në momentin e konstituimit të tyre sipas një skeme në të cilin u përcaktua vendi dhe koha e zhvillimit të tyre. Trajnimi i KZAZ konsistonte për trajnimin mbi detyrat e KZAZ dhe mbi procesin e numërimit të votave. Trajnimi i administratës së KZAZ për shkak të zëvendësimeve të shpeshta diktoi nevojën për trajnimin e anëtarëve zëvendësues të KZAZ.

Trajnimi i KZAZ për procesin e numërimit të votave si zakonisht u zhvillua në prag të ditës së zgjedhjeve në mënyrë që njohuritë e marra nga KZAZ të ishin më të freskëta.

Në përfundim, pothuajse të gjithë anëtarët e KZAZ u trajnuan nga ana e KQZ.

Në trajnimin e KQV u përfshinë të gjithë trajnerët (afatgjatë dhe afatshkurtër). Secili trajner kishte në dispozicion të saktësuar numrin e qendrave të votimit, mjedisin se ku do të zhvilloheshin trajnimin si dhe orarin e zhvillimit të tyre. Trajnerët lidhur me pjesëmarrjen e komisionerëve të QV në trajnim luan një rol koordinues me KZAZ përkatëse. Pra në këtë kuptim, trajnerët kishin edhe rolin e koordinatorit me KZAZ për të bërë të mundur rritjen e pjesëmarrjes së komisionerëve të QV në trajnim.

Në rang vendi u trajnuan 38% e Komisionerëve të qendrave të votimit. Edhe në rastin e komisionerëve të QV u vërejt si përherë numri i lartë i zëvendësimeve të anëtarëve të KQV përgjatë gjithë kohës nga ana e subjekteve zgjedhore. Këto zëvendësime janë kryer edhe deri në ditën e zgjedhjeve.

KQZ, duke qenë e vetëdijshme lidhur me fenomenin e zëvendësimeve masiv të komisionerëve të QV nga ana e subjekteve zgjedhore, përgatiti video të shkurtra lidhur me proceset në ditën e votimit si psh video për hapjen e procesit të votimit, mbylljen e procesit të votimit, apo për cënimin e procesit të votimit etj.

Po kështu, KQZ përgatiti edhe një tutorial në të cilën u pasqyrua një proces i rregullt votimi duke u fokusuar në detyrat e secilit prej anëtarëve të KQV, përfshirë edhe operatorin PEI. Këto video dhe tutoriali u ndoqën nga një numër i konsiderueshëm individësh. Linqet e video dhe tutorialit iu shpërndanë partive politike si dhe në kanalet e komunikimit të ndërtuara nga KQZ në platformat Whatsapp dhe Telegram.

Psh tutoriali pati një shikueshmëri 11,000 shikimesh.

Trajnimet e GNV u realizuan kryesisht në ditën e zgjedhjeve, para fillimit të procesit të numërimit. Trajnimi i GNV u krye tërësisht nga ana e trajnerëve, madje grupet e para dhe grupet e dyta, por trajnimi nuk zhvillohet në kushtet optimale të zhvillimit të trajnimeve, pasi ato kryhen kryesisht në VNV, pak para fillimit të procesit të numërimit. Kjo ndodh pasi anëtarët e GNV janë kryesisht të caktuar të njëjtët individë të cilët janë edhe pjesë e KQV. Kjo sjell vonesën në trajnimin e tyre që në fakt kryhet në kushtet e stërmundimit dhe lodhjes së tyre.

Roli i trajnerit si monitorues

Gjithashtu trajneri i administratës zgjedhore kreu edhe detyrën e monitoruesit të veprimtarisë së administratës zgjedhore. Angazhimi i tyre u krye sipas kërkesës së KQZ. Plani i monitorimit parashikonte monitorimin nga ana e trajnerëve të 19 aktiviteteve që kryhen nga administrata zgjedhore të tilla si verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe listave të kandidatëve, verifikimi i dërgimit të formularit të vetëdeklarimit nga KZAZ në KQZ, verifikimi i vendimmarrjes për vëzhguesit, për KQV apo GNV nga ana e KZAZ, dorëzimi i bazës materiale nga KZAZ në KQV, monitorimi i QV në ditën e zgjedhjeve, monitorim i procesit të numërimit të votave.

Trajnerët si për kryerjen e sesioneve të trajnimeve ashtu edhe për kryerjen e monitorimeve raportin në kohë reale përmes platformave përkatëse të KQZ.

Në kohë reale u realizuan 723 raportime për trajnimet e KQV, 198 raportime për KZAZ dhe 119 për GNV. Gjithsesi edhe pse treguesit e raportimeve në kohë reale janë përgjithësisht pozitive, sërish nga shqyrtimi i të dhënave rezultojnë se jo të gjithë trajnerët raportuan në kohë reale.

Ndërsa për monitorimet numërohen 628 raportime, ku fluksi më i madh i raportimeve i korrespondon datave 8 deri më 15 maj 2023 pa përfshirë këtu raportimet për monitorim në ditën e zgjedhjeve të cilat rezultojnë të jenë 970 raportime.

Trajnimet u zhvilluan kryesisht në mjedise shkollore por edhe në ambiente të tjera të pushtetit vendor. Bashkëpunimi i KQZ me strukturat e ministrisë së arsimit, konkretisht me drejtorinë e përgjithshme të arsimit parauniversitar ka qenë i frytshëm dhe kjo bëri që mjediset shkollore për zhvillimin e trajnimeve të ishin të hapura në çdo kohë e ditë të javës sipas kalendarit të zhvillimeve të trajnimeve.

KQZ konstaton sërish problematikën e zëvendësimeve në një masë të konsiderueshme të komisionerëve zgjedhorë nga subjektet zgjedhore përfshirë zëvendësime deri edhe në ditën e zgjedhjeve. Edhe pse KQZ u përpoq të realizonte edhe trajnime për anëtarët zëvendësues të KZAZ, sërish nuk mundi të ishte shteruese pasi zëvendësimet vijuan edhe pas kryerjes së trajnimeve të kësaj faze. Zëvendësimet në masë nga ana e subjekteve zgjedhore sjell reciprokisht demotivimin e trajnerëve nga njëra anë por edhe të komisionerëve nga ana tjetër. Kjo shprehet në numrin e ulët të pjesëmarrjes në trajnimet e KQZ.

2. Trajnimi i grupeve të interesit.

KQZ përgjatë 4 mujorit të parë të periudhës së raportimit është angazhuar edhe në trajnimin e grupeve të interesit. Një vëmendje të rëndësishme ka patur trajnimi i trajnerëve të policisë së shtetit për procedurat e punës dhe rolin e policisë së shtetit ditën e zgjedhjeve, të financiarëve të partive politike, të monitoruesve si dhe vëzhguesve.

Seksioni 9: Objektet zgjedhore, infrastruktura dhe logjistika.

1. Selitë e KZAZ-ve

Selitë e KZAZ-ve në përgjithësi u krijuan në të njëjtën vendndodhje si dhe të atyre në zgjedhjeve pararendëse të vitit 2021. Bashkëpunimi me organet e qeverisjes vendore ka qenë efikas dhe u janë përgjigjur me korrektësi kërkesave ligjore si për caktimin e ambienteve dhe të kriterëve që ato duhet të plotësonin si dhe sigurimin e bazës së nevojshme logjistike.

Në ditën e konstituimit të KZAZ-ve, ndryshe nga zgjedhjet e kaluara ku shfaqeshin problematika në numër të lartë për aksesimin e selive të KZAZ-ve, në procesin zgjedhor të 14 maj 2023 nuk u shfaq në masivitet si problematikë mosvënia në dispozicion e ambienteve nga institucionet

përkatëse. Në 7 raste u raportua për vonesa në vënien në dispozicion të ambienteve që do të përdreshin për seli KZAZ.

Disa seli KZAZ sipas propozimeve nga bashkia kishin mangësi të kompjuterëve dhe internetit. Nga referimet dhe komunikimet me KZAZ, 56 KZAZ ishin pa kompjuter funksional, dhe 37 KZAZ pa internet.

Koordinimi/bashkëpunimi ndërmjet KQZ, zyrave arsimore dhe bashkive, zuri vend më të rëndësishëm duke siguruar ecuri normale të aktivitetit të KZAZ-së.


2. Qendrat e Votimit

KQZ për zgjedhjet e datës 14 maj 2023 aplikoi një qasje më inovatore me bashkitë duke administruar informacionin për objektet zgjedhore në rrugë elektronike. KQZ nëpërmjet platformave të menaxhimit të informacionit administroi në 54 bashki informacion të detajuar për qendrat e votimit.

Në sistem u raportuan adresat dhe vendndodhjet gjeografike të vendndodhjeve të qendrave të votimit.

54 Bashki raportuan për vendndodhjet e 4,900 qendrave të votimit, ndërsa 7 bashki raportuan shkresërisht.

Nga administrimi i informacionit rezultoi se vendndodhja e qendrave të votimit ishte sipas kësaj tipologjie:



Nga të dhënat e administruara nga pushteti vendor rezultoi se rreth 200 QV ishin në katet e dyta e të treta kishin zgjedhës me aftësi ndryshe.

Organet e vetëqeverisjes vendore raportuan se ka rreth 18,809 zgjedhës me aftësi ndryshe (60% burra dhe 40% gra) prej të cilëve 6,169 zgjedhës të verbër (56% burra dhe 44% gra), të cilët ishin në listat e zgjedhësve të rreth 2700 qendrave të votimit.

Nga administrimi i informacionit të bashkive rezultuan se:

- 137 QV kishin probleme me vendodhjen për të siguruar fshehtësinë e votës,
- 15 QV nuk ishin me lidhje me energjinë elektrike,
- 1634 QV nuk kishin akses për rampa
- Mesatarja e ambienteve të votimit për 3300 QV ishte 36 metër katror.
- 400 QV ishin nën standardin e diktuar nga vendimi i KRR.

Me qëllim përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore, KQZ u bëri thirrje kryetarëve të bashkive që të sigurojnë që qendrat e votimit të jenë në katet e para, me theks të veçantë vendosjen në katet e para/përdhese të qendrave të votimit që kishin në listat e zgjedhësve, persona me aftësi ndryshe.

Bashkitë morën përsipër për të vendosur personel ndihmës dhe në 838 raste morën përsipër vendosjen e rampave.

Domosdoshmëria e energjisë elektrike në çdo qendër votimi kërkoi që të kishim komunikim intensiv me kryetarët e njësive të qeverisjes vendore dhe OSHEE, për të pajisur çdo qendër votimi me energji.

Përgjatë procesit të verifikimit të objekteve zgjedhore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit u evidentuan 136 raste/objekte zgjedhore me probleme të funksionalitetit të tyre (kryesisht zona rurale). Probleme të referuara për objektet zgjedhore në total 136 raste, konkretisht mungesë e energjisë elektrike, dyerve, dritareve, objekte në rikonstrukcion...etj. Bashkive ju tërhoq vëmendja për të adresuar problematikat të cilat në ditën e zgjedhjeve u minimizuan.

KQZ, bazuar në propozimet e Kryetarëve të Bashkive, shqyrtoi dhe vendosi miratimin e 333 QV-ve në ndërtesa private me 2 (dy vendime).

Ndonëse sipas përcaktimeve të kodit zgjedhor, vendndodhja e QV-ve nuk mund të ndryshojë 40 ditë para datës së zhvillimit të zgjedhjeve, vetëm për rastet e arsyeve madhore, sërish kishte kërkesa për dhënie autorizimi nga kryetarët e bashkive për ndryshimin e qendrave të votimit si në ambiente publike ashtu edhe në private.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar përtej këtij afati, sipas kërkesave të referuara nga kryetarët e bashkive, dhënien e autorizimit për ndryshimin e 39 vendndodhjeve të QV-ve në ambiente private me 5 (pesë) vendime.

QV të posaçme të ngritura me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me kërkesë të KZAZ, bazuar në vendimet e gjykatës:

KZAZ 45, Bashkia Belsh

KZAZ 79, Bashkia Tepelenë

Numri i qendrave të votimit të krijuara për zgjedhjet e datës 14 maj 2023 ishte 5,213⁴ Qendra Votimi. Nga këto QV 20 ishin qendra të posaçme votimi, dhe 333 prej tyre u vendosën në objekte private me miratimin e KQZ-së.

3. Vendet e numërimit të votave

Edhe në këto zgjedhje prefektët propozuan VNV në të njëjtën vendndodhje me zgjedhjet e kaluara të vitit 2021. Në disa VNV ambientet nuk ishin plotësisht të përshtatshme për të akomoduar numrin e madh të vëzhguesve dhe kandidatëve përgjatë procesit të numërimit duke diktuar ndërhyrjen e KZAZ-së apo edhe të Policisë së Shtetit.

Në këtë proces zgjedhor nuk pati kërkesë për ndryshimin apo dhënie autorizimi për vendndodhjen e VNV-ve.

Seksioni 10: Dokumentacioni zgjedhor

Dokumentacioni Zgjedhor dhe materialet e votimit janë dy kategori të rëndësishme për miradministrimin e zgjedhjeve. KQZ nën kujdesin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve identifikoi dhe rikonceptoi dokumentacionin e punës të cilat nga verifikimi paszgjedhor rezultuan me pasaktësi përgjatë administrimit si dhe ridizenjoi dhomat e fshehtësisë për të rritur standardin e garancisë së fshehtësisë së votës. Gjithashtu një risi në zgjedhjet e 14.5.2023 ishin edhe përdorimi i pullave/etiketave të sigurisë për objektet zgjedhore të cilat lehtësuan koordinimin e sigurisë së ambienteve të votimit me policinë e shtetit dhe KQV-të si dhe ishin një vlerë e shtuar për sigurimin e këtyre ambienteve.

KQZ rikonceptoi Librin e Protokollit të Mbledhjeve për KQV, si dhe udhëzuesit e punës duke synuar lehtësimin në përdorim nga përdoruesit fundor, si dhe procesverbalet që duhet të plotësoheshin nga administrata zgjedhore për të kërkuar ndihmën e policisë së shtetit në raste të veçanta apo për sigurinë e objekteve të votimit.

KZAZ ndonëse kishin detyrim të paraqisnin në KQZ vendimmarrjet dhe listat për kandidatë, lista e komisioneve të QV dhe GNV nën juridiksionin e tyre, si dhe të vëzhguesve, shfaqën vështirësi pavarësisht alternativave për dërgimin e tyre në format elektronik apo edhe shkresor.

Nga administrimi i dokumentacionit të punës nga ana e KZAZ-ve janë vërejtur problematika lidhur me:

- Mosevidentimin e shkeljes së afateve nga subjektet zgjedhore për propozimet për KQV, GNV e vëzhgues në regjistrin e vendimeve dhe në LPM,
- Marrjen e vendimeve jashtë afatit për ngritjen e KQV-ve (rreth 800 vendime),

⁴ QV e posaçme nr. 2224/01 në KZAZ 43, Bashkia Rrogozhinë, nuk përfshihet.

- Raportim i mangët apo i paplotë i problematikave në librin e protokollit të mbledhjeve (vetëm 4 problematika të raportuara në LPM),
- Mosevidentimin e komunikimeve me Policinë e Shtetit për shpërndarjen e bazës materiale të zgjedhjeve,
- Mungesën e dokumentacionit të anëtarëve të KQV/ vëzhgues dhe GNV,
- Mospërputhshmërinë e emrave në vendime me anëtarët e KQV-së prezent në ditën e zgjedhjeve.

Këto problematika të vërejtura dëshmojnë se administrimi manual i dokumentacionit duhet ridimensionuar në kuadër të përdorimit të teknologjisë në automatizimin e disa proceseve redundante apo edhe të rëndësishme në vend të përdorimit të mënyrave manuale të administrimit të dokumentacionit.

Pas administrimit të dokumentacionet të punës është konstatuar se për 92 KZAZ janë evidentuar:

- 22,400 vendime,
- 2,000 korrespondenca,
- Afërsisht 2,100 mbledhje.

Seksioni 11: Regjistrimi i Subjekteve, fushata zgjedhore

1. Regjistrimi i subjekteve zgjedhore

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 100, datë 08.03.2023 caktoi numrin e kandidatëve në listat shumemërore të paraqitura nga subjektet zgjedhore për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të Kodit Zgjedhor, pas shqyrtimit administrativ dhe dokumentacionit përkatës ka vendosur si vijon:

- Të regjistrojë si subjekte zgjedhore 48 parti politike;
- Të regjistrojë 2 koalicione zgjedhore;
- Të regjistrojë 15 Komitete Nismëtare, nga të cilët 12 kandidatë janë të propozuar nga zgjedhësit.

Nga sa më sipër:

- 44 subjekte zgjedhore, kanë depozituar kandidatë për kryetar bashkie/lista shumemërore,
- 4 subjekte zgjedhore nuk kanë propozuar kandidatë pasi nuk zotëronin asnjë mandat në Kuvend ose në organet e qeverisjes vendore dhe nuk kanë mundur të mbledhin firma mbështetëse (nënshkrime) për të propozuar kandidatë .
- 38 subjekte zgjedhore kanë depozituar lista shumemërore me lista të mëvetme;
- 6 subjekte zgjedhore janë pjesë e 2 koalicioneve dhe kanë depozituar lista shumemërore me kandidat të përbashkët.

Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 janë regjistruar në total 23.907 kandidatë, 23.763 kandidatë për anëtarë të këshillit bashkiak dhe 144 kandidatë për kryetar bashkie, nga të cilat 12.131 (dymbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e një) janë të gjinisë mashkullore dhe 11.811 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëmbëdhjetë) janë të gjinisë femërore.

Pas përfundimit të procesit zgjedhor rezultojnë se kandidatët fitues si anëtar këshilli bashkiak në total janë 1613, kandidatët për kryetar bashkie në total janë 61.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda afatit të parashikuar në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike” dhe vendimin nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, fillimisht verifikoi *prima facie* nëse ndonjë nga rrethanat përfshihej në fushën e veprimit të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, si dhe kërkoi informacion për kandidatët nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për historinë e ndryshimit të gjenealiteteve dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për verifikimin e gjendjes gjyqësore të tyre.

Nga verifikimi i 23.907 kandidatëve rezultoi se:

- 967 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) kandidatë kishin deklaruar dënim/dëbim/masë shtrënguese;
- 22.940 (njëzet e dy mijë e nëntëqind e dyzet) kandidatë nuk kishin deklaruar asnjë dënim;
- 7.802 (shtatë mijë e tetëqind e dy) kandidatë kanë rezultuar me ndryshime në gjenealitete.

a. Fondet paradhënie për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore

Me vendimin nr. 397, datë 22.4.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t’u shpërndahet si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”, u vendos shpërndarja si paradhënie, e fondeve të vëna në dispozicion nga Buxheti i Shteti për partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023. Vetëm 14 parti politike përfituan fonde paradhënie nga 44 parti politike që morën pjesë në zgjedhje. Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të këtij vendimi, përpara shpërndarjes së fondeve, partitë përfituese (kryetari ose person i autorizuar) nënshkruan akt- marrëveshjen, në të cilën u përcaktua se partia politike pranoi fondin e dhënë, se do ta përdorte atë në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara, pranonte auditimin e shpenzimeve të tyre prej subjektit dhe kandidatëve të tij, si dhe do të respektonte të gjitha ndalimet që përcaktohen në Kodin Zgjedhor. Fondet u shpërndanë si më poshtë:

Nr.	Partia Politike	Fondi që përfitohet (lekë)
-----	-----------------	----------------------------

1	Partia Demokratike (PD)	24.963.584.24
2	Partia Republikane (PR)	3,012,429.13
3	Partia Aleanca Progresiste L.ZH.K	1,100,255.80
4	Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)	42.833,466.73
5	Partia e Lirisë (PL)	15,594,215.8
6	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU)	4,260,606.71
7	Partia Fryma e Re Demokratike (FRD)	1,194,064.75
8	Partia Demokracia Sociale (PDS)	1,123,779.90
9	Partia Socialdemokrate (PSD)	0
10	Bindja Demokratike (BD)	639,798.69
11	Partia e Gjelbër (P.GJ)	797,915.09
12	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë (ADK)	448,974.27
13	Aleanca Arbnore Kombëtare (AAK)	532,820.88
14	Partia Uniteti Kombëtar (PUK)	562,618.08
TOTALI		97,064,530.08

b. Fushata zgjedhore – raportime

Referuar nenit 92/3, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, subjektet zgjedhore kanë detyrimin të depozitojnë raportet financiare për fushatën zgjedhore brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Për sa më sipër, Komisioni Rregullator më datë 7.04.2023, miratoi vendimin me nr. 15, “Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Në datën 6.05.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori vendimin me nr. 458, “Për raportimin financiar në Platformën Elektronike të Raportimit Financiar (PERF) nga subjektet zgjedhore, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”. Vendimet e sipërcituara parashikojnë afatet e dorëzimit, formatet e standardizuara, si dhe mënyrën se si do të plotësohen këto formate për të gjithë kandidatët e regjistruar në zgjedhje. Referuar vendimit me nr. 458 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, detyrimin për të raportuar në PERF në këto zgjedhje, e kishin partitë politike, si dhe kandidatët për kryetar bashkie, duke përjashtuar nga ky detyrim kandidatët e listave shumemërore.

PERF është një platformë elektronike që u mundësua dhe financua nga Bashkimi Evropian dhe u implementua nga Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë. Qëllimi i kësaj platforme është të rrisë transparencën dhe përmirësojë cilësinë e të dhënave sa i takon financimit të partive politike, por edhe monitorimit të fushatave zgjedhore. Përdorues të kësaj platforme janë:

- partitë politike (personat përgjegjës për raportimin financiar, kryetari i partisë ose një person tjetër i caktuar prej tij/saj për të miratuar raportimin, kandidatët);
- monitoruesit në terren të fushatës zgjedhore;
- administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Me qëllim mbarëvajtjen e procesit e për të lehtësuar tranzicionin e raportimit nga ai manual në letër në atë elektronik u organizuan disa takime konsultuese me përdoruesit si dhe 4 seanca trajnimi gjatë periudhës shkurt – nëntor 2023. PERF shoqërohet me manuale përdorimi dhe video tutoriale për çdo përdorues të kësaj platforme. Platforma mund të aksesohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në linkun: [KQZ-Identity-Ui](#)

Nga 46 (dyzet e gjashtë) subjekte të regjistruara në zgjedhje vetëm 35 (tridhjetë e pesë) subjekte dorëzuan në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportin financiar për fushatën zgjedhore të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, brenda afateve të përcaktuara. 30 (tridhjetë) nga këto 35 (tridhjetë e pesë) subjekte zgjedhore që e dorëzuan raportin financiar, respektuan detyrimin e dorëzimit të raportit financiar nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar (PERF), ndër të cilët 2 (dy) raporte të kandidatëve për kryetar bashkie të propozuar nga zgjedhësit. 5 (pesë) subjekte zgjedhore e dorëzuan dokumentacionin duke mos përmbushur kriteret për raportim. Të gjitha raportet e dorëzuara nëpërmjet PERF janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së, në linkun: [KQZ](#)

Aktualisht, gjatë vitit 2024, do të vijohet faza e dytë e projektit për upgrade (përmirësimin) e kësaj platforme, sërisht me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Faza e dytë parashikon kalimin e auditimit në Platformë, përmirësimin e cilësisë së të dhënave të raportuara në kuptim të të dhënave të hapura si dhe përmirësimin e të dhënave të publikuara online për interes të publikut dhe grupeve të interesit që konsumojnë këto të dhëna për qëllime të transparencës dhe/ose studime.

c. Monitorimi i fushatës zgjedhore në terren


Në muajin dhjetor 2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpalli thirrjen publike për shprehje interesi për t'u punësuar si monitorues për fushatën zgjedhore. Pas përzgjedhjes, shpërndarja e 120 (njëqind e njëzet) monitoruesve u bë në bazë të vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si më poshtë:

- Vendimi nr. 10, datë 9.1.2023, “Për përzgjedhjen e monitoruesve për bashkinë Tiranë, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”;
- Vendimi nr. 13, datë 13.1.2023, “Për përzgjedhjen e monitoruesve për bashkitë Berat, Kuçovë, Poliçan, Skrapar, Dimal, Bulqizë, Dibër, Klos, Mat, Durrës, Krujë,

Shijak, Cërrik, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Prrenjas, Divjakë, Fier, Lushnje, Mallakastër, Tepelenë, Devoll, Kolonjë, Korçë, Maliq, Pogradec dhe Pustec, Has, Kukës, Tropojë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Fushë- Arrëz, Malësia e Madhe, Pukë, Shkodër, Vau Dejës, Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë, Vorë, Finiq, Himarë, Konispol, Sarandë, Selenicë, Vlorë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”;

- Vendimi nr. 14, datë 14.1.2023, “Për përzgjedhjen e monitoruesve për Bashkinë Gjirokastrë dhe Bashkinë Delvinë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”, të cilët monitoruan veprimtaritë e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.

Në janar 2023 u zhvillua trajnimi për 120 (njëqind e njëzet) monitoruesit e caktuar. Programi i trajnimit përfshiu njohuri mbi aspektin ligjor dhe atë praktik mbi përgjegjësitë dhe detyrat që monitoruesit kanë gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore. Monitoruesit raportuan në kohë reale nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar. Për periudhën shkurt 2023 deri ditën e zgjedhjeve monitoruesit e KQZ përpiluan raporte monitorimi ditore dhe të ndërmjetme duke evidentuar dhe dokumentuar aktivitetet e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në 61 bashki. Në total gjatë kësaj periudhe u dorëzuan 1775 raporte monitorimi. Raportet u publikuan në faqen elektronike zyrtare të KQZ-së, si dhe gjatë hetimit administrativ të denoncimeve monitoruesit u angazhuan në terren për verifikimin e tyre. Këto raporte mund të aksesohen në linkun: KQZ



Gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, u respektua pjesërisht. Vetëm 48 nga 61 bashki sollën në KQZ vendimin për vend-afishimet e lejuara të materialeve propagandistike për fushatën zgjedhore. Lidhur me sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori vendimet si më poshtë vijon:

- Vendimi nr. 452, datë 6.5.2023, “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 7 mars deri 2 maj 2023”;
- Vendimi nr. 482, datë 10.5.2023, “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 2 maj deri më 8 maj 2023”;
- Vendimi nr. 496, datë 11.5.2023, “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 9 maj deri më 10 maj 2023”; për heqjen e menjëhershme të materialeve propagandistike, si dhe mbylljen e menjëhershme të zyrave zgjedhore në kundërshtim me aktet e KQZ-së.

Nga monitoruesit e caktuar nga KQZ për monitorimin e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore u konstatuan zyra zgjedhore të hapura nga subjektet zgjedhore në kundërshtim me udhëzimin nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Pas konstatimeve të monitoruesve Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimeve të sipërcituara ka urdhëruar mbylljen e menjëhershme të zyrave zgjedhore në shkelje të dispozitave ligjore.

Ndërkohë për kryetarët e 13 bashkive, të cilët nuk dorëzuan në KQZ vendimet për vend-afishimet e lejuara të materialeve propagandistike për fushatën zgjedhore, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 466, datë 8.5.2023 propozoi marrjen e masave administrative, gjobë.

d. Kompensimi financiar pas zgjedhor

Me vendimin nr. 727, datë 24.8.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përcaktoi vlerën në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023. Ky vendim shërben për përlllogaritjen e shumës që do t’u ndahet subjekteve zgjedhore në zgjedhjet e ardhshme. Vlera në para e një vote të vlefshme është 80.47 lekë.

Gjithashtu Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi t’u shpërndajë si kompensim financiar paszgjedhor atyre subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 14 maj 2023, të cilat nuk kishin përfituar fonde paradhënie dhe morën më shumë se 1% të votave. Nga kompensimi financiar paszgjedhor përfituan 3 subjekte zgjedhore, si më poshtë vijon:

- Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë;
- Partia Lëvizja e Legalitetit;
- Aleanca Liberale e Djathtë.

Në muajin dhjetor u hodh shorti për caktimin e audituesve ligjorë që do të auditojnë raportet financiare për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Ky proces do të vijojë në fillim të vitit 2024.

Seksioni 12: Media në fushatën e zgjedhjeve

Kodi Zgjedhor ka parashikuar monitorimin e medias audiovizive për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partive, apo koalicioneve të regjistruara në zgjedhje. Monitorimi i tyre lidhet me faktin nëse këto të fundit e respektojnë hapësirën kohore që duhet të venë në dispozicion të partive politike e kandidatëve, nëse materialet e transmetuara prej tyre janë në përputhje me dispozitat ligjore (të jenë në përputhje me kriteret profesionale të pasqyrimin të lajmit/aktivitetit/veprimtarisë, dhe nëse e respektojnë ndalimin për të bërë propagandë/komente dhe qëndrime personale gjatë raportimit të lajmeve).

Gjatë periudhës zgjedhore u zhvillua një tryezë konsultimi për rolin dhe përgjegjësinë e medias, si dhe gjuha e urrejtjes dhe standardet etike gjatë fushatës zgjedhore. Kjo tryezë u zhvillua në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës dhe Prezenca e OSBE në Shqipëri me pjesëmarrës përfaqësues nga Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gazetarë nga televizione të ndryshme kombëtare, si dhe përfaqësues të organizatave e partnerë ndërkombëtarë: IDEA, Faktoje.al, NDI Albania, EDM, BIRN, ASP, etj.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ju drejtua zyrtarisht të gjitha televizioneve mbi sjelljen në vëmendje të disa rregullave për t'u zbatuar gjatë fushatës zgjedhore, si dhe RTSH-së dhe AMA-s për t'i përcjellë vendimin e KSHZ, "Për përcaktimin e kohës së transmetimit në radiotelevizionin publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023". 21 (njëzet e një) Ofrues të Shërbimit Mediatik Audioviziv dorëzuan në KQZ brenda afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor tarifat zyrtare të transmetimit të reklamave politike, ndër të cilat 2 (dy) Ofruesve të Shërbimit Mediatik Audioviziv deklaruan se nuk do të transmetonin reklama politike për zgjedhjet e datës 14 maj.

Gjatë periudhës zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administroi dhe shqyrtoi raportet e ndërmjetme dhe përmbledhëse të Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA) në lidhje me tarifat dhe kohën e minutazhit të venë në dispozicion të subjekteve zgjedhore nga mediat në vend. Në total u dorëzuan 3 (tre) raporte periodike duke filluar nga data 14.4.2023. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në bazë të raportimeve të AMA-s për Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv gjatë shqyrtimit të raporteve në seancë publike vendosi sanksione për disa nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv, për mospërmbushje të detyrimeve ligjore.

Seksioni 13: Edukimi i zgjedhësve dhe informimi publik

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi Programin e Edukimit, Informimit dhe Ndërgjegjësimin të Zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 14 majit 2023.

Gjithashtu në dhjetor të vitit 2022, për herë të parë u miratuan 2 vendime të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilat u vendos që respektivisht për (1) pakicat kombëtare dhe (2) personat me aftësi të kufizuar (PAK) të ketë programe të veçanta në vazhdim. Këto programe kishin si qëllim të mirë informonin dhe ndërgjegjësonin zgjedhësit, duke përcjellë njohuri mbi të gjithë hapat e procesit zgjedhor

dhe besimin në vlerën që ka vota.

Përgjatë gjithë periudhës zgjedhore, u zhvilluan takime me organizatat e shoqërisë civile që mbrojnë interesat e target grupeve të ndryshme, takime me të gjithë anëtarët e Komunitetit të pakicave kombëtare, për evidentimin e zonave ku zgjedhësit e këtyre pakicave jetojnë dhe votojnë.

Fushatë intensive është bërë edhe për përdorimin e teknologjisë në zgjedhje, për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik (PEI) dhe pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) në tre bashkitë ku u pilotua projekti.

Implementimi i programeve të edukimit

Programi i Edukimit u nda në objektiva të rëndësishme për të arritur qëllimin e përbashkët për mirë informimin dhe edukimin e zgjedhësve, po ashtu kundër disinformimit në implementimin e teknologjisë në zgjedhje.

Objektivat si me poshtë:

- 1. FUSHATA “KONTROLLO EMRIN NË LISTËN E ZGJEDHËSVE”**
- 2. FUSHATA “HAPAT E PROCESIT TË VOTIMIT”**
- 3. FUSHATA “KRIMET ZGJEDHORE/SHITBLERJA E VOTËS”**
- 4. FUSHATA “THIRRJA PËR PJESËMARRJE NË ZGJEDHJE”**
- 5. FUSHATA “IDENTIFIKIMI ELEKTRONIK”**
- 6. FUSHATA “VOTIMI DHE NUMËRIMI ELEKTRONIK” NË 3 BASHKITË: ELBASAN, VORË, KAMËZ**
- 7. FUSHATA “VEPRIMTARITË E NDALUARA DHE PËRDORIMI I BURIMEVE PUBLIKE”**
- 8. TË RINJTË/VOTUES PËR HERË TË PARË**
- 9. FUSHATA “PAKICAT KOMBËTARE”**
- 10. FUSHATA “GRATË NË PROCESIN ZGJEDHOR”**
- 11. PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR**
- 12. PLOTËSIMI I FLETËS SË VOTIMIT**
- 13. MË SKANO! KONTROLLO QENDRËN E VOTIMIT**

1. FUSHATA “KONTROLLO EMRIN NË LISTËN E ZGJEDHËSVE”

Edukimi, informimi dhe ndërgjegjësimi i shtetasve mbi Listën e Zgjedhësve dhe Qendrën e Votimit. Mesazhet që kemi përcjell kanë qenë : Çdo zgjedhës duhet të kontrollojë emrin e tij në Listën e Zgjedhësve dhe të verifikojë Qendrën e Votimit ku do të votojë.

Mjetet:

- 1) Spote televizive;
- 2) Spote radiofonike;

- 3) LedWall;
- 4) Veshje ‘baner’ autobus;
- 5) Stacionet e autobusëve;
- 6) City Lights;
- 7) Media sociale;
- 8) Media online;
- 9) Konferenca për shtyp;
- 10) Takime me target/grupe;
- 11) Media e shkruar;
- 12) Aplikacioni “KQZ”;

1) Spote televizive

U prodhuan spote televizive me një gjatësi kohore prej 41 sekonda.

Periudha e transmetimit të spotit filloi në datën **10.03.2023** dhe përfundoi në **10.04.2023**.

Përmbajtja e spotit: U ftuan qytetarët të kontrollonin emrin në Listën e Zgjedhësve për të verifikuar saktësinë e të dhënave të emrit të tyre, si dhe qendrën e votimit. Spoti tregon se ku mund të kontrollohet Lista e Zgjedhësve: në www.kqz.gov.al, në zyrat e Gjendjes Civile në Njësitë Vendore, e të tjera. Spoti u transmetua në të gjitha kanalet televizive kombëtare (**4**), si dhe në kanalet televizive rajonale dhe kablllore/lokale në një total prej 46, në **8 gjuhët e pakicave** si dhe në **gjuhën e shenjave** sipas një media plani mesatarisht 560 transmetime në ditë në total. Në total spoti për të gjithë periudhën u transmetua **11,270 herë** në të gjithë televizionet e përzgjedhura. Spoti u transmetua edhe në të dy platformat televizive pay per view.

Për të parë spotin televiziv klikoni në këtë link:

<https://www.youtube.com/watch?v=IMpThBbëaB4>;

<https://www.youtube.com/watch?v=XXP5aV3BGMg>.

2) Spotet radiofonikë

U prodhua spot radiofonik me një gjatësi kohore prej 30 sekondash.

Periudha e transmetimit të spotit radiofonik filloi në datën **26.01.2023** dhe përfundoi në **08.04.2023**.

Përmbajtja e spotit: Nëpërmjet këtij spoti u ftuan qytetarët të kontrollonin Listën e Zgjedhësve për të verifikuar saktësinë e të dhënave të emrit të tyre, si dhe qendrën e votimit. Spoti tregon se ku mundej të kontrollohej Lista e Zgjedhësve: në www.kqz.gov.al, në zyrat e Gjendjes Civile në njësitë vendore. Spoti u transmetua në të gjitha stacionet radiofonike kombëtare **3 (tre)**, si dhe në **3 (tre)** stacione radiofonike lokale. Spoti është transmetuar në total **15.330 herë** në radiot e përzgjedhura.

3) Ledwall

U prodhuan 2 spote për formatin Ledwall me gjatësi 15 sekonda.

Periudha e transmetimit të spotit të parë nga 06.03.2023 deri më 08.04.2023

Periudha e transmetimit të spotit të dytë nga 04.05.2023 deri më 14.05.2023

Përmbajtja e spotit të parë: Ftohen qytetarët të kontrollojnë emrin në Listën e Zgjedhësve në www.kqz.gov.al dhe pranë Njësive Administrative, nëse të dhënat nuk janë të sakta, ftohen t'i drejtohen Zyrave të Gjendjes Civile për t'i ndryshuar ato.

Përmbajtja e spotit të dytë: Kontrolllo qendrën e votimit "Më Scano!" Ky spot përmbante një QR Code, i cili qëndronte statik duke u dhënë mundësi qytetarëve të skanonin dhe gjenin Qendrën e tyre të Votimit nëpërmjet aplikacionit "KQZ".

Të dy spotet u transmetuan në **13 ekrane led**, me zona të alternuara.

Spoti i parë u transmetua në led 90 herë në ditë, me një total prej **2700 herë** transmetimi për gjithë periudhën.

Spoti i dytë u transmetua në led 90 herë në ditë, me një total prej **900 herë** transmetim për të gjithë periudhën.

4) Veshje baner autobus

Baneri për të kontrolluar emrin në Listën e Zgjedhësve u vendos edhe në **5 linja** autobusi urbanë.

Periudha e banerit në autobusë ishte nga 26.01.2023 deri në 08.04.2023.

Përmbajtja: Ftohen qytetarët të kontrollojnë emrin në Listën e Zgjedhësve në www.kqz.gov.al dhe pranë njësive administrative, nëse të dhënat nuk janë të sakta, ftohen t'i drejtohen zyrave të Gjendjes Civile për t'i ndryshuar ato.

Autobusët janë përzgjedhur në linjat me më shumë lëvizje dhe përqëndrim të qytetarëve.

5) Stacionet e autobusëve

Në stacionet e autobusëve në qytetet Tiranë, Elbasan dhe Fier në zonat me përqëndrim të minoritetit rom dhe egjiptian, u vendosën postera me thirrjen për të kontrolluar emrin në Listën e Zgjedhësve në gjuhën rome dhe shqipe.

Periudha e qëndrimit të tyre nga data 08.03.2023 deri më 14.05.2023.

Përmbajtja: Ftohen qytetarët të kontrollojnë emrin në Listën e Zgjedhësve në www.kqz.gov.al dhe pranë njësive administrative, nëse të dhënat nuk janë të sakta, ftohen t'i drejtohen zyrave të Gjendjes Civile për t'i ndryshuar ato.

Këto postera u prodhuan dhe u vendosën me mbështetjen e Qeverisë Britanike.

6) City Lights

Në qytetet Tiranë, Elbasan dhe Fier në zonat me përqëndrim të minoritetit rom dhe egjiptian u vendosën city lights për të kontrolluar emrin në Listën e Zgjedhësve në gjuhën rome dhe shqipe.

Periudha e qëndrimit të tyre nga data 08.03.2023 deri më 14.05.2023

Përmbajtja: Ftohen qytetarët të kontrollojnë emrin në Listën e Zgjedhësve në www.kqz.gov.al dhe pranë njësive administrative, nëse të dhënat nuk janë të sakta, ftohen t'i drejtohen zyrave të Gjendjes Civile për t'i ndryshuar ato.

Këto postera u prodhuan dhe u vendosën me mbështetjen e Qeverisë Britanike.

7) Mediat sociale

Në rrjetet sociale janë shpërndarë postera dhe video/mesazhe për të kontrolluar emrin në Listën e Zgjedhësve.

Periodha e publikimit ishte nga data 09.01.2023 deri më 14.05.2023.

Pëmbajtja e posterave dhe video/mesazhe ishte që qytetarët të kontrollonin emrin në Listën e Zgjedhësve në www.kqz.gov.al dhe pranë njësive administrative, nëse të dhënat nuk ishin të sakta, ftohen t'i drejtohen zyrave të Gjendjes Civile për t'i ndryshuar ato.

Janë prodhuar dhe transmetuar videomesazhe të financuara nga Qeveria Britanike nga grup moshë të profesioneve të ndryshme, të cilët jepnin mesazhin për të kontrolluar emrin në Listën e Zgjedhësve, pranë njësive administrative ose në faqen www.kqz.gov.al të përshtatura për rrjetet sociale.

Transmetimi/publikimi është kryer nëpërmjet rrjeteve sociale të KQZ në Facebook, Instagram, Tëitter, Youtube përmes faqeve zyrtare “KQZShqiperi” dhe “Vendore2023”.

Shikueshmëria në total në të gjitha rrjetet sociale të KQZ ka qenë rreth **1.7 milionë** përdorues unikë në harkun e **30** ditëve, sipas statistikave të AgencyAnalytics.

8) Media online

U prodhua baner për publikimin në median online për të kontrolluar emrin në Listën e Zgjedhësve.

Periodha e publikimit të banerit nga 10.03.2023 deri në 10.04.2023.

Përmajtja ishte për qytetarët të kontrollonin emrin në Listën e Zgjedhësve në www.kqz.gov.al dhe pranë njësive administrative, nëse të dhënat nuk janë të sakta, t'i drejtoheshin zyrave të Gjendjes Civile për t'i ndryshuar ato.

Baneri qëndroi në **30 faqe web** të televizioneve kombëtare, lokale/rajonale të përzgjedhura për 30 ditë.

9) Konferenca shtypi

Në konferenca për shtyp, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në mënyrë periodike ka bërë apel për të kontrolluar emrin në Listën e Zgjedhësve, ku mund të gjejnë Qendrën e Votimit, si dhe çfarë rruge duhet të ndjekin zgjedhësit për të korrigjuar pasaktësitë në Listën e Zgjedhësve, kur është rasti.

Gjithashtu në të gjitha daljet publike, konferenca shtypi, apo seanca publike, në krah të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka qenë i vendosur një baner elektronik me sloganin “Kontrollo emrin në Listën e Zgjedhësve”, që qëndroi deri në 10.04.2023.

10) Takimet me target-grupet

Takimet për të kontrolluar emrin në Listën e Zgjedhësve dhe qendrat e tyre të votimit janë zhvilluar në të gjithë vendin.

Periodha e takimeve ka qenë nga janari i vitit 2023 edhe në vazhdim.

Pëmbajtja e takimeve: Në fokus ishin të rinjtë votues për herë të parë, të cilëve u shpjegohej rëndësia e votës, hapat e procesit të votimit, shitblerja e votës, fshehtësia e saj etj, të gjitha këto në formë bashkëbisedimi, i cili mbyllet me një proces simulimi të votimit nga vetë nxënësit.

Takime në total në **29 gjimnaze** me të rinjtë, votues për herë të parë.

Këto takime janë mundësuar edhe me mbështjetjen e Qeverisë Britanike.

Për të parë videon klikoni në:

<https://www.youtube.com/watch?v=ëY8qTl7AkfA;>

<https://www.youtube.com/watch?v=G29LonbxOuo>;
<https://www.youtube.com/watch?v=ë3fA5r45VpQ>;
<https://www.youtube.com/watch?v=R4odER8iT7Q>;
<https://www.youtube.com/watch?v=MKqzd24mqtg>;
<https://www.youtube.com/watch?v=p9RiysejgHc>;
<https://www.youtube.com/watch?v=tmBkT-Pë0Q4>;
https://www.youtube.com/watch?v=ëkn_tT_zQ3c;
https://www.youtube.com/watch?v=yiNsszpNi_I;
<https://www.youtube.com/watch?v=0eqN61hmS5o>;
<https://www.youtube.com/watch?v=3kktVfGmFqI>;
<https://www.youtube.com/watch?v=8-32O8iq94Y>;

11) Media e shkruar

Posterat me “Kontrollo Emrin në Listën e Zgjedhësve” janë publikuar edhe në **dy gazeta** (media e shkruar), me numër të konsideruar lexuesish, kryesisht të moshës së tretë.

Periudha e publikimit në media ka qenë nga **10.03. 2023** deri në **10.04.2023**.

12) Aplikacioni “KQZ”

Aplikacioni “KQZ” për pajisje komunikimin inteligjent për t’i ardhur në ndihmë zgjedhësve duke kontrolluar emrin e tyre në Listën e Zgjedhësve, qendrën e votimit, apo informacione të tjera rreth procesit zgjedhor në platformat IOs dhe Android.

Për aplikacionin klikoni në <https://play.google.com/store/apps/details?id=com.kqz.app.kqz>.

2. FUSHATA “HAPAT E PROCESIT TË VOTIMIT”

Qëllimi: Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit, hapat që ndjek zgjedhësi në Qendrat e Votimit, së bashku me identifikimin elektronik të zgjedhësve.

Mjetet:

- 1) Spote televizive;
- 2) Postera;
- 3) LedWall;
- 4) Citylight;
- 5) Stacionet e autobusëve;
- 6) Media sociale;
- 7) Media online;
- 8) Takime me target/grupe;
- 9) Media e shkruar;
- 10) Aplikacioni “KQZ”;

1) Spoti televiziv

U prodhuan spoti televiziv me një gjatësi prej **1 minutë e 20 sekonda**.

Periudha e transmetimit të këtij spoti ka qenë nga 29.03.2023 deri në 14.05.2023.

Përmbajtja e spotit: Hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit, identifikimi elektronik, që mundësohet nga pajisja e identifikimit elektronik (PEI).

Spoti u transmetua në **46** kanale televizive kombëtare, rajonale, kabllore/lokale sipas një mediaplani me një total **6900** transmetime për gjithë periudhën.

Për të parë linkun klikoni në: <https://www.youtube.com/watch?v=vzDAH5C10o>.

2) Led Wall

U prodhuan spoti “Hapat për të Votuar” me një gjatësi 15 sekonda.

Periudha e transmetimit të spotit të parë ishte nga 08.04.2023 deri në 14.05.2023, i alternuar edhe me spotet e tjera

Përmbajtja e spotit: Hapat/veprimet që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit, dhe identifikimi elektronik që mundësohet nga pajisja e identifikimit elektronik (PEI).

Spoti u transmetua në 13 Led Wall **360 herë** në ditë me frekuencë **1 herë në 4 minuta** të vendosur në të gjithë Shqipërinë.

Gjithsej është shfaqur **168.480** herë.

3) City Lights

U prodhuan posterat me “Hapat për të Votuar” në formatin 120 cm me 180 cm.

Janë vendosur në **20 City Lights** me shikueshmëri nga 20.000- 35.000 kalimtarë.

Periudha e qëndrimit të tyre nga data 08.04.2023 deri më 14.05.2023, në qytetet Tiranë, Shkodër, Berat, Fier dhe Durrës.

Përmbajtja e posterave: Hapat/veprimet që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe identifikimi elektronik që mundësohet nga pajisja e identifikimit elektronik (PEI).

4) Postera

Janë prodhuar **11 mijë postera** me “Hapat për të Votuar”, në formatin B2.

Përmbajtja e posterave: Hapat/veprimet që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe identifikimi elektronik që mundësohet nga pajisja e identifikimit elektronik (PEI).

Posterat janë vendosur **në çdo qendër votimi** në të gjithë vendin (**5213 gjithsej**)

1 mijë postera u vendosën në qendrat e votimit, ku jetojnë pakicat kombëtare në gjuhët që ata flasin.

5) Stacionet e autobusëve

U prodhuan dhe u vendosën posterat “Hapat për të Votuar” në stacionet e autobusëve në formatin 120

cm me 180 cm.

Përmbajtja e posterave: Hapat/veprimet që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe identifikimi elektronik që mundësohet nga pajisja e identifikimit elektronik (PEI).

Janë vendosur posterat në **20 stacionet e autobusëve** me më shumë lëvizje të qytetarëve.

Periodha nga 01.04.2023 deri në 14 maj 2023, për **45 ditë**.

6) Mediat sociale

Në rrjetet sociale janë shpërndarë postera dhe video/mesazhe për hapat e votimit.

Periodha e publikimeve nga 01.04.2023 deri në 14.05.2023.

Përmbajtja e posterave dhe video/mesazheve: Informimi për hapat e votimit, veprimet që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe identifikimi elektronik që mundësohet nga pajisja e identifikimit elektronik (PEI).

Transmetimi/publikimi është kryer nëpërmjet rrjeteve sociale të KQZ në Facebook, Instagram, Twitter, Youtube përmes faqeve zyrtare “KQZShqiperi” dhe “Vendore2023”.

Shikueshmëria në total në të gjitha rrjetet sociale të KQZ ka qenë rreth **1.7 milionë** përdorues unikë në harkun e **44 ditëve**, sipas statistikave të AgencyAnalytics.

7) Media online

U prodhua baner për transmetimin në median online për “Hapat e Votimit”.

Periodha e transmetimit të banerit nga 29.03.2023 deri në 14.05.2023.

Përmbajtja e banerit: Hapat/veprimet që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe identifikimi elektronik, që mundësohet nga pajisja e identifikimit elektronik (PEI).

Baneri qendroi në **30 faqe Web** të televizioneve kombëtare, lokale/rajonale, të përzgjedhura për 45 ditë.

8) Takime me target/grupet

Takimet për hapat/veprimet që ndjekin zgjedhësit në Qendren e Votimit janë zhvilluar në të gjithë vendin.

Periodha e takimeve ka qënë nga janari i vitit 2022 deri më qershor 2022 dhe nga shtatori 2022 deri në maj 2023.

Përmbajtja e takimeve ka qenë me fokus të rinjtë votues për herë të parë, të cilëve u shpjegohej rëndësia e votës, hapat e procesit të votimit, fshehtësia e votës etj, të gjitha këto në formë bashkëbisedimi, i cili mbyllej me një proces simulimi të votimit nga vetë nxënësit.

Takime në total në **29 gjimnaze** me të rinjtë, votues për herë të parë.

Këto takime janë mundësuar edhe me mbështjetjen e Qeverisë Britanike.

Për të parë videot klikoni në link-un më poshtë:

<https://www.youtube.com/watch?v=081zPc-IlyU>

<https://www.youtube.com/watch?v=xGx1tgqTaUU>

<https://www.youtube.com/watch?v=GmyRËlQ9nyg>

<https://www.youtube.com/watch?v=AivmkSrzi0>

<https://www.youtube.com/watch?v=rURJ54HUINs>

<https://www.youtube.com/watch?v=btIzAyogIzA>

<https://www.youtube.com/watch?v=skNsDdkfr2M>

<https://www.youtube.com/watch?v=2yO-662y3ZA>

9) Media e shkruar

Posterat me “Hapat e Votimit” janë publikuar edhe në **dy gazeta** (media e shkruar), me numër të konsideruar lexuesish, kryesisht të moshës së tretë.

Periudha e publikimit në këto media ka qenë nga **01.04.2023** deri në **14.05.2023**.

Pëmbajtja e posterave dhe video/mesazheve: Informimi për hapat e votimit, veprimet që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe identifikimi elektronik që mundësohet nga pajisja e identifikimit elektronik (PEI).

10) Aplikacioni “KQZ”

Aplikacioni “KQZ” për pajisje komunikimin inteligjent për t’i ardhur në ndihmë zgjedhësve, për hapat e votimit dhe mënyrën e plotësimit të fletës së votimit, apo informacione të tjera rreth procesit zgjedhor në për platformat IOs dhe Android, në rubrikën “Si të votoj”.

Për aplikacionin klikoni në <https://play.google.com/store/apps/details?id=com.kqz.app.kqz>.

3. FUSHATA “KRIMET ZGJEDHORE/SHITBLERJA E VOTËS”

Qëllimi: Informimi dhe ndërgjegjësimi i zgjedhësve mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, si dhe parandalimi i shitblerjes së votës.

Mjetet:

- 1) Spote televizive;
- 2) Spote radiofonike;
- 3) Postera;
- 4) LedWall;
- 5) Media sociale;
- 6) Media online;
- 7) City Light;
- 8) Stacione autobusi;
- 9) Konferenca shtypi;
- 10) Takime me target/grupe;
- 11) Aplikacioni “KQZ”;

1) Spote televizive

U prodhuan spoti televiziv me një gjatësi **46 sekonda**.

Periudha e transmetimit të këtij nga 19.04.2023 deri në 14.05.2023.

Përmbajtja e spotit: Thirrja ndaj qytetarëve për të denoncuar shitblerjen e votës, krime të tjera zgjedhore, si dhe denoncimi i tyre në portalin e denoncimeve në www.kqz.gov.al.

Spoti u transmetua në **46** kanale televizive kombëtare, rajonale, kablllore/lokale sipas një mediaplani me një total **8050** transmetime për të gjithë periudhën.

Për të parë linkun klikoni në: <https://www.youtube.com/watch?v=H1c8E4uImQQ>

2) Spote radiofonike

U prodhuan spoti radiofonik me një gjatësi **30 sekondash**.

Periudha e transmetimit të spotit radiofonik filloi në datën **19.04.2023** dhe përfundoi në **14.05.2023**.

Përmbajtja e spotit: Në këtë spot qytetarët, u ftuan të denoncojnë shitblerjen e votës, si dhe krime të tjera zgjedhore. Spoti u transmetua në të gjitha stacionet radiofonike kombëtare **3 (tre)**, si dhe në **3 (tre)** stacione radiofonike lokale me 35 transmetime në ditë.

Spoti është transmetuar në total **2700** herë në të gjitha radiot e përzgjedhura.

3) Posterat

Janë prodhuar **11 mijë postera** me “Krimet Zgjedhore/ shitblerja e votës”, në formatin B2.

Përmbajtja e posterit: Informacioni për ndëshkimet ligjore në rast të shitjes së votës, fotografimit të saj, votimit më shumë se një herë, apo korrupsioni aktiv dhe pasiv.

Posterat u vendosën **në çdo qendër votimi** në të gjithë vendin (**5213 gjithsej**)

1 mijë postera u vendosën në qendrat e votimit, ku jetojnë pakicat kombëtare në gjuhët që ata flasin.

4) LedWall

U prodhuan spoti “Krimet Zgjedhore/Shitblerja e votës” me kohëzgjatje 15 sekonda.

Periudha e transmetimit të spotit të parë ishte nga 19.04.2023 deri në 14.05.2023, i alternuar edhe me spotet e tjera.

Përmbajtja e spotit: Informacioni për ndëshkimet ligjore në rast të shitjes së votës, fotografimit të saj, votimit më shumë se një herë, apo korrupsioni aktiv dhe pasiv.

Spoti u transmetua në 13 Led Wall **90 herë** në ditë me frekuencë **1 herë në 16 minuta** të vendosur në të gjithë Shqipërinë.

Gjithsej është shfaqur **28.080**.

5) Media sociale

Në rrjetet sociale janë shpërndarë postera dhe video/mesazhe për “Krimet Zgjedhore/Shitblerja e votës”.

Periudha e publikimeve nga 01.04.2023 deri në 14.05.2023.

Përmbajtja e posterave dhe video/mesazheve: Informacioni për ndëshkimet ligjore në rast të shitjes

së votës, fotografimit të saj, votimit më shumë se një herë, apo korrupsioni aktiv dhe pasiv. **Transmetimi/publikimi** është kryer nëpërmjet rrjeteve sociale të KQZ në Facebook, Instagram, Twitter, Youtube përmes faqeve zyrtare “KQZShqiperi” dhe “Vendore2023”. Shikueshmëria në total në të gjitha rrjetet sociale të kqz ka qenë rreth **1.7 milionë** përdorues unikë në harkun e **44** ditëve, sipas statistikave të AgencyAnalytics.

6) Media online

U prodhua baner për publikimin në median online për “Krimet Zgjedhore/Shitblerja e votës”.

Periudha e publikimit të banerit nga 15.04.2023 deri në 14.05.2023.

Përmbajtja e banerit: Informacioni për ndëshkimet ligjore në rast të shitjes së votës, fotografimit të saj, votimit më shumë se një herë, apo korrupsioni aktiv dhe pasiv.

Baneri qëndroi në 30 faqe web të televizioneve kombëtare, lokale/rajonale të përzgjedhura për 30 ditë.

7) City Lights

U prodhuan posterat me “Krimet Zgjedhore/Shitblerja e votës” në formatin 120 cm me 180 cm.

Periudha e qëndrimit të tyre nga data 19.04.2023 deri më 14.05.2023.

Përmbajtja: Informacioni mbi shkeljet ligjore si: shitblerja e votës, fotografimi i votës, votimi më shumë se një herë, korrupsioni aktiv dhe pasiv, apo ofrimi i të mirave materiale, apo favoreve të tjera në këmbim të votës.

U vendosën **20 City Lights** me shikueshmëri nga 20.000-35.000 kalimtarë me informacionin e detajuar.

8) Stacione autobusi

U prodhuan posterat “Krimet Zgjedhore/Shitblerja e votës” në formatin 120 cm me 180 cm.

Periudha e qëndrimit të posterave nga 19.04.2023 deri më 14.05.2023.

Përmbajtja e posterave: Informacioni i detajuar mbi shkeljet ligjore si: shitblerja e votës, fotografimi i votës, votimi më shumë se një herë, korrupsioni aktiv dhe pasiv, ofrimi i të mirave materiale, apo favoreve të tjera në këmbim të votës.

Janë vendosur posterat në **20 stacionet e autobusëve** me më shumë lëvizje të qytetarëve.

9) Konferenca shtypi

Në konferenca për shtyp, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në mënyrë periodike ka bërë apel për të denoncuar rastet e shitblerjes së votës dhe denoncimin në organet ligjzbatuese për çdo rast që vërejnë shkelje, si dhe në **portalin** e dedikuar për denoncimet në faqen zyrtare të institucionit www.kqz.gov.al. Gjithashtu në konferenca shtypi dhe seanca publike, në krah të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka qëndruar një **baner** me sloganin “**Vota nuk shitet**”, që prej datës **11.04.2023** deri në **14.05.2023**.

10) Takime me target/grupe

Takimet ndërgjegjësuere me zgjedhësit, për Krimet Zgjedhore/shitblerja e votës janë zhvilluar në të gjithë vendin.

Periudha e takimeve ka qenë nga janari i vitit 2022 deri më qershor 2022 dhe nga shtatori 2022 deri në maj 2023.

Pëmbajtja e takimeve: Fokus të rinjtë, votues për herë të parë, të cilëve u shpjegohej rëndësia e votës, parandalimi i shitblerjes e saj, krimet zgjedhore, duke filluar nga dita e votimit, por edhe në dhomën e fshehtësisë, të gjitha këto në formë bashkëbisedimi i cili mbyllet me një proces votimi simulant nga vetë nxënësit.

Takime në total në **29 gjimnaze** me të rinjtë, votues për herë të parë.

Këto takime janë mundësuar edhe me mbështjetjen e Qeverisë Britanike.

Për të parë videot klikoni në link-un më poshtë:

<https://www.youtube.com/watch?v=081zPc-IlyU>

<https://www.youtube.com/watch?v=xGx1tgqTaUU>

<https://www.youtube.com/watch?v=GmyRElQ9nyg>

<https://www.youtube.com/watch?v=AivmkSrzi0>

<https://www.youtube.com/watch?v=rURJ54HUINs>

<https://www.youtube.com/watch?v=btIzAyogIzA>

<https://www.youtube.com/watch?v=skNsDdkfr2M>

<https://www.youtube.com/watch?v=2yO-662y3ZA>

11) Aplikacioni “KQZ”

Aplikacioni “KQZ” për pajisje komunikimin inteligjent për t’i ardhur në ndihmë zgjedhësve, për fenomenin negativ të shitblerjes së votës dhe denoncimin për veprimtaritë e paligjshme, apo informacione të tjera rreth procesit zgjedhor. Ky aplikacion për platformat IOs dhe Android.

Për aplikacionin klikoni në <https://play.google.com/store/apps/details?id=com.kqz.app.kqz>.

4. FUSHATA “THIRRJA PËR PJESËMARRJE NË ZGJEDHJE”

Qëllimi: Ndërgjegjësimi i zgjedhësve për të rritur pjesëmarrjen në zgjedhjet vendore të 14 majit 2023.

Mjetet:

- 1) Spote televizive;
- 2) Spote radiofonike;
- 3) Media Sociale

- 4) LedWall
- 5) Billboard;
- 6) Veshje baneri autobusi;
- 7) Takime me target/grupe;

1) Spote televizive

U prodhuan spote për pjesëmarrje në zgjedhje me një kohëzgjatje prej 30 sekondash.

Periudha kohore për këtë spot ka qenë nga 09.05.2023 deri në 14.05.2023.

Përmbajtja e spotit ishte thirrje nga aktori Nik Xhelilaj, i cili jeton jashtë vendit dhe fton qytetarët të ktheheshin dhe të merrnin pjesë në zgjedhje.

Për të parë spotin klikoni në <https://www.youtube.com/watch?v=JDZqIGG0mN8>

2) Spote radiofonike

U prodhuan spote 1, për thirrje për pjesëmarrje **prej 15 sekondash** për të gjithë zgjedhësit.

U prodhuan spote 2 për thirrje për pjesëmarrje për minoritetin rom dhe egjiptian **prej 15 sekondash**.

Periudha e transmetimit radiofonik për të dy spotet nga **08.04.2023** deri në **14.05.2023**.

Spoti 1 përmban apelin për pjesëmarrje në zgjedhje dhe fuqinë që ka vota.

Spoti 2 përmban thirrje për pjesëmarrje në votim për minoritetin rom në gjuhën romë dhe shqip.

Spotet u transmetuan në 3 radio kombëtare dhe 3 rajonale me një total **900 transmetime gjithsej**.

3) Mediat sociale

Në rrjetet sociale janë shpërndarë 7 banera/video-mesazhe për “Thirrje për pjesëmarrje”

Janë prodhuar 7 banera me mesazhin “Unë zgjedh, Unë votoj, Unë punoj/studioj”.

Janë prodhuar 7 video mesazhe me thirrjen “Unë zgjedh, Unë votoj, Unë punoj/studioj”.

Periudha e transmetimit të banerave dhe videove nga 10.03.2023 deri në 14.05.2023.

Përmbajtja e banerave ishte thirrje për pjesëmarrje nga 4 target/grupe të ndryshme si të rinj votues për herë të parë, studentë, minoriteti rom & egjiptian, gratë të cilët ftonin qytetarët për pjesëmarrje në zgjedhje, si një detyrë qytetare, me thirrjen “Unë zgjedh! Unë votoj! Unë punoj! Unë studioj!”.

Përmbajtja e video mesazhit ishte thirrje për pjesëmarrje nga 4 target/grupe të ndryshme, si të rinj votues për herë të parë, studentë, minoriteti rom & egjiptian, gratë të cilët ftonin qytetarët për pjesëmarrje në zgjedhje, si një detyrë qytetare, me thirrjen “Unë zgjedh, Unë votoj, Unë punoj/studioj”.

Transmetimi/publikimi është kryer nëpërmjet rrjeteve sociale të KQZ në Facebook, Instagram, Twitter, Youtube përmes faqeve zyrtare “KQZShqiperi” dhe “Vendore2023”.

Realizimi i tyre u mundësua me mbështetjen e Qeverisë Britanike.

Shikueshmëria në total në të gjitha rrjetet sociale të KQZ ka qenë rreth **1.7 milionë** përdorues unikë.

4) LedWall

U prodhuan spotet "Thirrje për pjesëmarrje" me kohëzgjatje 15 sekonda.

Periudha e transmetimit të spotit të parë ishte nga 09.03.2023 deri në 14.05.2023, i alternuar edhe me spotet e tjera.

Spoti 1 përmban apelin për pjesëmarrje në zgjedhje dhe fuqinë që ka vota.

Spoti 2 përmban thirrje për pjesëmarrje në votim për minoritetin rom në gjuhën romë dhe shqip

Thirrje për pjesëmarrje nga 4 target/grupe të ndryshme, si të rinj votues për herë të parë, studentë, minoriteti rom & egjiptian, gratë, të cilët ftonin qytetarët për pjesëmarrje në zgjedhje, si një detyrë qytetare, me thirrjen "Unë zgjedh! Unë votoj! Unë punoj! Unë studioj!".

Spoti u transmetua në 13 Led Wall, **48 herë** në ditë me frekuencë **1 herë në 30 minuta**.

Gjithsej është shfaqur **3024 herë**.

Spoti 2 me thirrje për pakicat kombëtare u realizua me mbështetjen e Qeverisë Britanike.

5) **Billboard**

Janë vendosur **5 billboard** me përmasat 3 x 4 metra.

Periudha e vendqëndrimeve të tyre ka qenë nga **27.04.2023** deri në **14.05.2023**.

Përmbajtja e billboardit ishte "Thirrje për Pjesëmarrje" me informacionin për datën dhe llojin e zgjedhjeve në pikat kufitare.

Janë vendosur gjithsej 5 billboard në:

Pikën kufitare të Kakavijës në gjuhën greke;

Pikën kufitare të Muriqanit në gjuhën malazeze;

Billboard në qendrat kryesore të qyteteve Berat, Pogradec dhe Gjirokastër.

6) **Veshje baneri autobusi**

Banerat me "Thirrjen për Pjesëmarrje" janë vendosur edhe në **5 linja** autobusi urbanë.

Periudha e vendosjes ka qenë **27.04.2023** deri në **14.05.2023**.

Përmbajtja e veshjes së autobuzit me informacionin për datën dhe llojin e zgjedhjeve, duke i ftuar qytetarët të marrin pjesë në zgjedhje.

7) **Takime me target/grupe**

Takimet ndërgjegjësuese për rritjen e pjesëmarrjes në zgjedhje, zhvilluar në të gjithë vendin.

Periudha e takimeve ka qenë nga janari i vitit 2022 deri më qershor 2022 dhe nga shtatori 2022 deri në maj 2023.

Përmbajtja e takimeve: Fokus të rinjtë, votues për herë të parë, të cilëve u shpjegohej rëndësia e votës, që zëri i tyre të dëgjohet dhe sa e rëndësishme është pjesëmarrja në zgjedhje.

Takime në total në **29 gjimnaze** me të rinjtë, votues për herë të parë.

Këto takime janë mundësuar edhe me mbështetjen e Qeverisë Britanike.

5. **FUSHATA "IDENTIFIKIMI ELEKTRONIK"**

Qëllimi: Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi procedurat e identifikimit elektronik në çdo qendër

votimi, përmes pajisjes elektronike më të sigurt.

Mjetet:

1. Tutorial për Qendrat e Votimit;
2. Media sociale;
3. Ledwall

1) Tutorial për Qendrat e Votimit

Është prodhuar tutorial për identifikimin elektronik të zgjedhësve, pajisjes elektronike të identifikimit (PEI) me kohëzgjatje 21 minuta e 15 sekonda.

Përmbajtja e tutorialit është mënyra e funksionimit të aparaturës dhe përdorimi i saj nga operatori i Qendrës së Votimit. Kjo video përveç tutorialit të plotë është e publikuar edhe me video të shkurtra, sipas çdo procesi që mund të kryhet me PEI (Pajisja e Identifikimit Elektronik).

Janë prodhuar **manuale** përdorimi për **5213 qendrat e votimit** për pajisjen e identifikimit elektronik (PEI).

Për të parë të plotë tutorialin klikoni këtë link: <https://www.youtube.com/watch?v=Iqfz3HuOsNI>;

2) Media sociale

Janë prodhuar dy banera për Identifikimin Elektronik të zgjedhësve.

Periudha e publikimit të banerave është nga **08.04.2023** deri në **14.05.2023**.

Përmbajtja e banerave është informacioni mbi identifikimin e zgjedhësve dhe se çdo zgjedhës do të identifikohet nëpërmjet pajisjes së identifikimit elektronik në çdo qendër votimi.

Transmetimet/publikimet janë kryer përmes postimeve në të gjitha mediat sociale të institucionit të KQZ; Facebook, Instagram, Twitter, Youtube.

Postimet janë aksesuar nga rreth **2 milionë** llogari përdoruesish, sipas AgencyAnalytics.

3) LedWall

U prodhua spoti “Identifikimi Elektronik” me gjatësi 15 sekonda.

Periudha e transmetimit ishte nga 15.03.2023 deri në 14.05.2023, i alternuar edhe me spotet e tjera.

Përmbajtja e spotit është shfaqur informacioni për identifikimin elektronik përmes pajisjes së identifikimit të zgjedhësve në çdo qendër votimi.

Spoti u transmetua në 13 Led Wall **90 herë** në ditë me frekuencë **1 herë në 16 minuta** të vendosur në të gjithë Shqipërinë. Gjithsej është shfaqur **28.080**.

6. FUSHATA “VOTIMI DHE NUMËRIMI ELEKTRONIK” NË 3 BASHKITË: ELBASAN, VORË, KAMËZ

Qëllimi: Informimi dhe ndërgjegjësimi i zgjedhësve në tre bashkitë Elbasan, Vorë dhe Kamëz për votimin dhe numërimin elektronik, përmes pajisjes më të sigurt.

Mjetet:

- 1) Spote televizive;
- 2) postera;
- 3) Ledwall;
- 4) Mediat sociale;
- 5) Stacionet e autobusëve;
- 6) Billboard;
- 7) Testimi i pajisjes (PEVN)
- 8) Deklarata publike;

1) Spote televizive

U prodhuan 2 spote “Votimi dhe Numërimi Elektronik” me gjatësi prej **2 minuta e 47 sekonda** në tre bashkitë (Elbasan, Kamëz dhe Vorë).

Periudha e transmetimit nga data 05.05.2023 deri më 14.05.2023

Përmbajtja e spotit 1 ishte hapat që ndjekin zgjedhësit që votuan elektronikisht, nëpërmjet pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik.

Përmbajtja e spotit 2 ishte informacion që në Elbasan, Vorë dhe Kamëz votohet nëpërmjet pajisjes së votimit.

Spoti është transmetuar 300 herë në total.

Për të parë spotin klikoni në:

<https://www.youtube.com/watch?v=7bC9bqzKdOk>;

<https://www.youtube.com/watch?v=X9Ar47GbduA>.

2) Postera

Janë prodhuar **550 postera** në formatin B2.

Përmbajtja në postera ishin hapat e votimit elektronik me anë të pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik.

Posterat u vendosën në çdo qendër votimi në Kamëz, Vorë dhe Elbasan, ku zbatua projekti pilot i Votimit dhe Numërimit Elektronik.

3) Ledwall

Është realizuar spoti në formatin Led me Votimin dhe Numërimin Elektronik.

Periudha e transmetimit është nga **27.04.2023** deri në **14.05.2023**.

Spoti është shfaqur në **2 Ledwall**, në Elbasan dhe Kamëz.

Informacioni në Ledwall është **15 sekonda** dhe shfaqet **një herë në 4 minuta**.

Në total është transmetuar **1790 herë**.

4) Media sociale

Në mediat sociale të institucionit janë shpërndarë postera/video/mesazhe për “Votimin dhe Numërimi Elektronik”.

Periudha e publikimeve nga 27.04.2023 deri në 14.05.2023.

Pëmbajtja e posterave dhe video/mesazhe: Informacioni për hapat që ndjekin zgjedhësit që votojnë nëpërmjet pajisjes së Votimit dhe Numërimit Elektronik.

Transmetimi/publikimi është kryer nëpërmjet rrjeteve sociale të KQZ në Facebook, Instagram, Tëitter, Youtube, përmes faqeve zyrtare “KQZShqiperi” dhe “Vendore2023”.

Për të parë linkun klikoni:

<https://www.youtube.com/watch?v=XXP5aV3BGMg>

5) Stacionet e autobusëve

U prodhuan posterat “Votimi dhe numërimi elektronik” në formatin 120 cm me 180 cm.

Periudha e qëndrimit të posterave është nga 27.04.2023 deri në 14 maj 2023, në **4 stacione** autobusi.

Pëmbajtja e posterave: Informacioni për hapat që ndjekin zgjedhësit, që votojnë nëpërmjet pajisjes së Votimit dhe Numërimit Elektronik. Në postera janë dhënë mesazhet për mënyrën e Votimit dhe Numërimit Elektronik përmes pajisjes më të sigurt dhe pa asnjë mundësi që të identifikohet vota e çdo zgjedhësi.

6) Billboard

Janë prodhuar postera për formatin billboard me përmasat 3 x 4 metra.

Periudha e qëndrimit të posterave/billboard është nga 27.04.2023 deri në 14 maj 2023

Janë vendosur gjithsej **5 billboard** në Vorë dhe Kamëz me mesazhe informuese për votimin dhe numërimin elektronik.

Përbajtja për të informuar zgjedhësit e 3 bashkive për mënyrën e votimit dhe numërimit elektronik përmes pajisjes më të sigurt.

7) Testimi i pajisjes (PEVN)

Demonstrimi i pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit nisi në datën **18.04.2023** në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan.

Zgjedhësit e tre bashkive në datën 14 maj 2023 votuan përmes pajisjes elektronike të votimit dhe demonstrimi kishte synim njohjen e zgjedhësve me pajisjen dhe me procedurën e votimit.

Për bashkinë **Elbasan** testimi u zhvillua në Teatrin “Skampa”, Pallati i Sportit dhe Qendra Kulturore e Femijëve.

Në Bashkinë **Kamëz**, testimi i pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik u zhvillua në ambientet e gjimnazit “Isa Boletini” dhe shkollën “Halit Çoka”.

Në Bashkinë e **Vorës**, testimi u zhvillua në shkollën 9 vjeçare me numër godine 159.

Për të parë linkun e demonstrimit klikoni në: <https://www.youtube.com/watch?v=meiIErQ1rWA>

8) Deklarata publike

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në daljet e tij publike dhe gjatë testimeve të pajisjes elektronike për votimin dhe numërimin ka siguruar se procesi është **i sigurt** dhe se askush nuk mund të identifikojë votën e zgjedhësve në tre bashkitë që do të kenë numërim dhe votim elektronik.

Nga pikëpamja e sigurisë dhe **garancisë së fshehtësisë së votës** pajisjet PEVN dhe PEI kanë siguri

100 për qind dhe garantohet fshehtësia e votës.

Është një sistem, i cili nga pikëpamja teknike e lehtëson procesin e votimit dhe qytetarët do të verifikojnë që procesi i votimit elektronik është i thjeshtë dhe **i sigurt**.

Për të parë linkun në: <https://www.youtube.com/watch?v=m35LL3OPTgg>

7. FUSHATA “VEPRIMTARITË E NDALUARA DHE PËRDORIMI I BURIMEVE PUBLIKE”

Qëllimi: Informimi i administratës publike për ndalimet dhe kriteret ligjore për zgjedhjet. Ndërgjegjësimi i punonjësve të administratës shtetërore gjatë periudhës zgjedhore dhe informimi mbi shkeljet ligjore dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, parandalimi i tyre, si dhe raportimi i çdo rasti në portalin e dedikuar për monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve shtetërore para zgjedhjeve.

Mjetet:

1. Media sociale;
2. Postera;
3. Udhëzues;

1) Media sociale

U prodhuan 5 spote për ”Veprimtaritë e ndaluara dhe administrata publike” me gjatësi 1 min e 20 sekonda.

Periudha e qëndrimit nga data 15.03.2023 deri më 14.05.2023

Përmbajtja e 5 spoteve është të informojnë nëpunësit e administratës mbi veprimtaritë e ndaluara gjatë orarit zyrtar dhe mospërdorimin e burimeve shtetërore. Gjithashtu jepen mesazhe, që të mos përdorin asetet e paluajtshme në pronësi të institucionit.

Spotet kishin si protagonistë përfaqësues të medias, aktivistë të shoqërisë civile e të tjerë.

Spotet janë prodhur me mbështetjen e **Qeverisë Britanike dhe NDI**.

Për të parë spotet klikoni në:

<https://www.youtube.com/watch?v=-XgoFwtYkdM;>

<https://www.youtube.com/watch?v=72TxHsWIPUG;>

<https://www.youtube.com/watch?v=kWuqg6Nfv0c;>

<https://www.youtube.com/watch?v=q-vA7JaPH0c;>

<https://www.youtube.com/watch?v=KwKGhGws2tg;>

2) Postera

Janë prodhuar 150 postera **në formatin B2**.

Posterat u vendosën në Institucionet publike.

Përmbajtja e posterave ishte veprimtaritë e ndaluara, ndërgjegjësimi i Administratës Publike dhe Subjekteve Zgjedhore për të mos përdorur burimet publike gjatë fushatës për zgjedhjet e 14 majit

2023.

3) Udhëzues

Janë prodhuar dhe shpërndarë 70 udhëzues të posaçëm për administratën publike dhe veprimtaritë e ndaluara.

Përmbajtja e udhëzuesve ishte për veprimtaritë e ndaluara, ndërgjegjësimi i Administratës Publike dhe Subjekteve Zgjedhore për të mos përdorur burimet publike gjatë fushatës për zgjedhjet e 14 majit 2023.

Udhëzuesit janë prodhuar me ndihmën e organizatave të Shoqërisë Civile, Qeverisë Britanike dhe NDI.

8. TË RINJTË/VOTUES PËR HERË TË PARË

Qëllimi: Edukimi, informimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve, kryesisht votues për herë të parë, për pjesëmarrje në zgjedhjet e datës 14 maj 2023, si një pjesë që i inkurajon ata që zëri i tyre të dëgjohet.

Mjetet:

1. Media sociale
2. City Light
3. Ledwall
4. Takime me të rinjtë

1) Media sociale

Janë prodhuar **5 spote** me thirrjen për pjesëmarrje në zgjedhje, me të rinjtë e disa profesioneve me një gjatësi prej 30 sekonda.

Periudha nga 10.03.2023 deri më 14.05.2023.

Përmbajtja e spoteve ka qenë ndërgjegjësimi i të rinjve për të marrë pjesë në zgjedhje. Spotet përmbajnë mesazhe për angazhimin e të rinjve në procesin zgjedhor.

Spotet për të rinjtë janë publikuar në rrjetet sociale të institucionit të KQZ; facebook, instagram, Twitter dhe Youtube.

Spotet kanë pasur një shifër shikimesh totale mbi **6.6 milionë**.

Informacioni i këtyre spoteve është aksesuar nga rreth **2 milionë** llogari përdoruesish.

Për të parë linkun klikoni në:

<https://www.youtube.com/shorts/crerBM6roL4>;

<https://www.youtube.com/shorts/XIBBwphwXs0>;

<https://www.youtube.com/shorts/0utpfxQSpHA>

2) City lights

U prodhuan posterat nga të rinjtë dhe për të rinjtë në formatin 120 cm me 180 cm.

Periudha e qëndrimit të tyre nga data 10.03.2023 deri më 14.05.2023.

Përmbajtja: Informacioni me thirrje nga të rinjtë për të marrë pjesë në zgjedhje.

U vendosën **10 City Lights** me shikueshmëri nga 20.000-35.000 kalimtarë me informacionin e detajuar.

Posterat me të rinjtë janë mundësuar me financimin e Qeverisë Britanike.

3) **Ledwall**

U prodhuan **spote** në formatin Ledwall, me thirrjen për pjesëmarrje në zgjedhje, me të rinjtë e disa profesioneve me gjatësi prej 15 sekonda.

Periudha nga 10.03.2023 deri më 14.05.2023.

Përmbajtja e spotit ka qenë ndërgjegjësimi i të rinjve për të marrë pjesë në zgjedhje. Spoti përmban mesazhin për angazhimin e të rinjve në procesin zgjedhor.

Informacioni në Ledwall është **15 sekonda** dhe shfaqet **një herë në 16 minuta**.

Në total është transmetuar **3200 herë**.

4) **Takime me të rinjtë**

Takimet ndërgjegjësuere për rritjen e pjesëmarrjes në zgjedhje janë zhvilluar në të gjithë vendin.

Periudha e takimeve ka qenë nga janari i vitit 2022 deri më qershor 2022 dhe nga shtatori 2022 deri në maj 2023.

Përmbajtja e takimeve: Fokus të rinjtë, votues për herë të parë, të cilëve u shpjegohej rëndësia e votës, që zëri i tyre të dëgjohet dhe sa e rëndësishme është pjesëmarrja në zgjedhje.

Takime në total në **29 gjimnaze** me të rinjtë, votues për herë të parë.

Këto takime janë mundësuar edhe me mbështjetjen e Qeverisë Britanike.

Për të parë linqet klikoni në:

<https://www.youtube.com/watch?v=n58jKgn-UKU>

<https://www.youtube.com/watch?v=G29LonbxOuo>

<https://www.youtube.com/watch?v=3kktVfGmFqI>

<https://www.youtube.com/watch?v=R4odER8iT7Q>

<https://www.youtube.com/watch?v=0eqN61hmS5o>

<https://www.youtube.com/watch?v=MKqzd24mqtg>

https://www.youtube.com/watch?v=yiNsszpNi_I

https://www.youtube.com/watch?v=wkn_fT_zQ3c

<https://www.youtube.com/watch?v=tmBkT-Pë0Q4>

<https://www.youtube.com/watch?v=p9RiysejgHc>

9. **FUSHATA “PAKICAT KOMBËTARE”**

Qëllimi: Edukimi, informimi dhe ndërgjegjësimi i pakicave kombëtare në Shqipëri për pjesëmarrje në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023. Informimi përmes gjuhës që ata flasin me qëllim nxitjen e parimit

të barazisë dhe mosdiskriminimit, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara në gjuhët e pakicave.

Mjetet:

- 1) Spote televizive;
- 2) Postera;
- 3) Mediat sociale;
- 4) City Lights;
- 5) Bus Station;
- 6) Billboard;
- 7) Takime me target/grupe.

1) Spote televizive

U prodhuan të gjitha spotet e fushatës edukuese në gjuhën e minoriteteve që jetojnë në vendin tonë, në gjuhët: greke, maqedonase, arumune, rome, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare.

Periudha e transmetimit nga data 08.03.2023 deri më 14.05.2023.

Përmbajtja e spoteve: Spotet e prodhuara ishin "Kontrollo emrin në Listën e Zgjedhësve", "Krimet Zgjedhore", "Hapat për të votuar," "Plotësimi i fletës së votimit", të cilat përveçse në gjuhën shqipe, u përshtatën me titra në gjuhët e 9 pakicave kombëtare dhe u shpërndanë në mediat lokale të zonave, ku pakicat janë më të përqëndruar, sipas etnive të tyre.

Përkthimi i spoteve në gjuhën e pakicave kombëtare u mundësua me mbështetjen e Këshillit të Evropës

Për të parë linkun klikoni në:

https://www.youtube.com/watch?v=dAgI_HpVJPg

<https://www.youtube.com/watch?v=fCA0jIwCy3o>

<https://www.youtube.com/watch?v=kB3Bd8g0uPQ>

<https://www.youtube.com/watch?v=M8pd06ThbPk>

https://www.youtube.com/watch?v=Z7700NFu_uM

<https://www.youtube.com/shorts/cdAMfI1ip7M;>

<https://www.youtube.com/shorts/y6it86roZDë>

2) Postera

U prodhuan postera në gjuhën e pakicave kombëtare në qendrat e votimit, në gjuhët greke, maqedonase, arumune, rome, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare.

Periudha: Nga data 10.03.2023 deri më 14.05.2023.

Përmbajtja: Posterat e prodhuar ishin "Krimet Zgjedhore/Shitblerja e votës", "Hapat për të votuar," të cilat përveçse në gjuhën shqipe, u përshtatën në gjuhët e 9 pakicave kombëtare dhe u shpërndanë

në qendrat e votimit, ku pakicat janë më të përqëndruar, sipas etnive të tyre.
Posterat u realizuan me ndihmën e **Këshillit të Europës**.

3) Mediat sociale

Spotet e prodhuar janë publikuar edhe në të gjitha rrjetet sociale të institucionit të KQZ; Facebook, Instagram, Twitter dhe Youtube.

Periudha nga data 10.03.2023 deri më 14.05.2023.

Spotet janë klikuar në total mbi **6.6 milionë** views.

Spotet janë aksesuar nga rreth **2 milionë** llogari përdoruesish, sipas AgencyAnalytics.

4) City Lights

U prodhuan **5 city lights** në gjuhën rome në formatin 120 cm me 180 cm në Tiranë, Fier dhe Elbasan.

Periudha nga data 10.03.2023 deri më 14.05.2023.

Përmbajtja e city lights me mesazhin për pjesëmarrje në zgjedhje të minoritetit rom.

Janë vendosur në qytetet, ku ata janë më të përqëndruar me mesazhin për pjesëmarrje në zgjedhje.

Këto city lights u financuan nga Qeveria Britanike.

5) Stacionet e autobusëve

U prodhuan postera për stacionet e autobusave në gjuhën rome dhe u vendosën në stacionet e autobusëve, në formatin 120 cm me 180 cm.

Periudha nga data 10.03.2023 deri më 14.05.2023.

Përmbajtja ishte të kontrollonin emrin në Listën e Zgjedhësve dhe Qendrën e Votimit dhe për çdo pasaktësi të drejtoreshin në Njësinë administrative, ose në www.kqz.gov.al, si dhe në Zyrat e Gjendjes Civile.

Posterat janë vendosur në 5 stacione autobusi.

6) Billboard

Janë prodhuar postera për formatin billboard me përmasat 3 x 4 metra.

Periudha: nga data 15.03.2023 deri më 14.05.2023.

Përmbajtja: Thirrje për pjesëmarrje në zgjedhje.

Janë vendosur **2 billboard** për pakicat kombëtare.

Një billboard është vendosur në pikën kufitare të Kakavijës për pakicat greke.

Një billboard në pikën kufitare të Muriqanit për pakicat malazeze.

7) Takime me target/grupe

Janë zhvilluar **25 takime** me pakicat kombëtare rome dhe egjiptiane, me thirrjen për pjesëmarrje në zgjedhje.

Periudha e takimeve ka qenë nga janari-mars 2023.

Përmbajtja e takimeve: Fokus zgjedhësit e minoritetit rom dhe egjiptian të cilëve u shpjegohej rëndësia e votës, që zëri i tyre të dëgjohet, pjesëmarrja në zgjedhje dhe parandalimi i fenomenit të shitblerjes së votës.

Këto takime janë mundësuar me mbështjetjen e Qeverisë Britanike.

Për të parë takimet e realizuara klikoni në:

<https://www.youtube.com/watch?v=wY8qTI7AkfA>

<https://www.youtube.com/watch?v=5EAYZ3USo>

<https://www.youtube.com/watch?v=sx0XJRRMQpU>

<https://www.youtube.com/watch?v=fp8OZSaIBIs>

https://www.youtube.com/watch?v=n_wbOw6bbT0

10. FUSHATA “GRATË NË PROCESIN ZGJEDHOR”

Qëllimi: Edukimi, informimi dhe ndërgjegjësimi për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje, shmangia e fenomenit negativ të votimit familjar dhe ndërgjegjësimi në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar të pandikuar në zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

Mjetet:

1. City lights;
2. Spote;
3. Media sociale;
4. Takime me target/grupe;

1) City lights

U prodhuan **postera në gjuhën rome** me gratë në formatin 120 cm me 180 cm.

Periudha nga 15.03.2023 deri më 14.05.2023.

Përmbajtja e posterit ishte mesazh për pjesëmarrjen në zgjedhje të grave rome.

Posterat e prodhuar do të vendosen në qendrat e votimit, ku ka shumicë të pakicave kombëtare dhe konkretisht gra rome.

2) Spote

U prodhuan **spote** për rrjetet sociale me gra të profesioneve të ndryshme.

Spotet kishin për protagoniste fotografe, fermere, shitëse, studente, që dhanë mesazhin për pjesëmarrje në zgjedhje dhe rëndësinë e votës.

Për të parë takimet e realizuara klikoni në:

https://www.youtube.com/watch?v=n_wbOw6bbT0

3) Media sociale

U prodhuan postera dhe spote të ndryshme **“Me Romët dhe për Romët”**.

Posterat dhe spotet e prodhuar u shpërndarë në rrjetet sociale të KQZ (Facebook, Instagram, Twitter, Youtube) me synim informimin përmes të gjitha mjeteve të të gjithë target/grupeve.

4) Takime me target/grupet

U zhvilluan **2 aktivitete** me gratë në Berat dhe Shkodër.

Në këto takime u diskutua për shmangien e fenomenit negativ të votimit familjar në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar, të pandikuar.

U zhvilluan **15 aktivitete** edukuese, informuese dhe ndërgjegjësuere me gratë rome.

Për gratë rome u shpërndanë mesazhet për të kontrolluar emrin në listën e zgjedhësve, dokumentet që u nevojiten për të votuar, shitblerjen e votës, si dhe mjetet dhe mënyrat e marrjes së informacionit.

U zhvillua një aktivitet me gratë rome dhe egjiptiane për ditën ndërkombëtare të gruas, me pjesëmarrjen nga Qeveria Britanike dhe zëvendësambasadores britanike në Tiranë. Aktiviteti kishte në fokus ndërgjegjësimin e grave për rëndësinë që ka vota.

Takimet janë zhvilluar me mbështetjen e Qeverisë Britanike.

Për të parë linqet klikoni në:

<https://www.youtube.com/watch?v=ëY8qTl7AkfA>

<https://www.youtube.com/watch?v=5EAYZ3USo>

<https://www.youtube.com/watch?v=sx0XJRRMQpU>

<https://www.youtube.com/watch?v=fp8OZSaIBIs>

https://www.youtube.com/watch?v=n_ëbOë6bbT0

11. PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Qëllimi: Informimi dhe ndërgjegjësimi për personat me aftësi të kufizuara (PAK) dhe krijimi i kushteve për të ushtruar të drejtën për të votuar në zgjedhjet vendore të 14 majit 2023.

Mjetet:

1. Spote televizive;
2. Media Sociale
3. Postera;
4. Takime me target/grupe;
5. Alfabeti Braille për zgjedhësit me kufizim të shikimit.

1) Spote televizive

U prodhuan të gjitha spotet e fushatës edukuese në **gjuhën e shenjave** për t'iu ardhur në ndihmë të gjitha personave me aftësi të kufizuara.

Periudha e transmetimit nga data 08.03.2023 deri më 14.05.2023.

Përmbajtja e spoteve: Spotet e prodhuar ishin "Kontrollo emrin në Listën e Zgjedhësve", "Krimet Zgjedhore", "Hapat për të votuar," "Plotësimi i fletës së votimit", të cilat u realizuan edhe në gjuhën e shenjave.

Për të parë spotet klikoni në:

2) Media sociale

U prodhuan postera informues, të cilët u publikuan në rrjetet sociale të institucionit të KQZ; Facebook, Instagram, Twitter dhe Youtube, përmes faqeve zyrtare "KQZ Shqipëri" dhe "Vendore2023".

3) Postera

U prodhuan postera informues në formatin B2 me sasi 5500 copë.

Periudha e qëndrimit, në ditën e zgjedhjeve, në çdo qendër votimi.

Përmbajtja e posterit, që të gjithë kanë të drejtë të votojnë.

4) Takime me target/grupet

U zhvilluan **4 takime/aktivitete** me përfaqësuesit e shoqatave të personave me aftësi të Kufizuar.

U zhvilluan 3 aktivitet me ndihmën e OSBE në **Korçë, Shkodër dhe Fier** me personat me aftësi të Kufizuar në shikim.

U zhvillua një takim me “Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me aftësi të Kufizuar”, në kuadër të projektit rajonal “SMART Balkans”.

Takimet u fokusuan mbi aksesueshmërinë në zgjedhje, për personat me aftësi të Kufizuar.

5) Alfabeti braille

Është mundësuar **alfabetin braille** për personat me aftësi të Kufizuar në shikim.

Personat me aftësi të kufizuar ushtruan të drejtën e tyre kushtetuese për të votuar në 14 maj, përmes fletës së posaçme të votimit.

12. PLOTËSIMI I FLETËS SË VOTIMIT

Qëllimi: Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit, përmbajtja e fletës së votimit dhe shënimin korrekt të saj. Zgjedhësit të jenë të përgatitur ditën e votimit për plotësimin e fletës së votimit që vota e tyre të jetë e vlefshme.

Mjetet:

- 1) Spote televizive;
- 2) Postera;
- 3) Ledwall;
- 4) Media sociale;
- 5) Media online;
- 6) Takime me target/grupe;
- 7) Aplikacioni “KQZ”.

1. Spote televizive

U prodhua spoti për “Plotësimin të fletës së votimit” me kohëzgjatje **43 sekonda**.

Periudha e transmetimit nga **27.04.2023** deri në **14.05.2023**.

Përmbajtja e spotit: Mënyra korrekte e plotësimin të 2 fletëve të votimit, për kryetar bashkie dhe

këshillat bashkiakë.

Ky spot u transmetua në **46 kanale** televizive kombëtare, rajonale dhe kabllore/lokale.

Janë **680** transmetime në ditë, alternuar me spotet e tjera.

Në total janë **11.560 transmetime**.

Për të parë spotin klikoni në:

https://www.youtube.com/watch?v=x_YINOVcOC0;

<https://www.youtube.com/watch?v=45d2XaAQ4BE>

https://www.youtube.com/watch?v=dAgI_HpVJPg;

<https://www.youtube.com/watch?v=fCA0jlëCy3o>;

<https://www.youtube.com/watch?v=kB3Bd8g0uPQ>;

<https://www.youtube.com/watch?v=M8pd06ThbPk>;

https://www.youtube.com/watch?v=Z7700NFu_uM

2. Posterat

U prodhuan posterat në formatin B2, me sasi 12 000 copë me emrat e kandidatëve për kryetar dhe këshillat bashkiakë.

Periudha e qëndrimit, në ditën e zgjedhjeve, në çdo qendër votimi.

Përmbajtja e posterit, ishte informimi i zgjedhësve për emrat e kandidatëve për kryetar bashkie dhe emrat e subjekteve për këshillin bashkiak, sipas bashkive ku votonin.

Të gjithë posterat janë shpërndarë dhe do shpërndahen edhe në rrjetet sociale të KQZ, Facebook, Instagram, Twitter dhe Youtube.

3. Ledwall

U prodhua spoti në format Ledwall për mënyrën e “Plotësimit të Fletës së Votimit” me kohëzgjatje 15 sekonda.

Periudha e shfaqjes në Led është nga **27.04.2023** dhe vazhdon deri në **14.05.2023**.

Përmbajtja e spotit ishte mënyra korrekte e plotësimit të 2 fletëve të votimit, për kryetar bashkie dhe këshillat bashkiakë.

Spoti është shpërndarë në 13 Ledwall, të vendosur në pikat me më shumë lëvizje të qytetarëve.

Spoti për mënyrën e “Plotësimit të Fletës së Votimit” është transmetuar në Ledwall **90** herë në ditë, me një frekuencë **1 herë në 16 minuta**.

Në total janë mundësuar **1530 shfaqje** në ekranet Led.

4. Mediat sociale

U prodhuan spotet dhe banera në formatin për mediat sociale për “Plotësimin e Fletës së Votimit” me gjatësi 15 sekonda.

Periudha e shfaqjes në mediat sociale ishte nga **27.04.2023** dhe vazhdon deri në **14.05.2023**.

Përmbajtja e spotit ishte plotësimi në mënyre korrekte e 2 fletëve të votimit, për kryetar bashkie dhe këshillat bashkiakë.

Spotet dhe posterat e prodhuar janë publikuar çdo një orë në rrjetet sociale të institucionit të KQZ; Facebook, Instagram, Twitter, Youtube përmes faqeve zyrtare “KQZ Shqipëri” dhe “Vendore2023”.

Spotet dhe posterat janë klikuar nga **1.7 milionë** përdorues unikë sipas AgencyAnalytics. Spotet dhe posterat për “Plotësimin e Fletës së Votimit” janë në shifrën e **4.9 milionë** sesioneve ekspozimi.

Postimet në mediat sociale të institucionit kapin shifrën totale të mbi **9.3 milion** views.

5. Media online

Spoti për “Plotësimin e Fletës së Votimit” u prodhua edhe në formatin baner.

Periudha e shfaqjes në mediat online ishte nga **27.04.2023** deri në **14.05.2023**.

Përmbajtja ishte mënyra korrekte e plotësimit të 2 fletëve të votimit, për kryetar bashkie dhe këshillat bashkiakë.

Baneri është publikuar në **30** faqe web të televizioneve kombëtare, lokale/rajonale.

Spoti/baner për faqen e web u publikua në total **510 herë**.

6. Takime me target/grupe

U zhvilluan **29 takime** me të rinjtë në gjimnazet e vendit, kryesisht votues për herë të parë për mënyrën e Plotësimit të Fletës së Votimit.

Vendi: Takimet janë zhvilluar në Shkodër, Durrës (Sukth, Çezmja e Ferrës), Vlorë (Novoselë, Llakatund), Fier (Drizë, Levan dhe Baltëz), Gjirokastrë (Zinxhira), Elbasan (Rrapisht), Berat, Divjakë (Grabian), Tiranë (Kinostudio, Shkozë) dhe Fushë Krujë.

Janë përfshirë në sesionet e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit për Plotësimin e Fletës së Votimit, afro **600 anëtarë** të komunitetit rom dhe egjiptian.

Sesionet e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit janë mundësuar me mbështetjen e Qeverisë Britanike.

7. Aplikacioni “KQZ”

Aplikacioni “KQZ” për pajisje komunikimin inteligjent për t’i ardhur në ndihmë zgjedhësve, është në Apple dhe Android. Aty janë të gjitha informacionet, që nga kontrolli i emrit në listat e zgjedhësve, qendra e votimit, pjesëmarrja e të tjera.

Për aplikacionin klikoni në <https://play.google.com/store/apps/details?id=com.kqz.app.kqz>.

13. MË SKANO! KONTROLLO QENDRËN E VOTIMIT

Qëllimi: Informimi në kohë reale dhe shpejtësia për të kontrolluar qendrën e votimit për zgjedhësit. Përmes aplikacionit të KQZ nëpërmjet skanimit mund të gjendej Qendra e Votimit.

- 1) Ledwall
- 2) Media sociale

1. Ledwall

U prodhua spoti me një kohëzgjatje prej 14 sekondash.

Periudha e transmetimit 04.05.2023 deri më 14.05.2023.

Përmbajtja : Spoti informon zgjedhësit të kontrollojnë qendrën e votimit përmes aplikacionit KQZ në Apple dhe Android.

Për të parë spotin klikoni në: <https://www.youtube.com/watch?v=lt3IPOrPycI>

2. Media sociale

U prodhua spoti me një gjatësi prej 14 sekonda.

Periudha e transmetimit 04.05.2023 deri më 14.05.2023.

Përmbajtja e spotit: Spoti informon zgjedhësit të kontrollojnë qendrën e votimit përmes aplikacionit KQZ në Apple dhe Android.

Spoti “Më skano! Kontrolllo Qendrën e Votimit” u shpërnda në rrjetet sociale të KQZ.

Postimet në rrjetet sociale kapin shifrën totale të mbi **6.6 milion** shikimeve.

Spoti janë aksesuar nga rreth **2 milionë** llogari përdoruesish, sipas AgencyAnalytics.

Spoti dhe posterat janë klikuar nga **1.7 milionë** përdorues unikë.

Spotet dhe posterat për “Plotësimin e Fletës së Votimit” përllogariten në shifrën e **4.9 milion** sesioneve ekspozimi.

Në vëmendje!

- *Të gjitha aktivitetet për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve, edhe nëse nuk janë pasqyruar imtësisht në materialin e mësipërm, janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit të KQZ dhe rrjetet sociale Facebook, Twitter, Instagram dhe Youtube në adresat “kqzshqiperi” dhe “vendore2023”.*

- *Në të gjitha sesionet e edukimit dhe takimet me pakicat kombëtare, të rinjtë, gratë, apo personat me aftësi të kufizuar janë ruajtur të dhënat e tyre personale, në zbatim të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 për mbrojtjen e tyre.*

Seksioni 14: Vëzhgimi i zgjedhjeve


Për akreditimin e vëzhguesve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 14 majit 2023 u bazuam në nenet 6, 7, e 19, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimin nr.19, datë 27.01.2023 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

KQZ-ja arriti të trajtojë në kohë akreditimin e rreth **2132** vëzhguesve jopolitikë në zgjedhjet e 14 majit 2023 nga të cilët:

452 vëzhgues vendas nga 9 Organizata të Shoqërisë Civile (OShC) të ndarë sipas mandatit në **367** vëzhgues afatgjatë dhe 85 vëzhgues afatshkurtër.

557 vëzhgues ndërkombëtar nga të cilët 429 vëzhgues nga 16 organizata ndërkombëtare (përfshirë ODIHR dhe Trupa të Menaxhimit të Zgjedhjeve) dhe 128 diplomatë nga 15 ambasada të akredituara në vendin tonë.

1,114 përfaqësues të medias nga të cilat 33 media lokale si dhe 5 media ndërkombëtare me numër të kufizuar vëzhguesish – 9 përfaqësues.



Në përputhje me mandatin e tij, ODIHR solli në vendin tonë një Mision Vëzhgimi Zgjedhor (MVZ) për këto zgjedhje. ODIHR akreditoi 300 vëzhgues afatshkurtër për të ndjekur hapjen e qendrave të votimit, votimin, numërimin e votave dhe tabelimin e rezultateve si dhe 24 vëzhgues afatgjatë dhe doli dhe me një raport përfundimtar me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse.

Për herë të parë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 14 majit 2023 u realizua “Programi i vizitorëve ndërkombëtarë”.

Delegacione të vendeve të ndryshme LOS Angeles, KQZ Gjeorgji, KQZ Kirgistan, KQZ Kosovë, KQZ Estonia, KQZ BiH, KQZ Moldavi si dhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP) dhe Qendra për Edukim të Vazhdueshëm (CICDE) me ftesë të Komisionerit vëzhguan procesin në ditën e zgjedhjeve. Ky program ishte një mundësi e shkëlqyer për Trupat e Menaxhimit të Zgjedhjeve të rajonit e më gjerë të interesuara për të aplikuar TIK-un në procesin e tyre zgjedhor dhe për të vëzhguar efektivitetin dhe përfitimet e sistemeve elektronike të votimit dhe numërimit. Pjesëmarrësit patën mundësi për të parë procesin e identifikimit, votimit dhe numërimit duke përdorur sistemet, pajisjet për identifikimin elektronik të votuesve si dhe votimin elektronik të kombinuar dhe me votimin manual në Durrës, Elbasan dhe Tiranë.

Pozitiv është fakti që KQZ është konsultuar në mënyrë të vazhdueshme organizatat vendase dhe ndërkombëtare lidhur me projektaktet e saj duke institucionalizuar në këtë mënyrë bashkëpunimin me këto organizata.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka zhvilluar takime bashkëpunimi me përfaqësues të shoqërisë civile për të diskutuar mbi problematikat dhe këndvështrimin e shoqërisë civile lidhur me zgjedhjet

vendore, të datës 14 maj 2023. Janë zhvilluar disa takime të tilla me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve ku janë adresuar problematikat e paraqitura gjatë mbarëvajtjes së procesit zgjedhor dhe një takim përmbyllës ku u diskutuan problematika të ndryshme si: pjesëmarrje e ulët në votime nga të rinjtë, dhe shumë problematika të tjera lidhur me procesin zgjedhor të 14 maj 2023. Gjithashtu organizatat e shoqërisë civile ndanë perspektivat e tyre se si të përmirësohet llogaridhënia dhe transparenca në zgjedhje dhe të ndërtohet besimi i qytetarëve.

KQZ ka në vëmendje të saj rekomandimet/sugjerimet e propozuara nga partnerët ndërkombëtarë dhe vendas. KQZ shpreh mirënjohjen e saj për të gjithë vëzhguesit vendas dhe ndërkombëtar që me gjetjet dhe rekomandimet e tyre do jenë program pune për KQZ-në në drejtim të përmirësimit të performancës së saj në të ardhmen.

Seksioni 15. Teknologjia në zgjedhje

1. Identifikimi Elektronik (IE)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, menjëherë pas shpalljes së dekretit të Presidentit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, vendosi të përdorë Sistemin e Elektronik të Identifikimit të Votuesve nëpërmjet Pajisjeve Elektronike të Identifikimit në të gjitha bashkitë ku do të zhvilloheshin zgjedhjet. Sistem i cili u përdor me sukses gjatë zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021 si dhe zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022. KQZ implementoi sistemin e identifikimit elektronik në të gjitha qendrat e votimit ditën e zgjedhjeve. Sistemi i implementuar është sistem identifikimi elektronik me nënshkrim biometrik.

Qëllimi i këtij sistemi të ri ishte parandalimi i:

- votimit të dyfishtë,
- votimit familjar ose
- votimit për një zgjedhës tjetër.

Objektivi i sistemit elektronik ishte identifikimi korrekt i zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, duke siguruar identifikimin e zgjedhësve në mënyrë të sigurtë, transparente si dhe duke rritur rendimentin e veprimeve në qendrat e votimit.

Sistemi Elektronik Identifikimit të Votuesve përfshin 3 komponentë:

- a. PEI, Pajisjen Elektronike të Identifikimit; një pajisje e integruar, portabël dhe e specializuar e cila përmban listë elektronike të zgjedhësve me të gjithë komponentët e nevojshëm për të bërë të mundur një proces identifikimi të sigurt dhe eficient.
- b. VIUClient; programi i specializuar për identifikimin e zgjedhësve i instaluar në Pajisjen Elektronike të Identifikimit.
- c. Sistemi Elektronik i Identifikimit të Votuesve i cili përbëhet nga 2 komponentë:

- Sistemi Qendror i Identifikimit të Votuesve, i cili bën të mundur përgatitjen dhe konfigurimin e PEI.
- Sistemi i Automatizuar i Identifikimit Biometrik, i cili menaxhon procesimin e të dhënave biometrike, deduplikimin dhe detektimin e rasteve të dyshuara si votim i dyfishtë.

Çdo pajisje e identifikimit elektronik përmban listat e plotë të zgjedhësve.

Zgjedhësit u identifikuan nëpërmjet letërnjoftimeve ose pasaportave.

Verifikimi i identitetit u bë në mënyrë elektronike për 93.3% të qendrave të votimit, duke skanuar kodin MRZ të dokumentit të identifikimit nga pajisja e identifikimit elektronik.

Si pjesë e procesit të identifikimit u bë dhe skanimi i gjurmëve të gishtërinjve i cili zëvendësoi nënshkrimin në listën e zgjedhësve, ky skanim u ruajt në memorien e pajisjes e me pas u transferua në serverin qendror të SEIV për verifikime të mëtejshme paszgjedhore.

Sistemi i prokuruar sipas dhe raportit nga OSBE-ODIHR plotësoi objektivat ligjorë dhe teknikë të vendosura në rregulloret përkatëse.

Gjate kësaj periudhe ndër të tjera u implementuan dhe pikat e mëposhtme:

- Ndryshimet dhe përmirësimet në software, përfshirë këtu; implementimin e transmetimit të të dhënave statistikore drejt serverit të KQZ, përmirësimeve në procedurën e identifikimit dhe nënshkrimit të zgjedhësit, ndryshimin e formatit të qendrës së votimit, etj.
- Konfigurimi i Pajisjeve dhe Serverit sipas specifikimeve për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023.
- Ngritjen e platformës online për rekrutimin e Operatorëve teknik të PEI, teknikëve të suportit në terren dhe trajnuesve të operatorëve. Përzgjedhjen dhe rekrutimin e rreth 5300 operatorëve. Përzgjedhjen dhe rekrutimin e 188 teknikëve të suportit në terren. Përzgjedhjen dhe rekrutimin e 58 trajnuesve.
- Trajnimin e 58 trajnuesve të jashtëm dhe 188 teknikëve të suportit në terren si dhe stafit të KQZ gjatë muajve prill - maj. Trajnimin e rreth 5300 operatorëve në të gjitha bashkitë, në rreth 25 qytetet kryesore të vendit, si dhe në Tiranë në një hark kohor 2 javor prej 58 trajnuesve të jashtëm të supervizuar prej stafit të përhershëm dhe të përkohshëm të KQZ, si dhe ritrajnimeve ose trajnimeve shtesë jashte periudhës së rregullt ose trajnimeve online gjatë ditëve të fundit përpara zgjedhjeve.
- Transportimi i të gjitha pajisjeve drejt 92 KZAZ-ve, përfshirë këtu dhe pajisjet rezervë që u përdorën nga stafi teknik i suportit në terren i KQZ për zëvendësim në rast difekti gjatë ditës së zgjedhjeve.

Referuar kërkesave të Kodit Zgjedhor u krye testimi publik (UAT) më datë 5 maj për 3% të pajisjeve të prokuruar, në seancë publike në prani të mediave.

KQZ realizoi në masën 100% të përgatitjes dhe disponueshmërinë me Pajisjet e Identifikimit Elektronik për të gjitha qendrat e votimit në të gjitha KZAZ-të.

Ditën e zgjedhjeve me datë 14 maj, PEI-t u aktivizuan në rreth 93.3% të qendrave të votimit. Në 1.3% ose 68 të qendrave të votimit nuk u arrit të rekrutohej operator ose operatori nuk u paraqit në QV e caktuar (9 QV), kjo kryesisht në qarqet Vlorë e Gjirokastrë, në bashkitë Konispol, Finiq, Dropull, zona në të cilat ka qenë i vështirë rekrutimi edhe për zgjedhjet e vitit 2021.

Për pjesën e mbetur prej 5% (281 QV) të QV, procesi i identifikimit u krye manualisht me metodën klasike të listës fizike të zgjedhësve për shkak të problemeve teknike me pajisjen, nga këto; 199 pajisje nuk u arrit të vihen fare në funksion, pjesa tjetër prej 82 pajisjesh u vunë në funksion por gjatë procesit zgjedhor shfaqën probleme teknike që e bënë të pamundur përdorimin. KQZ ngriti një grup pune për verifikimin e problematikave me pjesëmarrjen e kompanisë furnizuese dhe ekspertëve të jashtëm. Pas procesit të verifikimit rezultoi se një pjesë e pajisjeve keqfunksionuan për shkak të problemeve me leximin e listës zgjedhore nga usb (rreth 230) ndersa pjesa tjetër për shkak të mos konfigurimit të saktë nga stafi (rreth 50). Për të parandaluar problematika të tilla në zgjedhjet e ardhshme procedurat dhe verifikimet gjatë procesit të përgatitjes do të rishikohen dhe shtohen respektivisht për të garantuar funksionimin 100% të pajisjeve.

Ditën e zgjedhjeve për përsëritjen e zgjedhjeve në Bashkinë Rrogozhinë me datë 23 korrik PEI-t u aktivizuan në 100% të qendrave të votimit.

Pas procesit zgjedhor të datës 14 maj dhe 23 korrik u tërhoqën të gjitha pajisjet prej KZAZ-ve dhe u transportuan drejt magazinave të KQZ prej nga ku u transferua informacioni nga çdo PEI drejt serverit SEIV për qendërzimin e të dhënave dhe verifikimin e tyre paszgjedhor. Pas konsolidimit të të dhënave në server, gjatë procesit të verifikimit pas-zgjedhor, stafi i KQZ filloi procesin e kryqëzimit i cili realizohet nga komponenti ABIS (Automated Biometric Identity System). Rastet e gjeneruara nga sistemi pas verifikimit nga stafi i KQZ iu referuan organeve të prokurorisë për procedim penal.

Pas procesit të qendërzimit të të dhënave dhe verifikimit të tyre paszgjedhor, KQZ për herë të 3-të gjeneroi dhe publikoi raporte statistikore në lidhje me procesin zgjedhor të vitit 2023. Këto raporte përmbajnë:

- a. Përqindja e pjesëmarrjes në zgjedhje sipas grupmoshave
- b. Pjesëmarrja e moshave sipas fashave orare
- c. Pjesëmarrja e moshave sipas fashave orare me ndarje gjinore
- d. Pjesëmarrja sipas gjinisë
- e. Pjesëmarrja meshkuj/femra sipas moshës
- f. Votues për herë të parë mbi 18 vjeç,etj.

Pas procesit të qendërzimit të të dhënave dhe verifikimit të tyre paszgjedhor, me urdhër të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, KQZ kreu procesin i verifikimit të të dhënave daktiloskopike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik. Kryqëzimi i të dhënave daktiloskopike gjeneroi kategoritë e mëposhtme të rasteve të dyshuara të votuesve të shumëfishtë:

Për zgjedhjet e datës 14 maj 2023

ID e njëjtë	44	88
Shenjë gishti e njëjtë >2	77	511
Shenjë gishti e njëjtë =2	134	268
Total	255	867

Për përsëritjen e zgjedhjeve në Rrogozhinë të datës 23 korrik

ID e njëjtë	0	0
Shenjë gishti e njëjtë >2	2	8
Shenjë gishti e njëjtë =2	3	6
Total	5	14

Rastet e verifikuara i referohen organeve të prokurorisë për hetim të mëtejshëm.

Në përfundim të procesit zgjedhor të vitit 2023 si dhe në përgatitje të procesit zgjedhor kombëtar të vitit 2025, KQZ filloi një proces rishikimi të procedurave, ashtu siç është përmendur dhe më sipër, si dhe të dhënave në dispozicion për të përmirësuar teknologjinë dhe programin operativ të sistemit të identifikimit elektronik, me synim;

- Rregullimin e problematikave të shfaqura gjatë ditës së zgjedhjeve,
- Rritjen e transparencës ndaj publikut,
- Monitorimin e operacioneve gjatë ditës së zgjedhjeve,
- Përmirësimin e përdorimit të pajisjeve,
- Rritjen e rendimentit të operacioneve në QV,
- Shkurtimin e kohës së identifikimit dhe votimit gjatë ditës së zgjedhjeve.
- Rritjen sigurisë së pajisjes

2. Votimi dhe Numërimi Elektronik

Projekti pilot i votimit dhe numërimit elektronik u zbatua për herë të parë në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021, në ZAZ nr. 40, Qarku Tiranë, si dhe në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 mars 2022, në Bashkinë Vorë. Pas pilotimit të suksesshëm në dy rastet e

sipërpërmendura, u propozua që projekti pilot për procesin e votimit dhe numërimin elektronik (VE) të zbatohet edhe për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 duke zgjeruar zonën e implementimit. Bazuar në fondet e alokuara, u dakordësua që për këto zgjedhje, votimi dhe numërimi elektronik të shtrihet në Bashkitë Vorë, Kamëz dhe Elbasan.

Qëllimi kryesor i përdorimit të VE është të modernizojë dhe të përmirësojë procesin zgjedhor. Disa nga qëllimet kyçe të këtij projekti:

1. Efikasiteti dhe shpejtësia: Përdorimi i teknologjisë lejon që votimi të bëhet më shpejt dhe më efikas për votuesit. Numërimi automatik i votave gjithashtu redukton kohën e nevojshme për numërimin e votave.
2. Reduktimi i gabimeve njerëzore: VE mund të reduktojë gabimet njerëzore që ndodhin gjatë procesit manual të numërimin të votave.
3. Siguria e procesit: Përdorimi i sistemeve të sigurta dhe të enkriptuara siguron integritetin e votave dhe minimizon rrezikun e manipulimit të rezultateve zgjedhore.
4. Transparenca dhe besueshmëria: Përdorimi i teknologjisë shton transparencën dhe besueshmërinë në procesin zgjedhor duke lejuar për një mbikëqyrje më të lehtë të të gjitha fazave të votimit dhe numërimin.

Këto qëllime synojnë të bëjnë procesin zgjedhor më të lehtë, më të drejtë dhe më të besueshëm për të gjithë pjesëmarrësit.

Sistemi i Votimit dhe Numërimin Elektronik përmban:

- a. Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Votimit dhe Rezultateve (SEMVR)
- b. Pajisje Elektronike e Votimit dhe Numërimin (PEVN).

PEVN është një njësi votimi elektronike me ekran me prekje, e besueshme dhe e saktë, që mundëson zgjedhje të sigurta dhe të auditueshme. PEVN-të ofrojnë votimin elektronik si dhe përlllogaritjen e rezultatit përfundimtar në nivel të Qendrës së Votimi pas mbylljes së procesit të votimit. Makineritë e votimit thjeshtojnë të gjithë procesin e votimit, duke përmirësuar përvojën zgjedhore. Votimi elektronik bëhet në pajisje lokale që nuk janë të lidhura me internetin, ndërsa procesi i identifikimit të zgjedhësve është i ndarë proceduralisht dhe teknologjikisht nga procesi i votimit për të garantuar fshehtësinë e votës.

Për të zbatuar votimin dhe numërimin elektronik në 401 qendra votimi që bënin pjesë në Bashkitë Vorë, Kamëz, Elbasan, u blenë 760 pajisje të reja duke e çuar numrin total të pajisjeve në 828. Pajisjet PEVN të përdorura në zgjedhjet e 14 majit 2023 kishin përmirësime si më poshtë:

- Integrimi me printerin e ri Cut and Drop (CDE-110), i përdorur për të printuar si VVPAT (votat në kutinë e votimit) dhe Raporte.
- Transmetimi i rezultateve nga Vendi i Votimit duke përdorur një dongle USB 3G/4G.
- Rregullime në menynë e Panelit të Kontrollit dhe Menaxho Sondazhet.

- Integrimi me SmartTasks. Përshtatja e pajisjes përfshinte një hap për transmetim një paketë për SmartTask; nëse një paketë e tillë nuk do të transmetohej, atëherë pajisja do të transmetohej mos printoni raportin e instalimit.
- Sinkronizimi i datës dhe orës me shërbimin NTP, duke përdorur modemën USB.
- Dy instanca votimi në vijim të njëra tjetrës në përputhje me fletët e votimit, fillimisht fleta e votimit për kryetar dhe më pas ajo për këshill.

Me akt të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 415, datë 26.04.2023, u propozua caktimi i Bashkive Elbasan, Vorë, Kamëz ku do të zbatohet projekti pilot, për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023

Në tre bashkitë Elbasan, Kamëz e Vorë kishim gjithsej 401 QV dhe 311.846 zgjedhës u përdorën 802 pajisje PEVN, dy për çdo QV.

Me vendimin nr. 16, datë 13.4.2023, “Për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” të Komisionit Rregullator u përcaktuan bashkitë ku do të zhvillohet votimi elektronik.

Me vendimin nr. 17, datë 13.4.2023, “Për miratimin e rregullave procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik me anë të pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN), në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, të Komisionit Rregullator u miratuan rregullat procedurale gjatë procesit të votimit elektronik.

Gjithashtu, Komisioni Rregullator me vendimin nr. 14, datë 29.03.2023, miratoi aktin “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve që duhet të plotësojë personeli i kualifikuar për përdorimin e pajisjes elektronik të votimit dhe numërimit të zgjedhësve në qendrën e votimit, si dhe të procedurave të rekrutimit”. Për këtë proces u përzgjedhën 423 operatorë PEVN.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kreu demonstrimin e funksionimit të pajisjeve për një periudhë 7 (shtatë) ditore, si pjesë e rëndësishme e implementimit të VE në tre bashkitë e sipërpërmendura. Ky proces ishte pjesë e edukimit të zgjedhësve. Demonstrimi i pajisjeve PEVN u zhvillua në ambiente publike që u vunë në dispozicion nga Bashkitë Vorë, Kamëz dhe Elbasan.

U përgatiten 14 pajisje të cilat u shpërndanë :

Pajisje për demonstrim	Pajisje kryesore	Elbasan - 6 pajisje Kamëz - 4 pajisje Vorë - 2 pajisje
	Pajisje rezervë	2 pajisje
Total		14 pajisje PEVN

Testimi publik operacional (UAT) i pajisjes PEVN u zhvillua në datë 4 maj 2023 dhe u ftuan të merrnin pjesë partitë politike, mediat, organizata vendase dhe të huaja, në ambientin e paracaktuar nga KQZ. Testimi operacional (UAT) përmbante ekzekutimin dhe validimin e të gjitha proceseve në çdo pajisje PEVN sipas KZAZ-ve. Proceset e ekzekutuara ishin:

Hapja e votimit, votimi me 50 vota në çdo pajisje, mbyllja e votimit, printimi i raportit nga pajisja PEI, transmetimi i rezultateve, printimi i raportit përmbledhës për çdo ZAZ nga sistemi.

Për testimin operacional u përdoren 24 (njëzet e katër) pajisje të votimit elektronik (PEVN) të cilat përbëjnë 3% të pajisjeve totale që u përdoren gjatë votimit në Bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë. Këto pajisje ishin të konfiguruar sipas zonave ku do të zhvillohet votimi elektronik:

- 13 pajisje për Bashkinë Elbasan,
- 8 pajisje për Bashkinë Kamëz,
- 3 pajisje për Bashkinë Vorë.

Për të trajnuar operatorët që do të përdornin pajisjen PEVN në ditën e votimit u organizua fillimisht ToT (trajnimi i trajnerëve) nga kompania. Në këtë trajnim morën pjesë 25 persona.

Gjithashtu nga kompania u organizua trajnimi mbi përgatitjen e teknikëve të mbështetjes në terren. Në këtë trajnim morën pjesë 61 persona.

Nga KQZ u organizuan trajnimet e 423 operatoreve të PEVN në Tiranë dhe në Elbasan, sipas një skeduli të paracaktuar.

Disa nga konkluzionet mbi implementimin e Votimit dhe Numërimit Elektronik në këto bashki janë si më poshtë:

- Duhet një vëmendje e shtuar ndaj procesit të rekrutimit dhe trajnimit të operatorëve teknikë të ngarkuar me përdorimin e pajisjes PEVN;
- Rritja e pjesëmarrjes dhe edukimit të zgjedhësve gjatë procesit të demonstrimit të pajisjeve PEVN; Duhet të zgjerohen fushata gjithëpërfshirëse për edukimin e votuesve për të familjarizuar votuesit me funksionimin e makinerive elektronike të votimit. Kjo ndihmon në ndërtimin e besimit, në zbutjen e shqetësimeve dhe do të siguronte që votuesit të kuptojnë se si t'i përdorin makinat në mënyrë efektive.
- Është thelbësore të krijohen mekanizma për verifikimin dhe auditimin e pavarur të sistemeve të votimit elektronik.
- Duhet të rishikohet mënyra e shpërndarjes dhe dorëzimit të PEVN-ve duke vlerësuar mundësinë e transportimit nga KQZ në KZAZ. Shpërndarja e pajisjeve nga KQ në KQV me rritjen e numrit të QV-ve ku implementohet votimi elektronik është sfidues dhe me rrezik të lartë.

3. Kamerat në VNV dhe në QV

KQZ ka rritur nivelin e kontrollit dhe të transparencës gjatë procesit zgjedhor duke vendosur regjistrimin e pamjeve video të procesit të votimit nëpërmjet kamerave në të gjithë qendrat e votimit dhe në vendet e numërimit të votave. U tregua kujdes i veçantë që të ruhej fshehtësia e votës gjatë procesit të votimit të zgjedhësve duke i vendosur kamerat në një lartësi të kufizuar, ku nuk kishte pamje video në dhomat e fshehta të votimit.

- Kamera për regjistrim video të procesit të votimit ishin në 5212 QV-të;
- Kamera për regjistrimin video të procesit të numërimit të votave në 92 VNV.

a. Kamera për regjistrim video të procesit të votimit

Përgatitja e kamerave në QV për zgjedhjet e datës 14 maj 2023 është e ndarë në fazat:

- Testimi dhe vlerësimi për sistemet e video monitorimit në qendrat e votimit. Për shkak se këto pajisje janë përdorur në dy palë zgjedhje, në ato të përgjithshmet e vitit 2021, si dhe në zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, u pa e nevojshme të bëhej një testim dhe vlerësim i pajisjeve. Nga ky testim u identifikuan problemet që kishin kamerat, pjesët përbërëse të sistemit të monitorit dhe u përcaktua numri i saktë i pjesëve që duhej për të bërë funksionale të gjitha kamerat.
- Kontraktimi i kompanisë për shërbim dhe materiale për përgatitjen e kamerave në QV, për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023.

b. Kamera për regjistrimin video të procesit të numërimit të votave.

Regjistrimi video i procesit të numërimit të votave është përcaktim ligjor dhe standard mbi transparencën dhe besueshmërinë e procesit të cilin KQZ e realizon që prej disa zgjedhjesh. Regjistrimi video i numërimit të votave është vlerë e shtuar e besueshmërisë së procesit zgjedhor. Sistemi i regjistrimit të procesit të numërimit të votave si dhe transmetimi në kohë reale i pamjeve video të tavolinave të numërimit të votave në KQZ, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 u realizua plotësisht dhe pa asnjë problematikë, ndërprerje ose mungesë informacioni video.

KQZ administroi plotësisht pamjet video për të 92 Vendet e Numërimit të Votave dhe iu përgjigj të gjitha kërkesave të subjekteve politike të interesuara, kandidatëve të pavarur dhe kandidatëve të subjekteve politike.

Problematikat e kamerave në QV

Nga raporti përfundimtar i dorëzuar për pamjet filmike të Qendrave të Votimit, rezultoi se nga 5212 kamera në total, 312 prej tyre nuk kanë pamje filmike. Kjo vjen si rezultat i problemeve teknike që u hasen gjatë ditës së zgjedhjeve, si dhe në disa raste gabime njerëzore.

- Si probleme teknike janë identifikuar rastet e defekteve që kanë pësuar prizat si pasojë e amortizimit në godinat ku zhvillohet procesi i votimit, si dhe ndonjë problem teknik ose dëmtim gjatë transportit, nga magazina në KZAZ dhe nga KZAZ në QV.

- Detyrimin për vënien në punë të kamerës e kanë operatorët e identifikimit elektronik. Për 66 QV nuk u arrit të kishim operator dhe rrjedhimisht disa kamera të vendosura në këto QV nuk kanë qenë funksionale.
- Gabim njerëzor i ndodhur dhe i evidentuar më shpesh, është ai i vendosjes në prizë vetëm i bllokut të ushqimit, pa vendosur fishën e kamerës (shembull). Kjo bën që kamera të mos regjistrojë asnjë moment të procesit të votimit.

3. Të tjera

KQZ, gjatë proceseve zgjedhore, ka përdorur zgjidhjet IT si shërbime që implementoheshin vetëm gjatë periudhës së zgjedhjeve (Ad-Hoc). Për të lehtësuar menaxhimin e proceseve të punës, KQZ po digjitalizon proceset kryesore me anë të sistemeve IT. Kjo rrit efikasitetin, saktësinë, transparencën dhe siguron një raportim më të shpejtë në publik.

Për këtë arsye janë krijuar “From Scratch” platforma, aplikacione të cilat lehtësojnë punën e KQZ-së dhe palëve të treta të lidhura me KQZ-në si partitë politike, organizatat vendase e ndërkombëtare. Gjithashtu këto aplikacione shërbejnë për informimin e zgjedhësve për çdo proces që u intereson.

KQZ APP

KQZ e financuar nga qeveria Zviceriane implementoi aplikacionin KQZ për platformat IOs dhe Android si një platformë informimi për qytetarët si dhe një platforme komunikimi mes KQZ-së dhe administratës zgjedhore, KZAZ-ve e KQV-ve.

Aplikacioni i KQZ-së do të integrojë të gjitha aplikacionet e ueb portaleve (të njohura si module) që synojnë disa përdorues (p.sh. partitë politike, stafin potencial të përkohshëm të KQZ-së, stafin e EMB-së, votuesit, publikun e gjerë, organizatat ndërkombëtare dhe lokale që kërkojnë të akreditohen si vëzhgues, etj.).

KQZ APP ofron informacione për votuesin; ku do të votojë (hartë interaktive e qendrës së votimit), si të votojë, për kë të votojë, emërimi i organeve zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë (aplikimi online deri në nominim).

- Ky aplikacion u shkarkua nga App Store (IOS) dhe Play Store (Android) nga 26000 përdorues, fig 1. Numri më i madh i shkarkimeve të aplikacionit (shkarkime sipas shteteve) u bë nga Shqipëria por edhe nga vende të tjera, fig 2.






Figura 1: Nr i përdoruesve që kanë shkarkuar aplikacionin sipas shteteve

Gjithashtu aplikacioni KQZ u përdor dhe si një platformë komunikimi ndërmjet KQZ-së dhe administratës zgjedhore duke mundësuar raportimin live të situatës nga KZAZ-të dhe QV-të.



Janë krijuar për app KQZ në



1828 përdorues rolin e

sekretarit/anëtarit/kryetarit të KZAZ dhe anëtarit/kryetarit të QV. U implementua për herë të parë në zgjedhjet e 14 majit për të raportuar situatën nga kryetarët/sekretarët e KZAZ-ve dhe KQV-ve. Problemi kryesor gjatë raportimit ishte ndryshimi i vazhdueshëm i stafit të KZAZ dhe KQV.

Raportim nëpërmjet aplikacionit u krye edhe nga operatorët e Identifikimit Elektronik për zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Kukës. U raportua mbi pjesëmarrjen dhe ecurinë e procesit gjatë ditës së votimit. U krijuan 89 përdorues për operatorët e PEI për raportim për zgjedhjet e përsëritura të datës 24 shtator në Bashkinë Kukës.

Portali i Vëzhguesve

Portali i Vëzhguesve është një tjetër sistem i implementuar me ndihmën e qeverisë zviceriane. Qëllimi kryesor i këtij sistemi është regjistrimi dhe akreditimi i vëzhguesve të organizatave në proceset zgjedhore nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Organizatat aplikojnë për regjistrim përmes portalit i vendosur në faqen zyrtare të internetit www.kqz.gov.al. Pas aplikimit, autorizimi për profilin e tyre jepet nga KQZ. Pas miratimit, organizatat mund të regjistrojnë dhe dërgojnë për miratim vëzhguesit e tyre në KQZ. Ata janë përgjegjës për ngarkimin e dokumentacionit për secilin vëzhgues në sistem. Në fund, organizata merr autorizimin elektronik të vëzhguesit për secilin punonjës të tyre.

Portali mundëson aplikimin online për të gjitha organizatat ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja si dhe mediat që kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues në zgjedhje. Komunikimi me KQZ-në bëhet online dhe procesi lehtësohet për të dyja palët. Aplikacioni u përdor për herë të parë në zgjedhjet e përsëritura për Kryetar Bashkie në Rrogozhinë.

- Në portal janë regjistruar 15 organizata për zgjedhjet e ripërsëritura për Kryetar Bashkie në Rrogozhinë dhe për zgjedhjet për Kryetar Bashkie në Kukës;
- Janë certifikuar 125 vëzhgues për zgjedhjet e përsëritura për Kryetar të Bashkisë Rrogozhinë;
- Janë certifikuar 87 vëzhgues për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kukës.




Figura 2 Të dhëna nga Portali i Vëzhguesve

Portali i Partive Politike

Portali i Partive Politike është një tjetër aplikacion i implementuar me ndihmën dhe mbështetjen e qeverisë Zviceriane. Ky aplikacion sjell lehtësi si për subjektet zgjedhore, kandidatët e pavarur, ashtu edhe për administrimin e procesit zgjedhor nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve /KZAZ-të, duke krijuar qartësi në procedurë dhe në përmbajtje. Mundëson regjistrimin online të partive politike dhe më pas kthimin në subjekte zgjedhore, dorëzimin e dokumentacionit, listat e kandidatëve, propozimin e komisionarëve zgjedhorë dhe të gjitha sa më sipër vlerësohen nga stafi i KQZ-së/administrata e KZAZ-së.

Sistemi u përdor për herë të parë në zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kukës.

Në zgjedhjet e 24 shtatorit 2023 për Kryetarin e Bashkisë Kukës janë regjistruar në sistem:

- 6 parti politike
- 5 subjekte zgjedhore

#	Logo	Dt. e pranimit	Emërtimi i partisë	Shkronjat nistore	NIPT	Kryetari i partisë	Veprime
1.		31-08-2023, 13:14	Partia Demokratike e Shqipërisë	PD OSE PDSH	K51919009E	Lulzim Basha	
2.		14-09-2023, 12:43	Partia Demokratiane e Shqipërisë	PDK	A33333333B	Nard Ndoka	
3.		01-09-2023, 15:49	Partia për Europianizimin dhe Integrimin e Shqipërisë	PEISH	A11111111B	Rivelino Çuno	
4.		01-09-2023, 16:18	Partia e Lirisë	PL	A22222222B	Ilir Metaj	
5.		31-08-2023, 13:12	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS	K71329002F	Edi Rama	

Figura 3 Subjekte zgjedhore të regjistruara në sistem

Platforma elektronike e raportimit financiar (PERF)

Një nga aplikacionet e implementuara nga KQZ me ndihmën e Këshillit të Evropës dhe Delegacionin e BE-së është Platforma e Elektronike e Raportimit Financiar PERF. Platforma ka si qëllim rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë në proceset e raportimit dhe auditimit financiar. Platforma jep mundësi të aksesohen raportet financiare të partive, vlerësimin e audituesve si dhe raportet e monitoruesve gjatë fushatës zgjedhore.

Sistemi u implementua për herë të parë gjatë zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të 14 majit 2023. Në sistem u regjistruan 1675 raportime të monitoruesve.

IEMIS (Sistemi i integruar i menaxhimit të informacionit zgjedhor)

KQZ ka përdorur shërbimin e IEMIS (Sistemi i integruar i menaxhimit të informacionit zgjedhor), një shërbim i cili ofrohet vetëm gjatë periudhës së zgjedhjeve, i përbërë nga disa module specifike, parazgjedhore, në ditën e zgjedhjeve dhe paszgjedhore. Ky shërbim do të zëvendësohet pak nga pak nga sisteme të qëndrueshme në pronësi të KQZ-së si portali i Vëzhguesve, ai i Partive Politike e të tjera në vijim.

Gjatë zgjedhjeve të 14 majit u përdor ky shërbim me qëllim automatizimin dhe lehtësimin e proceseve si:

- Regjistrimi i kandidatëve dhe listat shumëmemërore të tyre;
- Regjistrimi dhe publikimi i formularëve të vetdeklarimit;
- Rezultatet e zgjedhjeve;
- Shpërndarjen e mandateve për këshilltarë për njësitë e qeverisjes vendore.


Për herë të parë u digjitalizua një pjesë e procesit të administrimit dhe publikimit të formularëve të vetdeklarimit duke shkurtuar kohën e përpunimit të dokumentacionit voluminoz. DLD, në

bashkëpunim me Sektorin e Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit dhe atë të Protokollit, kreu skanimin e 23.907 formularëve të vetëdeklarimit, publikimin në faqen zyrtare të këtyre formularëve dhe CV-të e çdo kandidati për kryetar bashkie dhe për këshill bashkiak.

Faqja zyrtare dhe raportimi i aktiviteteve

Faqja zyrtare e web-it www.kqz.gov.al shërben si dritare informacioni për qytetarët, partitë politike, median dhe të gjitha palët e interesuara në proceset zgjedhore.

Gjithashtu si ndërfaqe është ndërtuar portali <https://aktivitete.kqz.gov.al> nëpërmjet të cilit të gjithë institucionet publikuan aktivitetet e tyre.



Gjatë periudhës 13 – 16 maj, numri i personave që kanë aksesuar faqen www.kqz.gov.al është rreth 407 967.

Kreu II: Dita e Zgjedhjeve dhe numërimi i votave

1. Hapja e QV

Në ditën e zgjedhjeve shqetësimi kryesor ishte sigurimi i kuorumit të administratës zgjedhore të nivelit të tretë në KZAZ-të që kishin raportuar mungesa të propozimeve nga subjektet politike. Sikundër është evidentuar nga raportimi i KZAZ-ve dhe monitoruesve, në ditën e votimit mungoi 3% e anëtarëve të KQV-ve dhe u paraqitën në detyrë 34,647 anëtarë.

Lidhur me fillimin e procesit sipas raportimeve nga KZAZ-të dhe vetë QV-të në linkun e dërguar, është evidentuar se:

- 77% e QV-ve kanë filluar procesin në ora 07:00,
- 13% e QV-ve kanë filluar procesin në ora 07:30,
- 11% e QV-ve kanë filluar procesin pas orës 08:00.

2. Procesi i votimit

Dita e zgjedhjeve, përveç vonesave në disa qendra votimit të cilat erdhën si pasojë e mosfunksionimit të pajisjes PEI, ka qenë e qetë dhe e mirë administruar nga administrata zgjedhore.

KQZ në zgjedhjet e datës 14 maj 2023 aplikoi linjat e ndihmës për komisionerët e QV me sistem interaktiv. U vendosën në dispozicion të publikut dhe komisionerëve një linjë telefonike e gjelbër e ndihmës për të adresuar shqetësimet e administratës zgjedhore, si dhe kanalet e komunikimit në platformat Whatsapp dhe Telegram sikundër edhe në aplikacionin KQZ. Ditën e zgjedhjeve në linjën e ndihmës u administruan rreth 277 telefonata ku pjesën kryesore më të madhe u raportua mosfunksionimi apo problematika të hasura me PEI (126 raste).

Problematikat e tjera të raportuara ishin të shumëllojshme të tilla si mungesë apo shqetësime me materialet e votimit, votim familjar, funksionalitetin e kamerave, intimidim të zgjedhësve, mbipopullim të qendrave të votimit në ambientet e jashtme, votim pa kartë...etj)

Referuar vendimmarrjes së KZAZ-ve dhe listës së pagesave të dërguar nga KQZ për çdo bashki rezulton se në total nga 5213 QV:

- 57 QV kanë zhvilluar procesin e votimit me 4 anëtarë,
- 205 QV kanë zhvilluar procesin e votimit me 5 anëtarë,
- 351 QV kanë zhvilluar procesin e votimit me 6 anëtarë,
- 4600 QV kanë zhvilluar procesin e votimit me 7 anëtarë.

Në total sipas raportimeve rezulton që 3% e anëtarëve të KQV nuk janë paraqitur në detyrë/plotësuar si pozicione. Rreth 205 qendra votimi kanë kaluar procesin e verifikimit të zgjedhësve nëpërmjet listës së zgjedhësve (manualisht).

BAZA MATERIALE

- 2 QV problem me fletët e votimit (2275/01 Peqin mungonin 500 FV për kryetar dhe 3209/01 në Fier mungonin 500 FV për këshill),
- 2 QV në Devoll problematikë me kutinë e votimit (dëmtuar kapaku ku vendoset Kodi i pestë),
- 21% e QV të mbipopulluara në orët e para të ditës.

Nëpërmjet numrave të telefonit/ numrit jeshil vënë në dispozicion të zgjedhësve si dhe nëpërmjet aplikacionit KQZ, janë raportuar denoncime dhe problematika të ndryshme.

- 14 raste denoncimesh të administruara nga aplikacioni.


Denoncimet kanë për objekt kryesisht parregullsi nga ana e komisionerëve në QV, funksionimi i PEI, problem aksesimi i QV nga personat me aftësi ndryshe kryesisht në bashkitë Tiranë, Kamëz, Selenicë, Dropull, Tropojë, Durrës, Elbasan.

Nga raportimet e stafit të kontraktuar nga KQZ ditën e votimit është vërejtur se:


- Në 11% të QV janë hasur vështirësi në aksesin/ gjetjen e QV,
- Në 58 QV është raportuar mbipopullim (orët e paradites),
- Në 62 QV janë konstatuar materiale propagandistike në distancë më të vogël se 150 metra,
- Është pezulluar votimi në 40 QV, për të rifilluar më vonë,
- Në 30 QV është raportuar votim në grup,
- Në 4 raste është raportuar për votim jashtë dhomës së fshehtësisë,
- Në 10% të QV-ve është përdorur lista e zgjedhësve në mënyrë manuale,
- Në 2 QV (1 QV në Elbasan dhe 1 QV në Paskuqan) është votuar me 1 PEVN. Procesi ka përfunduar në orën 19:00 pa u raportuar ndonjë problematikë përgjatë transportimit të bazës materiale në KZAZ.

3. Votimi dhe numërimi elektronik (PEVN)

Votimi dhe numërimi elektronik përbënin një sfidë të veçantë për KQZ-në duke qenë se pilotimi i saj bëhej në disa bashki me shtrirje gjeografike, socio-kulturore të gjithanshme. Përgjatë ditës së zgjedhjeve administroi përshtypjet e votuesve në zonat zgjedhore ku u pilotua kjo teknologji. Në përgjithësi ekziston një perceptim pozitiv për sigurinë dhe lehtësinë e procesit nëpërmjet votimit dhe numërimit elektronik, ndonëse nga ana tjetër janë vënë re raste të izoluara lidhur me vështirësinë e përdorimit të këtij sistemi nga ana e zgjedhësve/ administratës zgjedhore.



Lidhur me fshehtësinë e votës pjesa më e madhe shprehen se fshehtësia e votës është e garantuar:



Pjesa më e madhe e të anketuesve kanë shprehur dëshirën për të votuar sërish me mjete elektronike



Procesi i votimit u realizua normalisht.

Të dhënat u transmetuan në një format të sigurtë dhe të pandryshueshëm nëpërmjet certifikatave dhe çelësave të enkriptuar nga PEVN drejt SEMVR. Informacioni i transmetuar transmetohet nga PEVN drejt SEMVR të KQZ u aksesua nga stafi përgjegjës i KQZ-së.

KQZ-ja filloi publikimin e rezultateve paraprake të votimit nga qendrat e votimit të cilat ishin pjesë e projektit pilot të votimit elektronik rreth orës 20:40 të ditës së zgjedhjeve.

4. Denoncimet ditën e zgjedhjeve

Më datë 14 maj 2023 janë administruar në total 45 parregullsi/denoncime për të cilat në përfundim të procedurës administrativ rezultuan mangësi në formë dhe në përmbajtje dhe për rrjedhojë është pushuar hetimi administrativ.

Sipas subjekteve zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë ka përcjellë 3 (tre) denoncime për thyerje të heshtjes zgjedhore dhe 1 (një) denoncim për presion ndaj zgjedhësve. Ndërsa subjekti Bashkë Fitojmë ka raportuar parregullsi lidhur me kandidatin i cili është në kushtet e ndalimit dhe fotografimit përpara dorëzimit të fletës së votuesit, si më poshtë vijon:

- Partia Socialiste 4 denoncime

Denoncim për Luciano Bocin, presion ndaj zgjedhësve në Bradashesh,
Denoncim për thyerje të heshtjes zgjedhore nga Luciano Boci (Elbasan),
Denoncim për thyerje të heshtjes zgjedhore nga Belind Këllici (Tiranë),
Denoncim për thyerje të heshtjes zgjedhore nga Bardh Spahia (Shkodër).

- Bashkë Fitojmë 2 denoncime

Denoncim për kandidatin e Aleancës Demokratike në Selenicë, si kandidat në kushtet e ndalimit për kandidim (Sokol Hodaj),

Denoncim ndaj anëtares së komisionit në QV 4229/00, ZAZ 80, Gjirokastrë, e cila ka plotësuar fletën e votimit, e ka fotografuar përpara se t'ia japë fletën votuesit.

Parregullsi të tjera të raportuara ditën e zgjedhjeve kanë pasur këto tipologji:

1. Nxjerrja jashtë e vëzhguesve të akredituar nga KQZ për organizatat H.A.N.A në QV-në 0737/00, KZAZ 12 dhe Komiteti Shqiptar të Helsinkit në 2 (dy) bashki, Berat dhe Lezhë:

- në Bashkinë Lezhë, në QV 0732/1,
- në Bashkinë Berat, në QV nr. 3273, KZAZ 65,
- QV-së 0687, KZAZ nr. 12. vërejtjet e vëzhguesve të KSHH nuk janë pasqyruar në proceverbalin e KQV. Intimidim i vëzhguesit të KSHH nga vëzhguesi i subjektit politik në KQV.

2. Prania dhe grumbullime të personave të paautorizuar jashtë QV, në bashkitë Durrës, Tiranë, Pogradec, Berat, Fier, Lezhë, Malësi e Madhe, Elbasan, Korçë dhe Vlorë.

- Shkolla Neim Babameto në Spitalë Durrës, duke u rikthyer qetësia pas shpërndarjes që ka bërë Policia e Shtetit,
- QV-të pranë Godinave të Fakultetit të Mjekësisë dhe Shkollës 9 vjeçare Bajram Curri, Tiranë,
- Bashkia Pogradec, në brendësi të dy QV-ve, 3900/00 dhe 3885/03,
- Bashkia Berat në QV 3273, 3273/1 dhe 3273/2,
- Bashkia Fier në oborret e qendrave të votimit, 3020/00, 3032/00, 2983/00, 3014/00,
- Bashkia Tiranë, në ambientet e jashtme të Shkollës “Dëshmorët e Lirisë”,
- Bashkia Lezhë, QV-së 0737, KZAZ 12,
- Bashkia Malësi e Madhe, në ambientet e jashtme të QV 0049,
- Bashkia Elbasan pranë QV-së 2307,
- Bashkia Korçë pranë QV 3669/1 shkolla Sevasti Qiriazi,
- Bashkia Vlorë, në fillim të procesit të votimit, në QV 4493, Shkolla Ismail Qemali,
- Bashkia Lezhë, Balldren.

3. Raportimi lidhur me elementë të votimit të shumëfishtë dhe familjar në këto zona:

- Bashkia Elbasan Në QV 2322,
- Bashkia Dibër Në QV 1142
- Bashkia Berat Në QV 3273/2,
- Bashkia Pogradec Në QV nr. 3885/03
- Bashkia Tiranë Në QV 2061/00, QV 2074/00, Në QV 1569/01,
- Bashkia Malësi e Madhe Në QV 0025

4. Intimidim i zgjedhësve në 6 bashki

- Bashkia Elbasan, Qv 2303/00, nga përfaqësues të Partisë Socialiste
- Bashkia, Kamëz
- Bashkia Tiranë, KZAZ nr 35, QV 1829
- Bashkia Peshkopi
- Bashkia Durrës, KZAZ 24, Shkolla Leonik Tomeo
- Bashkia Tiranë, Shkolla Kongresi i Manastirit
- Bashkia Lezhë
- Bashkia Kamëz, QV 1564/1

5. Identifikimi i zgjedhësve

- Në Bashkinë Elbasan, QV 2376, QV 2377 vëzhguesi ka vënë re prezencë të vëzhguesve të partive politike, konkretisht të subjektit zgjedhor PS, i cili mban shënime mbi identitetin e votuesit.

6. Fotografim i votës:

- QV 1963/00, Shkolla Qazim Turdiu, Tiranë.

7. Problem për aksesimin në QV nga PAK

- Bashkia Shkodër
- Bashkia Durrës, Shkolla Myslim Hida, Arapaj, Rrashbull,

5. Mbyllja e votimit

Dorëzimi i materialeve zgjedhore nga KQV në KZAZ (VNV) u krye pa problematika dhe brenda afatit kohor të përcaktuar në Kodin Zgjedhor.

Mbyllja e qendrave të votimit, pason me dorëzimin e materialeve zgjedhore nga KQV në VNV.

Përgjithësisht dorëzimi i materialeve zgjedhore nga KQV në VNV u realizua me qetësi dhe KZAZ ishin në komunikim të vazhdueshëm me KQZ-në për të gjithë procesin e dorëzimit.

Me administrimin e materialeve zgjedhore brenda orës 23:00 nga të gjithë KZAZ-të, u konstatuan në tërësi 4 kuti votimi të parregullta dhe 2 kuti votimi u deklaruan të parregullta për PEVN-të të cilat iu nënshtruan procesit të rishikimit administrativ.

1 kuti votimi për kryetar bashkie në KZAZ 58 Bashkia Fier,

3 kuti votimi për këshill bashkie në ZAZ-të 15 (QV-0907-00), 19 (QV1100/00) dhe 22 (QV 1467/03) ,

Në KZAZ nr. 27, Bashkia Kamëz janë deklaruar të parregullta PEVN-të për 2 qendra votimi, 1575/00 dhe 1597/00, për shkak të administrimit të vulës me kode sigurie nga ana e administratës zgjedhore dhe personelit teknik, të cilat u shqyrtuan administrativisht edhe nga KAS.

6. Numërimi dhe rezultati paraprak

KQZ monitoroi në vijimësi dhe me konsistencë 24/24 performancën e KZAZ-ve duke marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për disiplinimin dhe vazhdimin në mënyrë të pandërprerë të procesit të numërimit e të gjitha kutive të votimit të pranuar të rregullta.

Policia ndërhyri në dy raste për të rivendosur rendin në VNV. Një rast në KZAZ nr. 25, Bashkia Shijak dhe një rast me vendim të Komisionerit në KZAZ nr. 14, Bashkia Kurbin. Në KZAZ-në nr. 24, Bashkia Durrës procesi i numërimit të votave për këshillin e bashkisë pati ndërprerje të përkohshme prej 2 orësh.

Në KZAZ nr.14 Kurbin, procesi numërimit u pezullua dhe u kërkua ndërhyrja e policisë për shkak të konflikteve të krijuara dhe situatës së tensionuar të krijuar në ambientin e VNV. KQZ dërgoi personelin e tij për të asistuar në vijueshmërinë e procesit të numërimit.

Rritja e kërkesës së llogaridhënies ndaj KZAZ dhe rrjedhimisht edhe ndaj GNV bënë të mundur që rezultati paraprak i zgjedhjeve të deklarohet më datë 16.05.2023.

KQZ-ja filloi publikimin e rezultateve paraprake të votimit nga qendrat e votimit të cilat ishin pjesë e projektit pilot të votimit elektronik rreth orës 20:40 të ditës së zgjedhjeve.

7. Administrimi dhe arkivimi i dokumentacionit

Administrimi i dokumentacionit zgjedhor nga partitë politike dhe KZAZ, është kryer brenda afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Për herë të parë u aplikua një modul i cili lehtësoi procesin e administrimit të dokumentacionit Zgjedhor (formularët e vetëdeklarimit dhe dokumentat mbështesëse).

- Moduli gjeneroi regjistrin e FVD numrat unik 001-24058, si edhe u mbyll me numër rendor të faqeve 917.
- Ky regjistër zëvendësoi regjistrat për formularët e vetëdeklarimit në hard copy.
- Vula elektronike gjeneronte nr unik i cili korenspondonte në hard copy dosjes përkatëse.
- Kjo platformë ndihmoi edhe në administrimin e Dokumentacionit Zgjedhor nga KZA në KQZ.

Gjithashtu, nëpërmjet këtij sistemi, me anë të një procesverbali tip u mor në dorëzim dokumentacioni për 92 KZAZ.

Gjatë këtij procesi u administrua:

- Dokumentacioni për regjistrimin e partive politike,
- Dokumentacioni i listave të kandidatëve për Kryetar Bashkie, kandidatët për këshillat bashkiakë dhe për kandidatët e pavarur,
- Formularët e vetëdeklarimit për kandidatët kryetar bashkie si dhe lista për këshillat bashkiakë;
- Tabela përmbledhëse provizore për Kryetar,
- Tabela përmbledhëse Kryetar dhe Këshill,
- Tabela fletë të hedhura gabim Kryetar dhe Këshill,
- Libër protokolli, Procesverbal konstatimi,
- Vula KZAZ-je Regjistri i vendimeve të KZAZ dhe i korrespondencës,
- Seti PV hapje/ mbyllje sipas QV,
- Seti i vendimeve të KZAZ (numri i vendimeve),
- Të dhënat për çdo QV të KZAZ.

Procesi i përpunimit, numërtimit, klasifikimit të dokumentacionit administrativ kryhet sipas normave tekniko-shkencore, ligjit “Për Arkivat” në Republikën e Shqipërisë.

- dokumentacion për ruajtje të përhershme janë hapur 900 dosje, dhe
- dokumentacion me ruajtje të përkohshme janë hapur 220 dosje.

Gjatë vitit 2023 janë sistemuar, numërtuar dhe skanuar;

- 231 vendime, 4 udhëzime të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, 27 vendime të Komisionit Rregullator, 25 vendime të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve dhe inventari 231 i urdhrave Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Nga totali i akteve të Komisionerit, 16 (gjashtëmbëdhjetë) akte nënligjore, nga të cilat 6 (gjashtë) vendime dhe 10 (dhjetë) urdhra kanë dalë në bashkëushtim të kompetencave me Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Inventari, numërtimi dhe skanimi për 539 kontratave të punonjësve me kohë jo të plotë pune, të ndarë sipas drejtorive, kontratat e trajnuesve.
- Inventari, numërtimi dhe skanimi i kontratave për kohë transmetimi me 18 transmetues.
- Hapjen e dosjeve të punonjësve për pranimin në shërbimin civil me kohë të plotë pune.
- Përpunimi i dokumentacioni zgjedhor të përdorur për zgjedhjet vendore të datës 6 mars 2022, (Listat shumë-emërore të kandidatëve për Kryetar Bashkie të 4 subjekteve zgjedhore për 6 bashki) si dhe dokumentacioni i sjellë nga KZAZ-të pas përfundimit të procesit zgjedhor, 948 tabela e rezultateve dhe tabelat përmbledhëse të rezultateve për çdo QV.

Në fillim të vitit janë arkivuar pasqyrat financiare ndër vite 2012-2021, të administruara nga sektori i Kontrollit Financiar, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nga Sektori i Shërbimeve, për vitin 2019-2021 dhe të tjerë.

8. Marrja në dorëzim e kutive të numëruara dhe materialeve zgjedhore

Mbas përfundimit të procesit të numërimit të votave, filloi dorëzimi i kutive të votimit, kutive të materialeve zgjedhore (15639 kuti), dorëzimi i pajisjeve PEI, dorëzimi i pajisjeve PEVN si dhe dorëzimi i kamerave të përdorura në QV, nga ana e KZAZ-ve.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosi hapjen e kutive të votimit për bashkitë:

- Berat
- Mallakastër
- Rrogozhinë
- Kamëz (PEVN)
- Elbasan (PEVN)
- Belsh
- Pukë

Administrata e KQZ-së përgatiti infrastrukturën për materialet logjistike të nevojshme, për sjelljen e kutive të votimit, materialeve zgjedhore, hapjen, numërimin, mbylljen me kodet e sigurisë dhe më pas dërgimin në magazinë.

Gjithashtu Kolegji Zgjedhor vendosi hapjen dhe numërimin e 18 kutive të Bashkisë Kuçovë, në ambientet e Gjykatës Administrative.

9. Zgjedhjet e përsëritura në Rrogozhinë

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me vendimin nr. 28, datë 15.6.2023 arriti në përfundimin se, pavlefshmëria e zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, në qendrën e votimit nr. 2224/01 (pjesë e Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 43) sjell ndikim në rezultatin e zgjedhjeve duke shpallur të pavlefshme zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 në Zonën e Administrimit Zgjedhor nr. 43 për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë dhe duke urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve.

Komisioneri, më datë 4.7.2023 vendosi që zgjedhjet për kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë të përsëriten në datën 23 Korrik 2023.

Në funksion të organizimit dhe administrimit të procesit për përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar 12 (dymbëdhjetë) vendime nga të cilat:

- 1 vendim për caktimin e datës së zgjedhjeve,
- 2 vendime për strukturën buxhetore,
- 8 vendime në funksion të organizimit të zgjedhjeve dhe punës së administratës zgjedhore,
- 1 vendim për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë.

Komisioni Rregullator ka miratuar 1 (një) vendim për miratimin e afateve procedurale.

Me daljen e dekretit të Presidentit të Republikës për përsëritjen e zgjedhjeve për kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, të datës 23 korrik 2023, filloi puna për përgatitjen e bazës materiale të nevojshme për përgatitjen e infrastrukturës, për këto zgjedhje. Përveç fletës së votimit e cila u prodhua, çdo material tjetër u përdor nga zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

Raportimi i institucioneve publike

Për zgjedhjet e përsëritura për Kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, të datës 23 korrik 2023, ka pasur vetëm një raportim me postë elektronike për zhvillim aktiviteti, nga Bashkia Rrogozhinë.

Denoncime ankime

Për zgjedhjet e përsëritura në Rrogozhinë nuk janë administruar denoncime apo ankimime.

Përgatitja e zgjedhjeve të përsëritura

Në zgjedhjet e përsëritura për Kryetar Bashkie Rrogozhinë, KZAZ nr. 43, nuk pati ndryshime të administratës zgjedhore. Materialet dhe dokumentacioni zgjedhor u përshtat për këto zgjedhje të përsëritura duke garantuar furnizimin dhe zhvillimin në këto zgjedhjeve pa mangësi të materialeve të votimit dhe dokumentacionit të punës.

KQZ zhvilloi sesione trajnimi për anëtarët e KQV-së të cilët, edhe në zgjedhjet e përsëritura me 23 korrik, ishin të njëjtët komisionerë që administruan procesin në zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

- ***Edukimi dhe Informimi i Zgjedhësve***

Programi për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet e përsëritura për Kryetar bashkie Rrogozhinë të datës 23 korrik 2023, kishte për qëllim të informonte dhe ndërgjegjësoje zgjedhësit mbi aspektet kryesore të procesit zgjedhor. Në mënyrë specifike programi kishte si qëllim të informonte dhe edukonte zgjedhësit për datën e zgjedhjeve si dhe qendrën e votimit ku zgjedhësi voton, të informonte dhe edukonte zgjedhësit mbi procedurën e votimit dhe identifikimit elektronik, të informonte dhe edukonte zgjedhësit mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit, të informonte zgjedhësit mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor dhe parandalimi i tyre.

1. Informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi i zgjedhësve për listën e zgjedhësve, datën dhe llojin e zgjedhjeve.

Ky objektivi ka për qëllim të informojë zgjedhësit mbi datën e zgjedhjeve nëse kanë pasaktësi se ku duhet të drejtohen si dhe mjetet e ndryshme të komunikimit ku ata mund të gjejnë gjithë informacionin mbi procesin zgjedhor.

Mjetet e komunikimit që janë përdorur :

Media sociale (Është shpërdarë informacioni nëpërmjet spoteve, banera dhe mesazheve të ndryshme mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit).

Takim me zgjedhësit (Janë zhvilluar takime me votues për herë të parë, gratë dhe grupe të ndryshme vulnerabël të cilët ku u informuan se ku mund të gjejnë emrin e tyre në listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit.)

Aplikacioni “KQZ” (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendej qendra e votimit nga çdo zgjedhës nëpërmjet rubrikës “Ku votoj”)

Web KQZ (në website e KQZ është publikuar i gjithë informacioni mbi datën e zgjedhjeve dhe nëpërmjet web-it ku mund të gjendej qendra e votimit nga çdo zgjedhës.)

2. Ndërgjegjësimin e zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore për rëndësinë e procesit zgjedhor, zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara.

Ky objektivi ka për qëllim informimin e zgjedhësve dhe subjektet zgjedhore mbi veprat penale dhe shkeljet që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, si dhe parandalimi i tyre.

Mjetet e komunikimit që janë përdorur :

Media sociale (Është shpërdarë informacioni nëpërmjet spoteve, banera dhe mesazheve mbi parandalimin e veprave penale përgjatë procesit zgjedhor si dhe parandalimi i tyre.)

Takim me zgjedhësit (Janë zhvilluar takime me votues për herë të parë, gratë dhe grupeve të **ndryshme vulnerabël të cilët u informuan mbi veprat penale dhe si t’i parandalojnë.**)

Aplikacioni “KQZ” (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendej sesioni denonco shkeljet zgjedhore ku cilido mund të denoncoj shkeljet e ndryshme.)

Web KQZ (në website e KQZ është publikuar i gjithë informacioni mbi veprat penale.)

Spote televizive (Është transmetuar spoti mbi veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor në televizionet lokale që mbulojnë Bashkinë Rrogozhinë.)

Postera në çdo Qendër Votimi (Janë vendosur postera informues në të gjitha qendrat e votimit në Bashkinë Rrogozhinë mbi veprat penale në zgjedhje.)

3. Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit, përmbajtja e fletës së votimit dhe shënimin korrekt të saj.

Qëllimi i këtij objektivi është që zgjedhësit të jenë të përgatitur ditën e votimit për hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit në mënyrë që vota të jetë e vlefshme, duke qenë zgjedhje të përsëritura për Kryetar Bashkie në Rrogozhinë.

Mjetet e komunikimit që janë përdorur :

Media sociale (Është shpërdarë informacioni nëpërmjet spoteve, banera dhe mesazheve mbi hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit ditën e zgjedhjeve si dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.)

Aplikacioni “KQZ” (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendej sesioni “si mund të votoj” i cili shpjegon me video të gjitha hapat duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.)

Web KQZ (në website e KQZ është publikuar i gjithë informacioni në rubrikën “Edukimi i Zgjedhësve” mbi hapat duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.)

Spote televizive (Është transmetuar spot në televizionet lokale që mbulojnë Bashkinë Rrogozhinë mbi hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.)

Postera në çdo QV (Janë vendosur postera informues në të gjitha qendrat e votimit në Bashkinë Rrogozhinë mbi hapat duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit ditën e zgjedhjeve dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.)

- ***Vëzhgimi i zgjedhjeve***

Për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në Rrogozhinë datë 23.07.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve testoi për herë të parë përdorimin e Platformës Elektronike për regjistrimin e vëzhguesve jopolitikë. Platforma mundësoi në kohë reale dërgimin e listës për akreditim të vëzhguesve dhe gjithashtu i dha mundësinë çdo organizate apo media që të kontrollojnë listën e tyre në çdo moment.

Përmes Platformës u akredituan gjithsej 115 vëzhgues jopolitikë që përfaqësonin organizata vendase si dhe përfaqësues të mediave.

23 vëzhgues nga 5 organizata vendase: Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) me 16 vëzhgues afatgjatë, Qëndresa Qytetare me 5 vëzhgues afatshkurtër, Komiteti Shqiptar i Helsinkit me 2 vëzhgues afatgjatë si dhe Koalicioni për Zgjedhje të Lira dhe të Ndershme me 1 vëzhgues afatshkurtër. Mediat vendase akredituan 101 përfaqësues për vëzhgimin e zgjedhjeve në Rrogozhinë ku përfshihen: Euro Balkans News, ABC News, FOCUS MEDIA, MCN TV, G2 Media, MEDIA VIZION dhe ORA News.

- **Ankimet zgjedhore**

Në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme të Bashkisë Rrogozhinë, të datës 23 korrik 2023, nuk janë depozituar ankime në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

Kreu III: Ankimimet Zgjedhore

Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 janë depozituar 36 kërkesa ankimore ndaj vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të grupuara si vijon:

- a) 10 (dhjetë) kërkesa ankimore, për regjistrimin e subjekteve zgjedhore për të cilat vendimmarrja ka qenë si më poshtë:
 - KAS në **1 rast** vendosi regjistrimin e PDSH me kryetar z. Enkelejd Alibeaj; **1 rast** vendosi ndryshimin e vendimit të KSHZ dhe detyrimin për të regjistruar Partinë me emrin “Aleanca Progresiste LZHK”; **5 raste mospranim** për shqyrtim; **3 raste rrëzimin** e ankimit
 - Kolegji Zgjedhor administroi 5 kërkesë padi. Në **1 rast** vendosi të detyrojë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të regjistrojë partinë politike “Lëvizja Bashkë”; **4 raste** vendosi rrëzimin e padisë.
- b) 2 (dy) kërkesa ankimore, ndaj regjistrimit të kandidatit për kryetar bashkie të Mallakastrës, z. Qerim Ismailaj (verifikim i thelluar i prokurorisë), për të cilat vendimmarrja ka qenë si më poshtë:
 - KAS në **1 rast** vendosi mospranimin e ankimit pasi mungon legjitimi i ankuesit dhe në 1 rast vendosi rrëzimin e ankimit.
 - Kolegji Zgjedhor Gjyqësor administroi 2 kërkesë padi. në **1 rast** vendosi pushimin e çështjes dhe **1 rast** rrëzimin e padisë.
- c) 2 (dy) kërkesa ankimore, për përmbajtjen e fletës së votimit për të cilat vendimmarrja ka qenë si më poshtë:
 - KAS vendosi pasqyrimin e emrit të kryetarëve të partive udhëheqëse të koalicioneve,
 - Kolegji Zgjedhor vendosi rrëzimin e padisë.
- d) 1 (një) kërkesë ankimore, për caktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të GNV-ve për të cilën vendimmarrja ka qenë si më poshtë:
 - KAS vendosi rrëzimin e ankimit. Subjekti zgjedhor PDIU i lind i drejta për propozimin e anëtarit të katërt të GNV,
 - Kolegji Zgjedhor vendosi rrëzimin duke mbajtur të njëjtin qëndrim të KAS.
- e) 2 (dy) kërkesa ankimore, për shkelje administrative të parashikuar në Kodin Zgjedhor, për mosraportimin e veprimtarive publike
 - KAS në 1 (një) rast vendosi rrëzimin e ankimit dhe në 1 (një) rast mospranimin e ankimit.
- f) 1 (një) kërkesë ankimore, për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të dispozitave ligjore për të cilën vendimmarrja ka qenë si më poshtë:

- KAS vendosi pranimin e ankimit duke vendosur urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për heqjen e menjëhershme të materialeve propagandistike të subjektit zgjedhor.
- g) 1 (një) kërkesë ankimore për heqje të materialeve zgjedhore të vendosura në kundërshtim me ligjin nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” për të cilën vendimmarrja ka qenë si më poshtë:
 - KAS vendosi pranimin pjesërisht të ankimit, duke shfuqizuar shkronjën “f”, pika 1, të pjesës urdhëruese të vendimit 452/2023 të KSHZ.
- h) 2 (dy) ankimore për shpërdorimin e burimeve publike nëpërmjet postimeve të materialeve elektorale në faqet zyrtare të bashkive, për të cilat vendimmarrja ka qenë si më poshtë:
 - KAS në 1 (një) rast vendosi mospranimin e ankimit dhe në 1 (një) rast pushimin e ankimit.
- i) 1 (një) kërkesë ankimore “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 9 maj deri më 10 maj 2023”, për të cilën vendimmarrja ka qenë si më poshtë:
 - KAS vendosi pranimin e ankimit, duke vendosur lejimin e ushtrimit të aktivitetit të zakonshëm politik të partisë "Lëvizja Bashkë" në selinë e saj.
- j) 13 (trembëdhjetë) kërkesa ankimore, ndaj vendimeve të KSHZ për miratimin e rezultateve zgjedhore.

Ndaj vendimeve të KZAZ-ve u depozituan 28 kërkesat ankimore si më poshtë vijon:

- a) 8 (tetë) kërkesa ankimore, me objekt “regjistrimin e subjekteve zgjedhore”, për të cilat vendimmarrja ka qenë si më poshtë:
 - KAS në **3 raste vendosi rrëzimin** e ankimit;
 - **2 raste vendosi mospranim** e ankimit dhe
 - në **3 raste** vendosi pranimin e ankimit si vijon:
 - a. Detyrimin e KZAZ. 71, të pranojë dhe të shqyrtojë kërkesën për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtar të këshillit bashkiak në bashkinë Pustec, të subjektit Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrim European”.
 - b. Detyrimin e KZAZ. Nr 6, të pranojë dhe të shqyrtojë kërkesën për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtar të këshillit bashkiak në bashkinë Vau i Dejes të subjektit Partia “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”.
 - c. Detyrimin e KZAZ nr. 72, **Devoll**, të marrë vendim për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit për Kryetar Bashkie, z. Çlirim Hoxha.
 - Ndaj vendimmarrjeve të KAS për regjistrimin e subjekteve zgjedhore, Kolegji Zgjedhor gjyqësor administroi 3 kërkesë padi, nga të cilët **për 2 raste vendosi rrëzimin e padisë** dhe **1 rast vendosi pranimin e padisë** duke vendosur detyrimin e KZAZ Nr. 82, të

regjistroje si kandidat për kryetar të Bashkisë Dropull z. Kosta Garo, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”.

- b) 1 (një) kërkesë ankimore, për emërimin e anëtarëve të Komisionit të QV-ve.
- c) 19 (nëntëmbëdhjetë) kërkesa ankimore, ndaj vendimeve të KZAZ-ve për miratimin e rezultateve zgjedhore.

Ankimet ndaj rezultatit

Për rezultatin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve janë administruar 32 kërkesa ankimore që lidhen me kundërshtimin e rezultateve të tabelave përmbledhëse të rezultateve për kryetar bashkie dhe këshilla bashkiak, nga të cilat 13 (trembëdhjetë) ndaj vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) ndaj vendimmarrjes së KZAZ-ve.

1. Ndaj vendimmarrjes së Komisionerit janë depozituar 13 ankime si më poshtë vijon:

- a. *Për rezultatet e tabelave përmbledhëse për kryetar bashkie në bashkitë Belsh, Vlorë, Rrogozhinë, Kamëz, Elbasan, Tiranë, Korçë, dhe Lezhë.*
- b. *Për rezultatet e tabelave përmbledhëse për këshill bashkiak në bashkitë Kamëz, Vlorë, Elbasan, Korçë, Lezhë, Delvinë, Tiranë dhe Librazhd.*

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) ka vendosur si vijon:

- për 1 rast vendosi pranimin e ankimit duke vendosur ndryshimin e vendimit nr. 536, datë 20.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë Kamëz, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, sipas tabelës përmbledhëse të miratuar nga KAS;
- për 2 raste vendosi pranimin pjesërisht të ankimeve duke vendosur korrigjimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për bashkinë Belsh dhe bashkinë Rrogozhinë;
- për 4 raste vendosi rrëzimin e ankimit;
- për 4 raste vendosi mospranimin e ankimit dhe
- për 2 raste vendosi pushimin e ankimit.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor administroi 4 kërkesë padi, nga të cilat për **3 raste vendosi rrëzimin** e padisë; për **1 rast vendosi pranimin pjesërisht** të padisë duke vendosur shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023, për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë dhe duke urdhëruar përsëritjen e këtyre zgjedhjeve.

2. Ndaj vendimmarrjes së KZAZ-ve janë depozituar 19 ankime si më poshtë vijon:

- a. *Për rezultatet e tabelave përmbledhëse për kryetar bashkie në bashkitë Kuçovë dhe Krujë.*

b. Për rezultatet e tabelave përmbledhëse për këshill bashkiak në bashkitë Tiranë, Dibër, Pukë, Kamëz, Lezhë, Përmet, Memaliaj, Tropojë, Gjirokastrë, Kurbin, Mallakastër, Krujë

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS):

- për **2 raste vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës ankimore** dhe korrigjimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për këshillin e bashkisë Pukë, sipas gjetjeve të dala nga këqyja e fletëve të votimit;
- **1 rast vendosi pranimin** e ankimit dhe korrigjimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për këshillin bashkiak, KZAZ nr. 62, bashkia Mallakastër;
- **7 raste vendosi rrëzimin** e ankimit;
- **5 raste vendosi mospranimin** e ankimit;
- **4 raste vendosi pushimin** e ankimit.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor administroi 3 kërkesë padi, nga cilat për **2 raste vendosi rrëzimin e padisë; për 1 rast vendosi pranimin pjesërisht të padisë** duke detyruar Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve të bëjë pjesë të shqyrtimit, kërkimet e rrëzuara për shkak të mungesës së kompetencës të kërkesës ankimore nr.74, datë 22.05.2023, të ankuesit Lefter Maliqi, në kuadër të shkaqeve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve.

Çështje në Gjykatën Administrative, Tiranë

Në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, Gjykata Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë është vënë në lëvizje dhe ka marrë në shqyrtim 6 (gjashtë) padi, me objekt vendosjen e masës administrative gjobë për publikime me përmbajtje elektorale në faqen zyrtare “Facebook” të institucionit si dhe shpërdorime publike dhe respektivisht:

- Çështja Ministria e Turizmit dhe Mjedisit kundër KQZ;
- Çështja Ismail Shehu, Sekretar i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Drejtësisë, kundër KQZ;
- Çështja Majlinda Bufi Kryetar për Bashkinë Roskovec, kundër KQZ;
- Çështja Risena Xhaja Sekretar i Përgjithshëm, pranë Ministrisë së Financave, kundër KQZ; - në proces
- Çështja Gazment Turdiu Sekretar i Përgjithshëm, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme kundër KQZ;
- Çështja Dallëndyshe Bici, kundër KQZ;

Aktualisht, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë në 1 (një) rast ka rrëzuar kërkesë padinë për mungesë legjitimitetit/ (*Çështja Ministria e Turizmit dhe Mjedisit/MTM kundër KQZ*), ndërsa në 2 (dy) raste të tjera ka konfirmuar qëndrimin e KQZ, duke rrëzuar kërkesë padinë dhe

duke lënë në fuqi masën administrative të vendosur nga Komisioni i Sanksioneve dhe Ankimeve, përkatësisht për *Çështjen Ismail Shehu kundër KQZ dhe Çështjen Majlinda Bufi kundër KQZ*.

Në vijim, 3 çështjet e tjera janë ende në pritje të shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë përkatësisht *Çështja Risena Xhaja kundër KQZ, Çështja Gazment Turdiu kundër KQZ dhe Çështja Dallëndyshe Bici kundër KQZ*.

Gjithashtu për 2 (dy) nga këto kërkesë padi është investuar Kolegji Gjygjësor Zgjedhor i cili ka shpallur moskompetencën lëndore, duke i dërguar këtë çështje, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë përkatësisht për, *Çështjen Majlinda Bufi kundër KQZ dhe për Çështjen Dallëndyshe Bici kundër KQZ*.

Ekzekutimi i vendimeve

Në përfundim të shqyrtimit administrativ të denoncimeve që lidhen me raportimin ose jo të veprimtarive publike dhe zhvillimin e veprimtarive publike të ndaluara, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve sipas rasteve ka marrë vendime për pushimin e procedimit administrativ ose i është drejtuar Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve me kërkesë për vendosje sanksioni ndaj personave përgjegjës. Në vijim Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ka shqyrtuar denoncimet dhe është shprehur me vendimmarrje.

Bazuar në nenin 176, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, gjoba e vendosur nga KQZ -ja, përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet sipas procedurave të parashikuara në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile. Për këtë arsye, Drejtoria e Ligjshmërisë, Sektori i Hartimit të Akteve, pasi kanë përfunduar afatet e ankimit lidhur me vendimmarrjet, sipas legjislacionit në fuqi, i është drejtuar me kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, secilit prej personave përgjegjës që janë sanksionuar nga vendimet e KQZ, duke i lënë një afat kohor brenda 15 (pesëmbëdhjetë ditëve) nga e nesërmja e marrjes së njoftimit. Në rastet e mos përmbushjes së detyrimit vullnetar brenda afatit të caktuar, KQZ vijon me procedurën sipas nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, duke ju drejtuar Gjykatës Administrative Tiranë, për të lëshuar urdhrin e ekzekutimit dhe vijuar më tej me ekzekutimin e detyrueshëm nëpërmjet Shërbimit Përmbarimor Shtetëror.

Për sa më sipër, në kuadër të zgjedhjeve të qeverisjes vendore datë 14 Maj, 2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur sanksion administrativ ndaj 57 (*pesëdhjetë e shtatë*) subjekteve, nga të cilët 28 (*njëzetë e tetë*) subjekte kanë ekzekutuar vullnetarisht detyrimin.

Kreu IV: Shpallja e Rezultatit

Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbi bazën e rezultatit të votimit të vlefshme për çdo zonë zgjedhore, në mbështetje të nenit 162, 163, 166 të Kodit Zgjedhor, përlllogaritë shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme si dhe kandidatët fitues për kryetarët e bashkive dhe këshillat bashkiak për çdo zonë zgjedhore.

Komisioni Rregullator, pas shpalljes së rezultatit për shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 20, pika 2, shkronja “d” dhe nenit 167 të Kodit Zgjedhor, me vendimin nr. 27, datë 7.8.2023 “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, shpalli si më poshtë:

- a) Rezultatit e votimit për kandidatët për kryetar bashkie të cilët janë zgjedhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë në zonën zgjedhore përkatëse;
- b) Numrin e votave të fituara nga secili subjekt në shkallë kombëtare, bazuar në rezultatit e votave të fituara nga çdo subjekt zgjedhor në votimin për këshillat e qeverisjes vendore.

Kreu V: Verifikimi paszgjedhor

Kodi Zgjedhor autorizon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të realizojë procesin e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

Këqyrja e mëpasshme e fletëve të votimit dhe e materialit zgjedhor bëhet për të verifikuar rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit e numërimit të votave.

Bazuar në vendimin nr. 800, datë 20.10.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e organeve të vetëqeverisjes vendore”, administrata e KQZ-së zhvilloi procesin e këqyrjes paszgjedhore nga datat 06.11.2023 deri më datë 26.11.2023.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 167/2, këqyrjes iu nënshtruan 10% të qendrave të votimit. Nga totali prej 5213 qendra votimi, numri i qendrave të votimit që do të hapen për verifikim është 526 QV. Përzgjedhja e qendrave të votimit ishte rastësore dhe u bë me short. Më 23 tetor 2023, u hodh short ndërmjet 5208 qendrave të votimit nga 5213 në total dhe në përfundim të tij, u përzgjedhën 526 qendra votimit⁵, sipas lidhjes 1 të këtij raporti, që përfaqësojnë 10% të qendrave të votimit për çdo KZAZ.

⁵ Vendimi nr, 813, datë 23.10.2023 “Për miratimin e rezultatit të shortit për përzgjedhjen e Qendrave të Votimit që do t’i nënshtrohen procesit të këqyrjes paszgjedhore, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”

Në listën e QV-ve për të cilat u hodh short nuk u përfshinë ato të këqyrura nga KAS gjatë procesit ankimor për të dyja organet (5 QV në total), ndërsa QV të cilat u këqyrën për njërin prej organeve u përfshinë në short për t'ju nënshtruar verifikimit për organin e paankimuar/ pakëqyrur më parë.


Nga 526 QV-të e përzgjedhura 8 QV ishin këqyrur pjesërisht nga KAS (Kutia e Materialeve Zgjedhore 1 QV, Kutia e votimit për kryetar 7 QV), ndërsa numri i QV-ve në Zonat e Administrimit të Zgjedhjeve ku është implementuar PEVN (pajisja elektronike e votimit dhe numërimit) të përzgjedhura nga shorti ishte 40.

Për këqyrjen e fletëve të votimit dhe materialeve të votimit për këto 526 QV u ngritën 8 grupe për këqyrje të cilët vlerësuan dhe plotësuan procesverbalet përkatëse për administrimin e informacionit.

Ky proces përfundoi më datë 26.11.2023. Të dhënat e pasqyruara në procesverbalet përkatëse të këqyrjes u përpunuan dhe u analizuan. Në kuadër të procesit të analizës së gjetjeve, administrata u bëri me dije shkeljet e konstatuara personave, pjesë e administratës zgjedhore, të evidentuar me problematika dhe u kërkoi shpjegime. Në përfundim u ballafaquan të dhënat nga gjetjet e këqyrjes me shpjegimet e dhëna nga personat e identifikuar me shkelje, dhe u përgatit ky raport përmbledhës mbi respektimin nga ana e komisioneve të qendrave të votimit të kërkesave procedurale gjatë procesit të votimit si dhe të saktësisë së veprimeve të grupeve të numërimit të votave përgjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave.

Administrimi i dokumentacionit zgjedhor

Në përgjithësi nga QV-të e këqyrura rezulton se administrata zgjedhore ka përmbushur detyrat e saj në nivelin mesatar 88% nga totali i kërkesave themelore ligjore dhe nënligjore, duke vepruar në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe të akteve nënligjorë dalë në zbatim të tij. Ky tregues shënoi një rritje prej 9% nga rezultati i këqyrjes paszgjedhore të zgjedhjeve për Kuvend të vitit 2021.



- **Procesverbalet dhe raportet e hapjes dhe mbylljes së votimit**

Në 95% të qendrave të votimit të këqyrura ka rezultuar se nga ana e komisioneve janë administruar procesverbalet e hapjes dhe të mbylljes të procesit të votimit në përputhje me procedurat e përcaktuara ligjore, nga 91% që ishte raporti i zbatimit të kësaj kërkesë në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2021.

Problematikat e vërejtura më së shumti kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë e zbatimit të kërkesave procedurale për procesin e administrimit të materialeve/dokumentacionit të punës së KQV-së. Vihet re se vijon problematika e hasur në vitin 2021, ndonëse në një shkallë më të ulët, që lidhet me mosregjistrimin e vendimmarrjeve të KQV-ve si në procesverbalet tip të miratuar nga KQZ, njëkohësisht edhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve (LPM). 11% e QV-ve nuk kanë evidentuar në LPM hapjen e votimit dhe 26 % e KQV-ve nuk kanë evidentuar në LPM mbylljen së votimit.

Procesi i dorëzimit të fletëve të votimit nga KZAZ në KQV dhe pasqyrimi i tyre si në procesverbale edhe në Librin e Protokollit të Mbledhjes nuk ka ndjekur të njëjtin rrjedhë sipas procedurave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, respektivisht në kërkesat e neneve 101 dhe 113 të Kodit Zgjedhor.

Vendimi nr. 11/2021 i Komisionit Rregullator, i ndryshuar, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit”, përcakton se raporti i hapjes dhe ai i mbylljes i gjeneruar nga pajisja PEI nënshkruhet nga anëtarët e KQV-së dhe futet në kutinë e materialeve të votimit (materialet zgjedhore).

Administrimi i raporteve të PEI është bërë në mënyrë jo konsistente nga të gjithë KQV-të / operatorët dhe konkretisht në:

- 16% të qendrave të këqyrura nuk janë administruar raportet e hapjes së votimit,
- 22% të qendrave të këqyrura nuk janë administruar raportet e mbylljes së votimit.

- Lista e zgjedhësve

Lista e zgjedhësve është përdorur në 70% të rasteve në krahasim me 57 % të rasteve të evidentuara në zgjedhjet e vitit 2021. Në 29% të qendrave të votimit të këqyrura, nga ana e komisioneve të qendrave të votimit nuk është respektuar kërkesa për të vendosur vizën mbi emrin e zgjedhësit.

A: Të dhëna për vendimmarrjet e KQV-ve dhe pasqyrimi i tyre në dokumentacionin e punës

Të dhënat e përpunuara nga procesverbali që administrojnë pyetjet për këtë tregues evidentojnë si më poshtë:

1. Për hapjen e procesit të votimit rezultojnë se:
 - 80% e QV kanë marrë vendim për hapjen e QV në orën 07:00.
 - 5% e QV kanë marrë vendim për hapjen e votimit në deri orën 08:00.
 - 2% e QV-ve kanë marrë vendim për hapjen e votimit deri në orën 10:00.
 - 13% e QV-ve nuk kanë evidentuar me vendimmarrje orarin e hapjes së votimit.
2. Për mbylljen e procesit të votimit rezultojnë se:
 - 69% e QV-ve kanë marrë vendim për mbylljen e votimit në orën 19:00.
 - 4% e QV-ve kanë marrë vendim për mbylljen e votimit deri në orën 19:30.
 - 27% e QV-ve nuk kanë evidentuar me vendimmarrje orarin e mbylljes së votimit.
3. 72% e vendimeve të QV-ve janë të vullosura me vulën e KQV-së.
4. Në 8% të QV-ve janë evidentuar vendimmarrje për pezullimin e procedurës së votimit për arsye të ndryshme.
5. Në 12% të QV-ve janë evidentuar problematika lidhur me funksionimin/mungesën e operatorëve/ mosfunksionimin e PEI.
6. Në 12 QV është konstatuar se procedura ka kaluar manualisht me listën e zgjedhësve për shkak të mungesës së operatorit PEI.
7. Në 11 % të QV-ve ka filluar procedura e votimit manualisht dhe më pas ka kaluar me përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit/ anasjelltas.
8. Në 1% të rasteve është kërkuar ndërhyrja e policisë në QV.
9. Në 1 QV vëzhguesit kanë paraqitur vërejtje.

Nenet 41 dhe 42 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë detyrat e Sekretarit të KQV-së dhe vendimmarrjet e komisionit të qendrës së votimit, ndërsa nenet 101 – 114 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë detyrat dhe rregullat për procesin e votimit ditën e zgjedhjeve.

Në përfundim të këqyrjes rezultoi se 47 QV nuk kishin administruar apo nuk kishin plotësuar Librin e Protokollit të Mbledhjeve (LPM).

U konstatua se në 8 QV, në krahasim me 21 që ishte ky raport në zgjedhjet e vitit 2021, mungon ky dokument (LPM) në kutinë e materialeve zgjedhore veprime që bëjnë me përgjegjësi të drejtpërdrejtë sekretarin e KQV-së.

Neni 31 i Kodit Zgjedhor përcakton detyrimin e sekretarit të KQV-së për pasqyrimin e vendimmarrjes së KQV-së në Librin e Protokollit të Mbledhjeve. Neni 41 i Kodit Zgjedhor ngarkon me përgjegjësi Sekretarin e KQV-së për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KQV-së, i cili protokollon ankesat, kërkesat, dhe njoftimet drejtuar KQV-ve, regjistron në LPM vendimet e KQV-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara, regjistron në protokoll marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore, përgjigjet për vendosjen e materialeve zgjedhore në kutinë e materialeve të votimit dhe vulosjen e saj me kode sigurie.

Për 47 rastet e evidentuara me mosplotësim të Librit të Protokollit të Mbledhjeve dhe të mungesës së tyre, administrata e KQZ-së në përputhje me rekomandimin e KAS në vendimin nr. 1/2022 si dhe me nenin 42 dhe 87 të Kodit të Procedurave Administrative, u ka kërkuar shpjegime sekretarëve lidhur me gjetjet e evidentuara nga grupet e këqyrjes a posteriori.

Nenet 41, 101/1/e dhe 113/5, përcaktojnë rregullin për administrimin e procesverbaleve, librit të protokollit të mbledhjeve të KQV-së. Sipas këtij rregulli vendoset dhe mbyllet në kutinë e materialeve zgjedhore së bashku me origjinalet e vendimeve të KQV-së (të inkorporuara në LPM).

Gjatë komunikimit me sekretarët e KQV-ve u evidentua se:

- emërimet e sekretarëve të QV-vë në pjesën më të madhe të këtyre QV-ve janë emëruar një ditë para ditës së zgjedhjeve duke mos ju dhënë mundësi trajnimi.
- në disa raste sekretarët e emëruar ishin me arsim 8 vjecar apo mbi moshën 65 vjeç;


Gjatë sqarimeve të dhëna nga sekretarët e qendrave të votimit rezultoi se LPM:

- janë vendosur në kutinë e votimit të cilat janë hapur gjatë procesit të numërimit të votave ose u janë dorëzuar dorazi KZAZ-së, ose
- ky material zgjedhor është dëmtuar/ në mungesë, ose
- është dorëzuar në KZAZ dorazi (për të cilën kjo e fundit nuk kishte evidentuar këtë fakt në Procesverbalin e konstatimit).

Nga hetimi i zhvilluar, deduktohet se mund të jemi përpara një gabimi njerëzor për shkak se nuk janë shfaqur të dhëna që synojnë të fshehin shkelje apo që çënojnë standardin e zgjedhjeve në këto qendra votimi.

Nga tërësia e treguesve të performancës së KQV-ve për këtë kategori vendimmarrje, komisionet e qendrave të votimit në këto 526 të këqyruara kanë vepruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në nivelin mesatar 93% të tyre nga 86% që ishte ky nivel në zgjedhjet e vitit 2021.


Rezulton që procesverbalet nuk janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KQV-së të emëruar, referuar listpagesave/ informacioneve të dërguara nga KZAZ-të.



U konstatua se në 8 QV nuk është administruar Libri i Protokollit të Mbledhjeve.

Në kutinë e materialeve zgjedhore rezultojnë që janë administruar përgjithësisht dokumentet e mëposhtëm nga ana e KQV-së:

ADMINISTRIMI I BMZ- PERGJIGJUR "Po"



Në mesatarisht 93% të QV-ve baza materiale dhe dokumentacioni zgjedhor është administruar në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe vendimit 11/2021 të KQZ-së.

2. Verifikimi i procesit të numërimit të votave

KQZ në përputhje me përcaktimet e nenit 167/2 të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit 800/2023 “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore”, kreu këqyrjen e saktësisë së vlerësimit dhe numërimit të votave.

Grupet e këqyrjes vlerësuan dhe numëruan votat për subjektet dhe për kandidatët e listave shumëmemërore të subjekteve zgjedhore.

Devijimi në vota	# QV për Këshill	# QV për Kryetar	# QV Total	Në % nga Totali i këqyrur
0-9	108		108	21.5%
10-19	12		12	2.3%
20-29	6		6	1%
30-39	2	1	3	0.5%

40-49	1		1	0.2%
50-60	1		1	0.2%
QV Total	130	1	131	25.7 %

Nga këqyrja paszgjedhore në përfundim të procesit të numërimit të votave për subjektet zgjedhore, rezultuan se:


- 20% e QV-vë të këqyrura (100 QV nga 526 QV të kqyrura) rezultuan me diferencë nga 1-5 vota;
- 1.5% e QV-ve të këqyrura (8 QV nga 526 QV të kqyrura) rezultuan me diferencë nga 6-9 vota;
- 2.3% e QV-ve të këqyrura (12 QV nga 526 QV të kqyrura) rezultuan me diferencë nga 10-19 vota;
- 1.5% e QV-ve të këqyrura (9 QV nga 526 QV të kqyrura) rezultuan me diferencë nga 20-39 vota;
- 0.4% e QV-ve të këqyrura (2 QV nga 526 QV të kqyrura) rezultuan me diferencë nga 40-60 vota.

Ndërsa saktësia e numërimit për kandidatë për kryetar bashkie ishte më e lartë ku është evidentuar vetëm një QV me devijim standard/ relativ.

Viti 2023 – 74.3% e QV pa devijime; 25.7% e QV me devijime

Viti 2021: 5% e QV-ve pa devijime, 95% e QV-ve me devijime

SAKTËSIA E NUMËRIMIT TË VOTAVE NGA GNV KRAHASIM 2021 VS 2023




3: Votat e pavlefshme dhe natyra e pavlefshmërisë

Nga administrimi i të dhënave të grupeve të këqyrjes për votat e pavlefshme rezultoi se natyra e votave të pavlefshme në përqindje janë sipas këtyre kategorive:

1.	Në fletën e votimit mungojnë vultat e kryetarit apo sekretarit të KQV	3.4%
2.	Në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës	18.5%
3.	Është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit	46%
4.	Në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuar zgjedhore	5.4%
5.	Nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit	20.2%
6.	Është votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit	3%

7.	Nuk është e qartë se për kë është votuar	3.5%
----	--	------

Të pasqyruar në mënyrë grafike :



III: Pilotimi i Pajisjes Elektronike të Votimit dhe Numërimit

Pajisja elektronike e Votimit dhe e numërimit u implementua në zgjedhjet e datës 14 maj 2023 në 7 KZAZ-të e bashkive Elbasan (4 KZAZ), Kamëz (2 KZAZ) dhe Vorë (1 KZAZ). Në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 167/2 pika 3 e Kodit Zgjedhor për këto ZAZ u përzgjedhën në mënyrë rastësore 40 qendra votimi Bashkia Elbasan 23 QV, Bashkia Kamëz 113 QV dhe Bashkia Vorë 4 QV, që përfaqësonin kampionaturën prej 10%.

Në përfundim të procesit u konstatua se në të gjitha QV-të rezultati i tabuluar nga sistemi ishte i njëjtë me fletët e votimit të gjetura në kutinë e fletëve të printuara nga sistemi.

Pjesa III: ZGJEDHJET E PJESËSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS TË DATËS 24 SHTATOR 2023

Kreu I: Përgatitja e zgjedhjeve

Seksioni 1: Aktet rregullatore

Në funksion të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar **53** (pesëdhjetë e tre) vendime, si vijon:

- 29 (njëzet e nëntë) akte në funksion të organizimit të zgjedhjeve dhe punës së administratës zgjedhore;
- 1 (një) vendim për miratimin e strukturës buxhetore, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023;
- 13 (trembëdhjetë) vendime për akreditimin e vëzhguesve;
- 6 (gjashtë) vendime për regjistrimin e subjekteve zgjedhore;
- 3 (tre) vendime për shqyrtimin administrativ të denoncimeve;
- 1 (një) vendim për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kukës.

Komisioni Rregullator, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023, ka miratuar 6 (gjashtë) vendime, si vijon:

- 1 (një) vendim për miratimin e afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Kukës;
- 1 (një) vendim për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023;
- 1 (një) vendim për miratimin e orarit të votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës;
- 2 (dy) vendime për përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve dhe kamerave në QV;
- 1 (një) vendim për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023.

Seksioni 2: Planifikimi buxhetor i programit të zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me fondet e vëna në dispozicion brenda strukturës së miratuar të shpenzimeve për zgjedhjet e 14 majit, (me fonde të pa shpenzuara), arriti të mbulojë të gjitha shpenzimet e nevojshme për kryerjen e zgjedhjeve për Kryetar Bashkie në Kukës, pa kërkuar fonde të tjera shtesë. Fondet për zgjedhjet për Bashkinë Kukës u përlllogaritën në vlerën 25,5 milion lekë.

Seksioni 3: Edukimi dhe Informimi i Zgjedhësve

Programi për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet vendore të Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023, kishte për qëllim të informonte dhe ndërgjegjësoje zgjedhësit mbi aspektet kryesore të procesit zgjedhor. Në mënyrë specifike programi ka si qëllim të informojë dhe edukojë zgjedhësit për datën e zgjedhjeve në lidhje me procesin e verifikimit të emrit në listën e zgjedhësve, si dhe qendrën e votimit ku zgjedhësi voton, të informojë dhe edukojë zgjedhësit mbi procedurën e votimit dhe identifikimit elektronik, të informojë dhe edukojë zgjedhësit mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit, ndërgjegjësimin dhe edukimin e grupeve vulnerabël dhe të rinjve votues për herë të parë për pjesëmarrje në zgjedhje, ndërgjegjësimi dhe edukimi i pakicave kombëtare, informimi i zgjedhësve mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor dhe parandalimi i tyre.

Objektivat:

1. Informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi i zgjedhësve për listën e zgjedhësve

Ky objektivi ka për qëllim të informojë zgjedhësit mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e tyre të votimit, nëse kanë pasaktësi se ku duhet të drejtohen si dhe mjetet e ndryshme të komunikimit ku ata mund të gjejnë gjithë informacionin mbi procesin zgjedhor.

Mjetet e komunikimit që janë përdorur:

Media sociale (Është shpërdarë informacioni nëpërmjet spoteve, banera dhe mesazheve të ndryshme mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit).

Takim me zgjedhësit (Janë zhvilluar takime me votues për herë të parë, gratë dhe grupe të ndryshme vulnerabël të cilët ku u informuan se ku mund të gjejnë emrin e tyre në listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit.)

Aplikacioni “KQZ” (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendej qendra e votimit nga çdo zgjedhës nëpërmjet rubrikës “Ku votoj”)

Web KQZ (në website e KQZ është publikuar i gjithë informacioni mbi listën e zgjedhësve dhe nëpërmjet web-it mund të gjendet qendra e votimit nga çdo zgjedhës.)

2. Ndërgjegjësimin e zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore për rëndësinë e procesit zgjedhor, zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara.

Ky objektivi ka për qëllim informimin e zgjedhësve dhe subjektet zgjedhore mbi veprat penale dhe shkeljet që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, si dhe parandalimi i tyre.

Mjetet e komunikimit që janë përdorur :

Media sociale (Është shpërdarë informacioni nëpërmjet spoteve, banera dhe mesazheve mbi parandalimin e veprave penale përgjatë procesit zgjedhor si dhe parandalimi i tyre.)

Takim me zgjedhësit (Janë zhvilluar takime me votues për herë të parë, gratë dhe grupeve të ndryshme vulnerabël të cilët ku u informuan mbi veprat penale dhe si t'i parandalojnë.)

Aplikacioni “KQZ” (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendej sesioni denonco shkeljet zgjedhore ku cilido mund të denoncoj shkeljet e ndryshme.)

Web KQZ (në website e KQZ është publikuar i gjithë informacioni mbi veprat penale.)

Spote televizive (Është transmetuar spoti mbi veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor në televizionet lokale që mbulojnë Bashkinë Kukës.)

Postera në çdo Qendër Votimi (Janë vendosur postera informues në të gjitha qendrat e votimit në Bashkinë Kukës mbi veprat penale në zgjedhje.)

3. Sensibilizimi i grupeve vulnerabël, të rinjve, kryesisht votues për herë të parë, gratë, ku qëllimi është rritja e pjesëmarrjes së tyre.

Ky objektiv ka në fokus sensibilizimin e zgjedhëseve gra dhe të rinjtë, për të shmangur fenomenin e votimit familjar, për të votuar të lira dhe të pandikuara, rritja e pjesëmarrjes së votuesve për herë të parë si dhe përfshirja e tyre në proceset e ndryshme zgjedhore.)

Mjetet e komunikimit që janë përdorur :

Media sociale (Është shpërdarë informacioni nëpërmjet spoteve, banera dhe mesazheve të ndryshme nga të rinjtë dhe gratë për pjesëmarrje në zgjedhje.)

Takim me zgjedhësit (Janë zhvilluar takime me votues për herë të parë, gratë dhe grupeve të ndryshme vulnerabël ku u informuan mbi të gjitha hapat e procesit zgjedhor.)

Aplikacioni “KQZ” (Janë informuar që nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet qendra e votimit nga çdo zgjedhës, mund të denoncojnë çdo parregullsi që mund të shohin përgjatë procesit zgjedhor apo edhe ditën e zgjedhjeve.)

Web KQZ (Në website e KQZ është publikuar i gjithë informacioni mbi procesin zgjedhor në rubrikën “Edukimi i Zgjedhësve”.)

4. Informimi i administratës publike për ndalimet dhe kriteret ligjore për zgjedhjet.

Ky objektiv ka për qëllimi kryesor sensibilizimin e punonjësve të administratës vendore gjatë periudhës zgjedhore, mbi shkeljet ligjore dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, parandalimi i tyre, si dhe raportimi i cdo rasti në portalin e dedikuar për monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve shtetërore.

Mjetet e komunikimit që janë përdorur :

Media sociale (Është shpërdarë informacioni nëpërmjet spoteve, banera dhe thirjeve për parandalimin e burimeve shtetërore përgjatë fushatës zgjedhore nga administrata vendore si dhe parandalimi i pjesmarrjes në fushatën zgjedhore i punonjësve shtetëror përgjatë orarit zyrtar.)

Aplikacioni “KQZ” (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet sesioni denonco shkeljet zgjedhore)

Web KQZ (në website e KQZ është publikuar i gjithë informacioni mbi shkeljet dhe parandalimi i veprave penale.)

5. Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit, përmbajtja e fletës së votimit dhe shënimin korrekt të saj.

Qëllimi i këtij objekti është që zgjedhësit të jenë të përgatitur ditën e votimit për hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit në mënyrë që vota të jetë e vlefshme.

Mjetet e komunikimit që janë përdorur :

Media sociale (Është shpërdarë informacioni nëpërmjet spoteve, banera dhe mesazheve mbi hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit ditën e zgjedhjeve si dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.)

Takim me zgjedhësit (Janë zhvilluar takime me votues për herë të parë, gratë dhe grupe të ndryshme vulnerabel të cilët do të informohen mbi hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit ditën e zgjedhjeve si dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit)

Aplikacioni “KQZ” (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendej sesioni “si mund të votoj” i cili shpjegon me video të gjitha hapat duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.)

Web KQZ (Në website e KQZ është publikuar i gjithë informacioni në rubrikën “Edukimi i Zgjedhësve” mbi hapat duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.)

Spote televizive (Është transmetuar spot në televizionet lokale që mbulojnë bashkinë Kukës mbi hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.)

Postera në çdo QV (Do të vendosen postera informues në të gjitha qendrat e votimit në Bashkinë Kukës mbi hapat duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit ditën e zgjedhjeve dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.)

Seksioni 4: Vëzhgimi i Zgjedhjeve

Për zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e Bashkisë Kukës, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi vendimin nr.702, datë 12.07.2023 “Për akreditimin e vëzhguesve jopolitikë nëpërmjet platformës elektronike të vëzhguesve, në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetarin e Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023.”

Përmes platformës online për këto zgjedhje u akredituan gjithsej 87 vëzhgues vendas që përfaqësonin 6 organizata të shoqërisë civile dhe 9 media vendase. Të klasifikuar sipas mandatit të tyre u akredituan 13 vëzhgues afatgjatë dhe 12 vëzhgues afatshkurtër si dhe 62 përfaqësues të Mediave.

Seksioni 5: Raportimi i institucioneve publike dhe denoncime

Për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, ka pasur vetëm 1 raportim me shkresë për zhvillim veprimtarie publike.

Për sa i përket denoncimeve, ka patur 1 (një) denoncim nga organizata “Qëndresa Qytetare”, lidhur me aktivitetin koncert të planifikuar në Bashkinë Kukës, më datë 20.09.2023. Gjatë hetimit administrativ u provua që ky koncert nuk organizohej nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe kandidati i saj, z. Albert Halilaj, për rrjedhojë me vendim të KSHZ u vendos pushimi i procedimit administrative. KAS vendosi mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore të paraqitur nga Organizata Qendra “Qëndresa Qytetare”, për shkak të mosrespektimit të afatit të ankimit.

Seksioni 6: Komisionet Zgjedhore

Për zgjedhjet e datës 24 shtator 2023, Komisioneri me vendimin nr. 722, datë 19.8.2023, të ndryshuar dhe me vendimin nr. 775 datë 15.9.2023, caktoi partitë të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarë për KZAZ Nr. 11, Bashkia Kukës.

Konstituimi i KZAZ-se nr. 11, Bashkia Kukës, u krye brenda afateve kohore ndërkohë që kuota gjinore në përbërjen e KZAZ-së nuk respektoi standardin që dikton Kodi Zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvend apo për organet e vetëqeverisjes vendore.

KZAZ Nr. 11 administroi kërkesat e subjekteve politike për propozimin e anëtarëve për KQV për 518 komisionere për 74 qendrat e votimit në juridiksionin e kësaj KZAZ-je si dhe për grupet e numërimit të votave.

KQZ nëpërmjet administratës së saj trajnoi administratën zgjedhore të kësaj KZAZ-je si dhe mbikëqyri nga afër procesin e administrimit të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023.

Seksioni 7: Regjistrimi i subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të Kodit Zgjedhor, pas shqyrtimit administrativ dhe dokumentacionit përkatës ka vendosur si vijon:

- Të regjistrojë si subjekte zgjedhore 5 parti politike;
- Të regjistrojë 1 koalicion zgjedhor;

Për zgjedhjet e pjesshme të datës 24 shtator 2023 janë regjistruar dhe verifikuar 2 kandidatë për kryetar bashkie.

Seksioni 8: Infrastruktura dhe logjistika zgjedhore

Seksioni 9: Fushata zgjedhore

Pas daljes së dekretit të Presidentit të Republikës, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori vendimin nr. 736, datë 25.08.2023, “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023” dhe u shpall njoftim për të aplikuar për monitorues për zgjedhjet e pjesshme në këtë bashki. Duke qenë se pati vetëm 1 aplikim, u mor vendimi me nr. 737, datë 25.08.2023, “Për përzgjedhjen e monitoruesit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”. Monitoruesi dorëzoi 3 (tre) raporte monitorimit për secilin subjekt zgjedhor të monitoruar.

Për këto zgjedhje KSHZ mori vendimin nr. 768, datë 11.09.2023, “Për caktimin e kohës së transmetimit në radio- televizionin publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”. Gjatë kësaj periudhe sektori i MFMF administroi raportet e Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA), në lidhje me tarifat dhe kohën e minutazhit të vënë në dispozicion të subjekteve zgjedhore nga mediat në vend. Në total u dorëzuan 2 (dy) raporte periodike duke filluar nga data 11.09.2023.

Kreu II: Dita e Zgjedhjeve

Me 24 shtator 2023 të gjitha qendrat e votimit u hapën me kuorum të plotë në orën 07:00. Procesi u mirë administrua nga KZAZ-ja nr. 11 dhe përgjatë ditës se votimeve nuk pati asnjë shqetësim, apo situatë që mund të cënonte standardin e zgjedhjeve. Administrata e KQZ-së monitoroi në terren gjithë dinamikën e procesit në qendrat e votimit dhe adresoi shqetësimet e pakta të subjekteve për prezencë të personave të paautorizuar në ambientet e jashtme të qendrave të votimit.

Në zgjedhjet e datës 23 shtator 2023 u pilotua nga KQZ-ja edhe moduli i raportimit të anëtarëve të qendrave të votimit, i cili diktonte dërgimin në kohë reale të informacionit për të gjitha fazat e procesit, përfshirë edhe raportimin e shqetësimeve apo problematikave.

Kreu III: Shpallja e Rezultatit

KZAZ Nr. 11 dhe grupet e numërimit administrojnë brenda afatit ligjor bazën materiale të votimit. KZAZ administroi procesin e vlerësimit dhe numërimit të votave pa ndërprerje duke e përmbyllur këtë proces brenda 12 orëve.

Kreu IV: Ankimimet Zgjedhore

Në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023 janë depozituar 2 (dy) kërkesa ankimore, si më poshtë vijon:

1. **Kërkesa Ankimore nr. 93** (*Partia Demokratike e Shqipërisë*) ndaj vendimit nr. 722, datë 19.08.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 1, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.
 - Ndaj këtij vendimi është bërë ankim në KAS, ku u vendos rrëzimi i kërkesës ankimore të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë” për shkak se nuk plotësoheshin elementet e legjitimitetit të ankimuesit.
 - Ndaj vendimit të KAS është bërë ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, i cili vendosi pranimin e padisë dhe detyrimin e KAS të marrë vendimin përfundimtar lidhur me kërkesën ankimore nr. 93.
 - Në zbatim të vendimit nr. 34, datë 01.09.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, KAS më datë 07.09.2023 zhvilloi seancën e rishqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 93, ku në përfundim me shumicë votash vendosi rrëzimin e saj.
 - Ndaj vendimit të KAS është bërë ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor. Pas shqyrtimit në themel të çështjes, **Kolegji Zgjedhor** vendosi shfuqizimin e vendimit nr. 181, datë 07.09.2023, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 722, datë 19.08.2023, në shkronjën “b” dhe “c” të pikës 1 të tij, si më poshtë:
 - b) dy anëtarë propozohen nga “Partia Demokratike e Shqipërisë” (PDSH);
 - c) një anëtar propozohet nga “Partia e Lirisë” (PL).
2. **Kërkesa Ankimore nr. 94** (*Partia Demokratike, me kryetar Sali Berisha*) ndaj vendimit nr. 745, datë 04.09.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës së “Partisë Demokratike”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023”, ku kërkohet ndryshimi i vendimit duke vendosur, regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga Kryetari Sali Berisha, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023.

- Ndaj këtij vendimi është bërë ankim në KAS, në përfundim të cilës me shumicë votash KAS vendosi rrëzimin e kërkesës dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 745, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Kreu V: Verifikimi paszgjedhor

Këqyrja paszgjedhore për 7 QV-të e kësaj bashkie dëshmoi se KQV kishin mirë administruar dokumentacionin dhe materialet e punës. Natyra e pavlefshmërisë së votave ishte e dy natyrave:

- 53% për votimin e më shumë se një subjekti në fletën e votimit,
- 47% nuk ishte votuar për asnjërën nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit,

Pjesa IV: VEPRIMTARI TË TJERA

Kreu 1: Financimi për vitin kalendarik

a. Raportimi financiar për aktivitetin e vitit kalendarik 2022

Në zbatim të nenit 23, pika 1, të ligjit “Për partitë politike”, partitë politike kanë detyrimin të dorëzojnë raportet financiare 1 (një) herë në vit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky raport duhet të dorëzohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në fillim të vitit kalendarik 2023, ju drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të kërkuar informacion të përditësuar për partitë politike të regjistruara. Në përgjigje të kësaj kërkesë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, informoi se janë 131 partitë politike të regjistruara pranë saj. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i dërgoi njoftim zyrtar të gjitha partive politike për detyrimin që kanë për të dorëzuar raportet financiare vjetore në KQZ. Nga 131 parti politike të cilave ju dërgua njoftimi, 37 parti politike e morën njoftimin ndërkohë që për 94 parti politike njoftimi nuk u bë i mundur për shkak të adresës së pasaktë.

Partitë politike të cilat dorëzuan raportet vjetore financiare për vitin 2022, brenda datës 31 mars 2023, janë 48. Ndërkohë 83 partitë e tjera politike nuk e dorëzuan raportin vjetor financiar për vitin 2022.

b. Fondet e shpërndara si ndihmë financiare për partitë politike për vitin 2023

Për vitin 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shpërndau me vendimin me nr. 309, datë 12.4.2023, i ndryshuar me vendimin me nr. 422, datë 2.5.2023, si ndihmë financiare vjetore për partitë politike fondin në vlerën 345.600.000 lekë.

Partitë politike të cilat përfituan fonde si ndihmë financiare për vitin 2023, janë si më poshtë vijon:

Nr.	Partia politike	Fondi që përfitohet (lekë)
1	Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)	151.494.783
2	Partia Demokratike (PD)	106.661.182
3	Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU)	9.753.658
4	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ)	8.018.647
5	Partia Republikane Shqiptare (PR)	11.488.669
6	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë (PAA)	8.018.647
7	Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (LZHK)	8.018.647
8	Partia Lëvizja e Legalitetit (PLL)	8.018.647
9	Partia e Lirisë (PL)	15.577.215
10	Partia Social Demokrate (PSD)	12.266.269
11	Partia Nisma Thurje (NTH)	6.283.636
TOTALI		345.600.000

c. Auditimi i pasqyrave financiare të partive politike për vitin kalendarik 2022

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 544, datë 22.5.2023, “Për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2022”, caktoi 9 ekspertë kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e 132 partive politike të regjistruara në regjistrin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga raportet e dorëzuara nga audituesit ligjorë për 84 parti politike nuk është kryer auditimi për shkak të adresave të pasakta, apo pasi partitë edhe pse kanë marrë njoftimin për fillimin e procesit të auditimit nuk janë vënë në kontakt me audituesit ligjorë. Për 4 parti politike nuk është kryer auditimi pasi kanë status pasiv në kuptim të legjislacionit tatimor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas verifikimeve të kryera nga raportet e dorëzuara nga vetë partitë politike si dhe nga raportet e

dorëzuara nga audituesit ligjorë është në proces për marrjen e masave administrative për partitë politike.

Kreu 2: Votimi nga jashtë vendit

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 38, datë 09.12.2022, i cili hyri në fuqi në datën 09.01.2023, konstatoi cënimin e të drejtës kushtetuese të votës së emigrantëve në zgjedhjet për Kuvendin për shkak të boshllëkut ligjor, si dhe vendosi detyrimin e Kuvendit për plotësimin e boshllëkut ligjor brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Nga momenti i shpalljes së këtij vendimi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk mund të ndërmerre më hapa për anën rregullatore të këtij procesi pa u shprehur Kuvendi në lidhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ndër mangësitë e Kodit Zgjedhor të shpjeguara në këtë vendim mund të përmendim:

- Dhënien e autorizimit për nxjerrjen e akteve nënligjore lidhur me rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit,
- Për procedurat e tyre të votimit,
- Për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit,
- Përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin,
- Për caktimin e organit kompetent,(për realizimin e këtij procesi)
- Parimeve në bazë të të cilave nxirren këto akte, si dhe afatin brenda të cilit ato duhet të nxirren.

Në kuadër të nxitjes së palëve dhe rritjes së ndërgjegjësimit për mundësimin e votës nga jashtë vendit, në muajin tetor të 2023 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Shqipëri zhvilloi konferencën me titullin “Votimi nga jashtë vendit – rruga përpara!”.

Kjo konferencë shërbeu si platformë diskutimi, duke mbledhur së bashku përfaqësues të Kuvendit, Komisioneve të Kuvendit (Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore dhe Komisionit të Ligjeve), Kuvendit, partive kryesore politike, institucioneve shtetërore, diasporës, partnerëve ndërkombëtarë si dhe ekspertë e aktorë të shoqërisë civile. Çështjet që u diskutuan lidheshin me adresimin e boshllëqeve ligjore të evidentuara në Vendimin Nr. 38, datë 09.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese, plotësimin e kuadrit ligjor dhe rolin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe palëve të tjera të interesuara, nëpërmjet propozimeve dhe ekspertizës së ofruar prej tyre, në mbështetjen e Kuvendit për adresimin e këtyre mangësive të konstatuara. Partitë politike premtuan angazhim për procesin, por ende hezitojnë për të shprehur në mënyrë të hapur qëndrimet e tyre politike.

Në këto kushte mbetet detyrimi i Kuvendit që përtej çdo diskutimi të bërë t’i japë zgjidhjen çështjes së votimit nga jashtë, për ushtrimin në mënyrë efektive të drejtës së votës për shqiptarët që jetojnë jashtë territorit të Shqipërisë.

Kreu 3: Procesi i dekriminalizimit

Përgjatë vitit 2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shqyrtoi rezultatet e verifikimeve të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2023, për kandidatët për deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë (2021-2025), për anëtarë në këshillin bashkiak (2023-2027) dhe për kryetar bashkie (2023-2027).

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2023, nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit janë dërguar 11 (njëmbëdhjetë) vendime për përfundimin e verifikimit të thelluar, për kandidatët për deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë 2021-2025.

Në lidhje me këto vendime të Prokurorisë së Përgjithshme pas verifikimit të thelluar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur si vijon:

- Për 4 (katër) kandidatë për deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, deklarimin e procedurës administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar, duke vlerësuar se ka humbur objekti dhe qëllimi i verifikimit të thelluar, për sa kohë, në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, këto subjekte nuk do të mund të përfitojnë mandatin e deputetit për legjislaturën 2021 - 2025;
- Për 7 (shtatë) kandidatë për deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, ka vendosur konstatimin se nuk përfshihen në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, ka kërkuar verifikim të thelluar për 44 (dyzetë e katër) kandidatë, nga të cilët 11 (njëmbëdhjetë) kandidatë për kryetar bashkie dhe 33 (tridhjetë e tre) kandidatë për anëtarë këshilli bashkiak për shkak të deklarimit të të dhënave për dënim në territorin e një shteti të huaj, si dhe indicieve të bëra prezente për vepra të tjera të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të parashikuara si ndalime në nenin 2, të ligjit nr. 138/2015.

Nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit janë dërguar 11 (njëmbëdhjetë) vendime për përfundimin e verifikimit të thelluar, për kandidatët për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023 dhe 5 (pesë) vendime për mospranim të kërkesës për verifikim të thelluar.

Në lidhje me këto vendime të Prokurorisë së Përgjithshme pas verifikimit të thelluar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur si vijon:

- Për 3 (tre) kandidatë, ka vendosur deklarimin e procedurës administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar, duke vlerësuar se ka humbur objekti dhe qëllimi i verifikimit të thelluar, për sa kohë, në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, këto subjekte nuk do të mund të përfitojnë mandatin e anëtarit për këshillin bashkiak për legjislaturën 2023 - 2027;

- Për 1 (një) kandidat për anëtarë në këshillin bashkiak, ka vendosur konstatimin se përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të këshilltarit.
- Për 4 (katër) kandidatë, ka vendosur konstatimin se nuk përfshihen në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik për legjislaturën 2023-2027;
- 3 (tre) kandidatë, janë ende në proces vlerësimi nga KQZ.

a. Plotësimi i vakancave të krijuara në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të krijuara gjatë vitit 2023

Për plotësimin e vakancave të njoftuara nga Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim, në zbatim të Nenit 164 të Kodit Zgjedhor. Ky nen përcakton, se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës, në listën shumëemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Gjatë vitit 2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë 7 (shtatë) zëvendësime vakancash të njoftuara nga Kuvendi i Shqipërisë, për shkak të ndërprerjes së mandatit të deputetëve, 3 (tre) prej tyre i përkasin subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë dhe 4 (katër) i përkasin subjektit politik Koalicioni PD-AN, si dhe 2 (dy) vendime mos zgjedhshmërie:

- Vendimi nr. 46, datë 10. 02. 2023, “Për dhënien e mandatit të deputetit z. Gëzim Nuri Ademaj, kandidat i listës shumëemërore të Koalicionit Partia Demokratike -Aleanca për Ndryshim, Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet (PDIU), qarku Vlorë.
- Vendim nr. 347 datë 13.04.2023 “Për dhënien e mandatit të Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëemërore të “Partia Socialiste e Shqipërisë”, qarku Elbasan, z. Shkëlqim Bullari”.
- Vendim nr. 348 datë 13.04.2023 “Për dhënien e mandatit të Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëemërore të “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, qarku Tiranë, z. Asllan Dogjani”.
- Vendim nr. 349 datë 13.04.2023 “Për dhënien e mandatit të Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëemërore të “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, qarku Shkodër, z. Lodovik Hasani”.
- Vendim nr. 350 datë 13.04.2023 “Për dhënien e mandatit të Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëemërore të “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, Partia Republikane Shqiptare (PR), z. Qani Hoxha”.
- Vendim nr. 431, datë 03.05.2023 “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër z. Frrok Gjini Gjini”.
- Vendim nr. 693, datë 12.7.2023 “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumëemërore të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, Qarku Durrës, z. Arkend Bashkim Balla”.

- Vendim nr. 316, datë 12.4.2023 “Për shpalljen e moszgjedhshmërisë të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Shkodër, z.Illir Hamit Beqaj, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë”.
- Vendim nr. 317, datë 12.4.2023 “Për shpalljen e mos zgjedhshmërisë të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, Qarku Shkodër, z. Bardh Ali Spahia, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë”.

b. Plotësimi i vakancave të kandidatëve për anëtar në këshillat bashkiakë, të krijuara gjatë vitit 2023

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve gjatë vitit 2023 janë paraqitur për plotësim 72 (shtatëdhjet e dy) vakanca pas njoftimit të këshillave bashkiak, nga të cilat 49 (dyzetë e nëntë) janë të gjinisë femërore dhe 23 (njëzet e tre) janë të gjinisë mashkullore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për 63 (gjashtëdhjet e tre) vakanca është shprehur me vendimarrje për plotësimin e vakancës në ushtrimin e funksionit në këshill bashkiak gjatë vitit 2023, për arsye se të dhënat nuk përfshiheshin brenda sferës së ndalimeve/brenda periudhës së ndalimit;

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për 9 (nëntë) vakancat e mbartura është shprehur me vendimarrje gjatë vitit 2024.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin nr.17/2016 të Kuvendit, ka kërkuar informacion për të gjithë kandidatët për Këshillat Bashkiak nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, përkatësisht për historinë e ndryshimit të gjenealiteteve dhe për gjendjen gjyqësore të tyre. Nga verifikimi i dokumentacionit për 72 (shtatëdhjet e dy) kandidatë (formularit të vetëdeklarimit, vërtetimit të gjendjes gjyqësore dhe të gjendjes civile), rezultoi se:

- 40 (dyzet) kandidatë për anëtarë në Këshillat Bashkiak, kanë deklaruar/rezultuar në formularin e vetëdeklarimit ndryshime në gjeneralitete;
- 2 (dy) kandidatë për anëtarë në Këshillat Bashkiak, kanë deklaruar dënime/dëbime në formularin e vetëdeklarimit.
- 70 (shtatëdhjetë) prej kandidatëve për anëtarë në Këshillat Bashkiak, nuk kishin të deklaruar asnjë të dhënë që përfshihet në kushtet e nenit 2, pika 1 dhe 2 të ligjit nr.138/2017, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për ndalimin e kandidimit.
- 2 (dy) prej kandidatëve për anëtarë kanë qënë në papajtueshmëri me funksionin, nga të cilat 1 (një) i përket gjinisë femërore dhe 1 (një) i përket gjinisë mashkullore.

Përgjatë procesit të zëvendësimit të vakancave të mësipërme 58 (pesëdhjetë e tetë) kandidatë për anëtar në këshillat bashkiak kanë refuzuar dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit.

Gjithashtu rezulton se nga plotësimi i vakancave të krijuara në këshillat bashkiak gjatë vitit 2023, aktualisht kanë shteruar listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtar:

Listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të Partisë Socialiste në Bashkinë Skrapar, Lushnjë, Kavajë.

Kreu 5: Analiza paszgjedhore

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Shqipëri zhvilloi aktivitetin dy ditor me tematikë “Analiza e zgjedhjeve të organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” në datat 14-15.12.2023, në Hotel Vlora International, me pjesëmarrjen e kreut të Departamentit të Dekriminalizimit/ Prezenca e OSBE në Shqipëri, zv/ Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të Kosovës, përfaqësues të trupave zgjedhore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Kosovë, përfaqësues të Policisë së Shtetit, përfaqësues të Ambasadës Britanike dhe Zvicriane, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe organizata ndërkombëtare si dhe përfaqësues të medias.

Analiza u bazua në prezantimet e çdo drejtorie mbi përmbushjen e detyrave dhe arritjen e objektivave, si dhe identifikimin e problematikave të konstatuara gjatë zhvillimit të procesit zgjedhor. Diskutimet gjatë analizës u bazuan mbi sfidat dhe risitë me të cilat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u përball gjatë administrimit zgjedhor.

Kjo analizë paszgjedhore kishte si qëllim vlerësimin e përgjithshëm mbi administrimin e procesit zgjedhor të zgjedhjeve të 14 majit 2023, si dhe përmirësimin e problematikave të evidentuara. Në këtë tryezë u diskutua edhe mbi aspektet dhe çështje të ndryshme lidhur me organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor.

Kreu 6: Planifikimi, Prokurim, Monitorimi i buxhetit të institucionit

Programi “Planifikim Menaxhim Administrim”

I. Planifikimi

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në datën 1 maj 2022, dërgoi dokumentin e fazës së parë (strategjike) të kërkesave për Buxhetin Afatmesëm, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Këshilli i Ministrave në muajin qershor 2022 miratoi projektbuxhetin afatmesëm dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve. Pas këtij miratimi në korrik 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë u dërgoi të gjithave institucioneve udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit.

Të gjitha drejtoritë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përgatitën dhe dërguan kërkesat buxhetore, brenda afateve të përcaktuara në legjislacion.

Në datën 1 shtator 2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dërgoi dokumentin e fazës së dytë (teknike) të kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Buxheti vjetor u miratua nga Kuvendi në datë 15 dhjetor 2022. Fondet në ligjin e buxhetit nr. 84/2022 për KQZ në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim u miratuan në shumën 284,750,000 lekë, sipas zërave:

- Shpenzime korrente 263,250,000 lekë
- Shpenzime kapitale me financim të brendshëm 21,500,000 lekë
- Shpenzime kapitale me financim të huaj 95,000,000 lekë

Programi “Planifikim, Menaxhim, Administrim” siguron mbështetjen financiare, me qëllim realizimin e objektivave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Buxheti i rishikuar i KQZ-së për shpenzimet korrente dhe kapitale me financim të brendshëm në 31 dhjetor 2023, në tabelë paraqitet:

“Planifikim, Menaxhim, Administrim”		Buxheti 2023
	Shpenzime Korente - Paga, Mallra, Shërbime	263,250,000
	Shpenzime Kapitale - Investime 01	21,500,000
	Totali i Buxhetit të Programit 01610	284,750,000

Struktura e shpenzimeve u miratua si në tabelën e mëposhtme:

Shpenzimet e programit 01610	Totali	Struktura në %
Paga dhe Sigurime Shoqërore	151,500,000	53
Mallra dhe Shërbime të Tjera/ transferta të huaja	43,760,000	15
Transferta për Buxhete Familjare & Individë	67,990,000	24
Investime	21,500,000	8
Totali i Buxhetit të Programit 01610	284,750,000	100

II. Zbatimi dhe monitorimi i buxhetit vjetor për vitin 2023

Realizimi i fondeve buxhetore për programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim” për vitin 2023 paraqitet si në tabelë.

Veprimtaria administrative e institucionit 01610	Buxheti 2023	Realizuar	Realizimi në %	
Shpenzime Korente - Paga, Mallra, Shërbime		263,250,000	242,587,508	92
Shpenzime Kapitale - Investime		21,500,000	18,685,760	87
Totali i Buxhetit të Programit 01610		284,750,000	261,273,268	92

Sipas natyrës së shpenzimeve, realizimi i fondeve buxhetore paraqitet:

- shpenzimet korrente janë realizuar në masën 92 % e planit të parashikuar për vitin 2023.
- Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në masën 87 % e planit të parashikuar për vitin 2023.
- Total buxheti është realizuar në masën 92 % e planit të parashikuar për vitin 2023.

Analiza sipas zërave të miratuar të buxhetit 2023 për programin 01610:

Veprimtaria administrative e institucionit 01	Buxheti 2023	Realizuar	Realizimi në %
Paga, Sigurime Shoqërore	151,500,000	149,602,700	99
Mallra dhe Shërbime të Tjera	43,460,000	25,241,621	58
Transferta Korente të Huaja	300,000	0	0
Trans per Buxh. Fam. & Individ	67,990,000	67,743,187	100
Shpenzime Kapitale - Investime financim i brendshëm	21,500,000	18,685,760	87
Totali i Buxhetit të Programit 01610	284,750,000	261,273,268	92

A. Shpenzimet korrente

Struktura e shpenzimeve korrente në programin “Planifikim, menaxhim, administrim” është e përbërë:

- 1) Paga, Sigurime Shoqërore
- 2) Mallra dhe Shërbime të Tjera
- 3) Transferta Korente të Huaja
- 4) Trans per Buxh. Fam. & Individ

Veprimtaria administrative e institucionit 01	Buxheti 2023	Realizuar	Realizimi në %
Paga, Sigurime Shoqërore	151,500,000	149,602,700	99
Mallra dhe Shërbime të Tjera	43,460,000	25,241,621	58
Transferta Korente të Huaja	300,000	0	0
Trans për Buxh. Fam. & Individ	67,990,000	67,743,187	100
Totali i Buxhetit për shpenzime korrente të Programit 01610	263,250,000	242,587,508	92

1) Shpenzime për paga

Shpenzime personeli përfshin pagat dhe sigurimet shoqërore referuar organigramës dhe nivelit të pagave të miratuara dhe organikës prej 95 punonjës të aparatit të KQZ-së, për rritjen e performancës së administratës, në funksion të realizimit të objektivave të institucionit, në zbatim të kërkesave ligjore, si dhe krijimin e kushteve optimale në këtë institucion. Paga dhe sigurime shoqërore planifikuar në shumën 151.5 milion lekë, dhe janë realizuar 149.6 milion lekë ose 99 % e fondeve të planifikuara në këtë zë.

2) Shpenzime për mallra

Mallra dhe shërbime janë planifikuar 43.5 milion lekë dhe janë realizuar 25.2 milion lekë ose 58% e fondeve të planifikuara për këtë zë.

Mallra janë planifikuar në shumën 7.2 milion lekë dhe janë realizuar në shumën 7 milion lekë ose 97 % e fondeve të planifikuara në këtë zë dhe sipas % paraqiten:

- (a) 42 % Naftë/ benzinë ose 3 milion lekë
- (b) 37% Kuti Amballazhi për kancelaritë ose 2.7 milion lekë
- (c) 16 % Materiale për funksionim të përgjithshëm/ kancelari, materiale pastrimi ose në shumën 1.1 milion lekë.
- (d) 5 % Shpenzime të ndryshme operative ose 370 mijë lekë.

3) Shpenzime për shërbime

Shërbime për institucionin e KQZ-së, në këtë zë janë planifikuar 36.3 milion lekë dhe është realizuar në masën 58% ose 18.2 milion lekë dhe sipas % paraqiten:

- (a) 29% Shërbime për mirëmbajtje & siguri, për magazinat në Lundër dhe godinën e institucionit të KQZ-së, ose 10.4 milion lekë.

- (b) 21% Shërbime artgrafike dhe videografike (Video me grafika për edukimin, informimin dhe sensibilizimin e zgjedhësve në periudhë zgjedhore dhe jo zgjedhore) etj, ose në shumën 7.5 milion lekë.
- (c) 19% Shërbime udhetime jashtë vendit, vizita studimore, bileta ose në shumën 6.7 milion lekë.
- (d) 12% Shërbime të teknologjisë së informacionit, zhvillim/personalizim platformë e-learning, mirëmbajtje e faqes zyrtare të KQZ-së në WEB kqz.gov.al etj, ose 4.5 milion lekë.
- (e) 10% Shërbime të funksionimit të përgjithshëm, energji, ujë, taksa ose 3.7 milion lekë.

4) Shpenzime për transferta korente të huaja

Transferta Korente të Huaja përfshin kuotën e anëtarësimit vjetor pranë AËEB - Shoqata Botërore e Trupave të Menaxhimit të Zgjedhjeve e cila është planifikuar 300 mijë lekë dhe konkretisht nuk është realizuar për arsye të ndryshimit të kuotizacionit nga organizatorët por edhe të ndryshimit të formës së riorganizimit të kësaj organizate.

5) Shpenzime transferta për buxhete familjare & individë

Transferta për Buxhete Familjare & Individë është zëri i shpenzimeve nga i cili bëhet pagesa për shpërbimin e anëtarëve të Komisionit Rregullator, Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve. Llogaritja e fondeve është bërë në përputhje me parashikimin e nenit 12 të Kodit Zgjedhor të RSH. Këtu janë planifikuar 68 milion lekë dhe janë realizuar 68 milion lekë ose 100% % e fondeve të planifikuara në këtë zë.

B. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj investime

- I. Investime me financim të brendshëm në shumën 21.5 milion lekë
- II. Investime me financim të huaj në shumën 95 milion lekë

1) Realizimi i investimeve me financim të brendshëm në këtë program 01610 është 18.7 milion lekë ose në masën 87%, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023 në shumën 21.5 milion lekë.

Veprimtaria administrative e institucionit 01	Buxheti 2023	Realizuar	Realizimi në %
Shpenzime Kapitale - Investime financim i brendshëm 01	21,500,000	18,865,760	87
Totali i Buxhetit të Programit 01610	21,500,000	18,865,760	87

Në mënyrë të detajuar projektet e investimeve paraqiten sipas shumës dhe % që zënë ndaj totalit të investimeve me financim të brendshëm 2023:

- a) 70 % Paisje informatike dhe zyre ose në shumën 15 milion lekë realizuar 91.3 %
 - b) 30 % Blerje Mjete transporti ose 6.5 milion lekë dhe pritet të realizohet 77 %
- 2) Realizimi i investimeve me financim të huaj në këtë program 01610 është 86.4 milion lekë ose në masën 91 %, (Diferencë për shkak të kursit të këmbimit) kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023 në shumën 95 milion lekë.

Në mënyrë të detajuar projektet e investimeve paraqiten sipas shumës dhe % që zënë ndaj totalit të investimeve me financim të huaj 2023:

Veprimtaria administrative e institucionit 02	Buxheti 2023	Realizuar	Realizimi në %
Shpenzime Kapitale - Investime financim i huaj 02 “Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar; mbështetje e KQZ-së” GRANT	95,000,000	86,400,000	91
Totali i Buxhetit të Programit 01610	95,000,000	86,400,000	91

Kreu 7 : Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Aktivitetet

Bashkëpunimi i vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtar dhe vendas është thelbësor për të siguruar një proces zgjedhor të besueshëm dhe të suksesshëm.

Më 15 mars 2023 me mbështetjen e OSBE-së, u zhvillua Takimi i Grupit Ndërkombëtar të Punës për Zgjedhjet (EËG), duke shprehur rëndësinë e këtij takimi si dhe mbështetjen që japin vendet e tjera, pjesë e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim, për procesin zgjedhor. Përgjatë këtij takimi u prezantuan nevojat, për të cilat KQZ kërkon mbështetje nga partnerët ndërkombëtarë.

Takime të tilla të organizuara nga OSBE me ambasadorët e shteteve pjesëmarrëse dhe të organizatave ndërkombëtare në Shqipëri synojnë në shkëmbimin e informacionit dhe për të bashkërenduar ndihmën dhe qëndrimet për zgjedhjet.

OSBE ka mbështetur KQZ në aktivitete të mundshme që përfshijnë nismat për votimin e diasporës dhe analizën e thelluar të administrimit të zgjedhjeve.

KQZ-ja në bashkëpunim me Qeverinë Britanike realizoi implementimin e projektit, i cili shtrihet në të gjithë Shqipërinë mbi rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimit të Komunitetit Rom për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Në kuadër të projektit janë zhvilluar takime sensibilizimi të KQZ-së së bashku me përfaqësues të Qeverisë Britanike dhe në bashkëpunim me dy organizatat jofitimprurëse IRCA dhe Voice of Roma për Edukimin, Informimin dhe Ndërgjegjësimin e Komunitetit Rom, rreth zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023.

Me nënshkrimin e marrëveshjes me qeverinë zvicerane në datën **24 mars 2023** nisi një projekt shumë ambicioz që do të zhvillojë më tej transparencën dhe efektivitetin e KQZ-së përmes mjeteve digjitale. Projekti i cili do të zgjasë katër vite, synon të përmirësoj kapacitetet e Komisionit për të modernizuar disa shërbime dhe për të futur instrumente të reja digjitale dhe IT.

KQZ vlerëson bashkëpunimin me Këshillin e Evropës duke u ndalur në krijimin e Platformës Elektronike të Raportimit Financiar si një nga arritjet më të mëdha të këtij bashkëpunimi i cili synon të përmirësojë dhe të rrisë aksesin në informacion, transparencë, si edhe të përmirësojë cilësinë e të dhënave dhe përpunimit të tyre nga të gjithë përdoruesit e platformës.

Gjithashtu KiE ofroi dhe trajnime për menaxhimin dhe përdorimin sa më efikas të burimeve shtetërore.

International IDEA, në bashkëpunim me Qendrën për Shtetin e së Drejtës në Finlandë, po mbështesin KQZ-në, partitë politike dhe shoqërinë civile, duke paraqitur, modele të suksesshme dhe duke ofruar ekspertizë për digjitalizimin e raportimit dhe deklarimit të financimeve të partive politike. Këtij qëllimi i shërbeu dhe organizimi më 19.04.2023 i Tryezës së Konsultimit Ndërkombëtar mbi temën “Shfrytëzimi i potencialit të sistemeve të raportimit dhe deklarimit online të financimit të partive politike”.

KQZ me mbështetjen e International IDEA dhe Qendrës për Sundimin e Ligjit të Finlandës ka nisur dialogun e bashkëpunimit ndërinstitucional me trupat zgjedhore në rajon dhe agjencive të ndryshme në nivel vendas dhe rajonal, mbi zgjerimin e përdorimit të instrumenteve digjitale në zgjedhje. Tryeza Rajonale “Digjitalizimi i proceseve zgjedhore -Perspektiva mbi sigurinë kibernetike dhe koordinimi ndërinstitucional në të gjithë Ballkanin Perëndimor” u fokusuan tek votimi elektronik, siguria kibernetike, konfidencialiteti, integriteti dhe disponueshmëria e teknologjisë e të dhënave zgjedhore dhe tek fushata dezinformuese që tentojnë të minojnë besueshmërinë e zgjedhjeve.

Vëzhgimi i proceseve zgjedhore

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjatë vitit 2023, me ftesë të institucioneve homologe dhe me mbështetjen financiare të tyre, ka marrë pjesë në vëzhgimin e proceseve zgjedhore lokale, parlamentare dhe presidenciale në disa vende të rajonit.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, KQZ në Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 14 maj 2023, ftoi homologët e trupave zgjedhore, anëtarë të rajonit e me gjerë për të vëzhguar nga afër procesin zgjedhor dhe për të ndarë dhe shkëmbyer eksperiencat dhe praktikat më të mira zgjedhore për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve sipas standardeve të kërkuara.

- **03 mars 2023** – Vëzhgimi i zgjedhjeve parlamentare - Estoni

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mori pjesë në Programin Ndërkombëtar të Vizitorëve organizuar nga Zyra Shtetërore Zgjedhore në Estoni për ndjekjen e zgjedhjeve parlamentare të 2023.

Procesi i votimit u shoqërua me demonstrimin e proceseve në disa qendra votimi, si dhe me procedurën e numërimit të votave elektronike në parlamentin e Estonisë. Në këtë aktivitet ishin pjesëmarrës institucionet shtetërore, bashkitë, institucionet arsimore dhe shoqatat jofitimprurëse nga gjithë bota që ishin të interesuar mbi funksionimin e zgjedhjeve në Estoni dhe kryesisht mbi votimin elektronik.

- **29 prill 2023** – Vëzhgimi i zgjedhjeve në Gjeorgji

Përfaqësues të KQZ-së vëzhguan nga afër zgjedhjet e pjesshme parlamentare dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar bashkie, në 10 bashki të Republikës së Gjeorgjisë. Risi në këto zgjedhje ishte përdorimi për herë të parë masivisht i teknologjisë për identifikimin e votuesit si dhe numërimit elektronik.

Shqipëria ashtu si Gjeorgjia zbatoi për herë të parë në zgjedhjet parlamentare identifikimin elektronik në gjithë vendin dhe pilotoi votimin dhe numërimin elektronik në bashkinë Vorë.

- **17 shtator 2023** – Vëzhgimi i procesit zgjedhor në Armeni

Përfaqësues të KQZ morën pjesë në Zgjedhjet e Këshillit të Yerevanit në Armeni, së bashku me 25 delegacione të ndryshme nga trupa të administrimit zgjedhor dhe organizata ndërkombëtare të përfshira në zgjedhje. KQZ Shqipëri u angazhua plotësisht në hapjen e procesit zgjedhor në qendrat e votimit ku ndërmori vëzhgimin në mbi 10 qendra votimi në të gjithë Yerevanin dhe u kujdes për të regjistruar çdo hollësi të procesit zgjedhor, duke përfshirë procedurat e identifikimit të votuesve, organizimin e kutive të votimit dhe rregullat e sigurisë në qendrat e votimit.

- **5 nëntor, 2023** – Vëzhgimi i procesit zgjedhor në zgjedhjet e përgjithshme në Moldavi.

Përfaqësues të KQZ-së u ftuan për të marrë pjesë në vëzhgimin e procesit zgjedhor në zgjedhjet e përgjithshme të Moldavisë ku ndoqën nga afër aspekte të rëndësishme të procesit sic ishte procesi i regjistrimit, aftësia teknologjike e një procesi zgjedhor të lirë, të drejtë dhe transparent.

Aktivitete ndërkombëtare

Më poshtë, janë prezantuar veprimtaritë kryesore të KQZ-së të realizuara jashtë vendit që lidhen me shkëmbimin e përvojave dhe bashkëpunimin me organizatat e ndryshme ndërkombëtare. Në mënyrë të përmbledhur, po i paraqesim aktivitetet, si në vijim:

- **21.02.2023** - Workshop Rajonal – Varshavë, Poloni

KQZ mori pjesë në seminarin “Shoqëria civile dhe ndjekja e rekomandimeve zgjedhore” si pjesë e projektit “Mbështetje për Reformat Zgjedhore në Ballkanin Perëndimor”, organizuar nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) në Varshavë, Poloni. Seminari u fokusua në praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra nga përvoja e shoqërisë civile në promovimin dhe monitorimin e reformës zgjedhore, dhe në adresimin e sfidave të përsëritura dhe të reja duke shfrytëzuar mundësitë për të përmbushur më tej rolin e tyre si promovues të demokracisë.

- **16.06.2023** - Konferencë - Strasburg

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mori pjesë në konferencën e organizuar nga Këshilli i Evropës në temën "Votimi elektronik, përdorimi i teknologjive informuese dhe komunikuese (TIK) në zgjedhje". Delegacioni i KQZ diskutoi me pjesëmarrësit e konferencës çështje të rëndësishme si: eksperiencia shqiptare me projektet e votimit elektronik, përdorimi i praktikave të teknologjisë elektronike, mbikëqyrja, realizimi i reformës zgjedhore dhe projektet e tilla në mënyrë që të garantohet siguria, mbrojtja kibernetike dhe integriteti zgjedhor, si dhe përmbushja e principeve të ciklit zgjedhor.

- **06.07.2023** – Vizitë studimore në KQZ Shqipëri nga delegacioni i KQZ Gjeorgji

KQZ mikpritri në një vizitë studimore një delegacion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Gjeorgjisë të kryesuar nga Kryetari Giorgi Kalandarishvili në kuadër të Projektit të Këshillit të Evropës "Mbështetja e Transparencës, Përfshirjes dhe Integritetit të Praktikave dhe Proceseve Zgjedhore në Gjeorgji".

Gjatë vizitës tre ditore në mjediset e KQZ, delegacioni gjeorgjian u njoh me implementimin e sistemeve teknologjike në proceset zgjedhore në vend.

- **27.09.2023** - Tryezë teknike - Bosnjë – Hercegovinë

Në kuadër të projektit të ODIHR "Mbështetja për Reforma Zgjedhore në Ballkanin Perëndimor" u organizua një Tryezë Teknike në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së dhe KQZ Bosnjë Hercegovinë. Pjesëmarrësit diskutuan principet kyçe që rrjedhin nga angazhimet ndërkombëtare dhe praktikave të mira zgjedhore, dhe se si këto principe udhëhoqën punën e TMZ-ve dhe sigurojnë bazën për vlerësimin nga vëzhguesit e zgjedhjeve. U diskutua rreth aktiviteteve të administratës së zgjedhjeve, sfidave të reja dhe të përsëritura, zgjidhjeve inovative të adoptuara për të adresuar këto sfida. KQZ e Shqipërisë në këtë aktivitet mbajti një prezantim mbi përdorimin e teknologjisë në proceset zgjedhore në vend.

- **03.10.2023** - Program i trajnimit - Kore e Jugut

Programi i trajnimit mbi temën "Studimi i Rasteve të ndryshme të Legjislacionit Zgjedhor për Zgjedhje të Lira dhe të Drejta" përfshiu 5 delegacione të ndryshme nga trupa të administrimit zgjedhor. Agjenda u përqëndrua në prezantimet e raporteve, shkëmbimin e eksperiencave mes vendeve, vizitës në qendrën e numërimit të votave dhe vizitës në KOCEI- Instituti Korean i Edukimit Qytetar. Trajnimi u zhvillua në dy faza: Trajnimi synonte eksplorimin e praktikave më të mira duke thelluar bashkëpunimin midis dy vendeve në fushën e proceseve zgjedhore.

- **09.10.2023** - Vizitë Studimore - Finlandë

KQZ zhvilloi vizitën studimore në Helsinki, Finlandë në kuadër të projektit "Integriteti dhe Besimi në Zgjedhjet Shqiptare: Nxitja e Transparencës në Financimin Politik dhe Përdorimin e Sigurt të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit", e bashkë-implemtuar nga IDEA

Ndërkombëtare dhe Qendra e Ligjit e Finlandës." U realizua një vizitë në Departamentin e Demokracisë dhe Ligjit Publik të Ministrisë së Drejtësisë, e cila ishte një mundësi për të eksploruar funksionimin e sistemit zgjedhor finlandez. Momenti i rëndësishëm i vizitës ishte edhe takimi në Parlamentin Finlandez, pasi Delegacioni i KQZ-së u njoh me rolin e parlamentit në fushën e financimit të partive politike, monitorimit dhe raportimit të tyre.

- **26.10.2023** – Konferencë - Gjeorgji

Konferenca me temë "Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Zgjedhje" u zhvillua për të evidentuar aspektet e shumanshme të kësaj sfide dhe për të eksploruar strategji efektive për të kundërshtuar efektet e dëmshme të saj në integritetin dhe transparencën e sistemeve zgjedhore.

Kreu 8: Statistike për procedimet penale në kuadër të zgjedhjeve vendore të vitit 2023

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve u kërkoi Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Përgjithshme informacion te detajuar në lidhje me procedimet penale në kuadër të zgjedhjeve vendore të 14 Maj 2023.

Seksioni 1: Të dhënat e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (në vijim PKKKO).

Referuar informacionit të përcjellë nga PKKKO rezulton si vijon:

Për periudhën 1.1.2023 deri më 31.12.2023 janë regjistruar pranë PKKKO, 37 procedime penale për 12 persona nën hetim që lidhen me krimet zgjedhore në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore datë 14 Maj 2023.

Janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 5 procedime penale me 11 persona të pandehur për periudhën 1.1.2023 deri më 31.12.2023.

Më poshtë ju paraqesim në mënyrë të përmbledhur të dhënat për gjeneralitetet e personave dhe procesit aktual nga faza e hetimit deri në fazën e gjyqimit.

Institucioni	Procesi	Gjinia	Viti i lindjes	Arsimi	Gjendja Gjyqesore	Gjendja shoqerore	Total
Prokuroria e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar	<i>proses hetimi</i>	mashkull	1984	I mesëm	I padënuar	nuk ka të dhëna	
		mashkull	1971	I mesëm	I padënuar	nuk ka të dhëna	
		mashkull	1962	I mesëm	I padënuar	nuk ka të dhëna	
		mashkull	1972	I lartë	I padënuar	Nëpunës i nivelit të lartë	
		mashkull	1979	I mesëm	I padënuar	nuk ka të dhëna	
		mashkull	1992	I lartë	I padënuar	Nëpunës i nivelit të lartë	
		mashkull	1979	I mesëm	I padënuar	Nëpunës i nivelit të lartë	
		mashkull	1960	I mesëm	I padënuar	Nëpunës i nivelit të lartë	
		mashkull	1960	I lartë	I padënuar	nuk ka të dhëna	
		mashkull	1975	I mesëm	I padënuar	nuk ka të dhëna	
		mashkull	1982	I mesëm	I padënuar	nuk ka të dhëna	
		mashkull	1953	I mesëm	I padënuar	nuk ka të dhëna	
	<i>procedime penale</i>	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	37

Seksioni 2: Të dhënat e Prokurorisë së Përgjithshme (në vijim PP).

Referuar informacionin të përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme rezulton si vijon:

Nga verifikimet e PP-së, si dhe të dhënat e zyrës së statistikës në PP, rezulton se në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm, aktualisht janë nën hetim për vepra penale në fushën e zgjedhjeve 5 persona.

Nga 21 procedime penale që ndiqen nga prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm, për 7 prej tyre është kërkuar në gjykatë pushimi i hetimeve, prej tyre 3 kërkesa për pushimin e hetimeve, janë pranuar nga gjykata dhe për 4 kërkesat e tjera për pushim të hetimeve vazhdon shqyrtimi në gjykatë. 14 procedime penale janë akoma në fazën e hetimeve paraprake.

Kohëzgjatja e hetimeve të procedimeve penale të regjistruara për veprat penale në fushën e zgjedhjeve, të cilat kanë përfunduar, varion nga 3-6 muaj. Kurse procedimet penale në proces hetimi kanë kohëzgjatje mbi 9 muaj.

Nuk rezulton të ketë përfunduar me kërkesë për gjykim asnjë procedim penal.

Në lidhje me gjininë e personave nën hetim rezultojnë dy femra banuese në Konispol dhe 5 meshkuj banues në Cërrik me gjendje gjyqësore të padënuar të grup moshave 28-43 vjeç. Më poshtë ju paraqesim në mënyrë të përmbledhur të dhënat për gjenealitetet e personave dhe procesit aktual nga faza e hetimit deri në fazën e gjyqimit.

Prokuroria e Përgjithshme	<i>proses hetimi</i>	mashkull	28-43 vjeç	nuk ka te dhena	I padënuar	nuk ka të dhëna	5
		mashkull	28-43 vjeç	nuk ka te dhena	I padënuar		
		mashkull	28-43 vjeç	nuk ka te dhena	I padënuar		
		femër	28-43 vjeç	nuk ka te dhena	I padënuar		
		femër	28-43 vjeç	nuk ka te dhena	I padënuar		
	<i>procedime penale</i>	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	21
	<i>procedime penale ne fazen e hetimeve paraprake</i>	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	14

Seksioni 3: Zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e Bashkisë Kukës datë 24 Shator 2023.

Sipas informacionit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Prokurorisë së Përgjithshme në lidhje me zgjedhjet e pjesshme të mbajtura më datë 24 Shtator 2023 për Kryetar të Bashkisë Kukës nuk rezulton që të kenë asnjë procedim penal apo person nën hetim të regjistruar.

Pjesa V: REKOMANDIME

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i angazhuar në vijimësi për përmbushjen sa më optimale të misionit institucional dhe detyrimeve ligjore që Kodi Zgjedhor i ngarkon, me përgjegjshmëri ka analizuar ecurinë e çdo etape të procesit zgjedhor të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021 dhe zgjedhjeve të përgjithshme vendore të datës 14 maj 2023, duke fokusuar veçanërisht problematikat e dëshmuara, duke synuar arritjen e standardeve të pranura ndërkombëtarisht për procesin zgjedhor të ardhshëm.

Rekomandimet e paraqitura synojnë përmirësimin e aspekteve të ndryshme të organizimit dhe menaxhimit të zgjedhjeve, forcimin e rolit institucional të KQZ-së, me qasje rekomandime për përmirësim të mundshme të Kodit Zgjedhor në aspekte, të cilat shënjojnë standardet e procesit zgjedhor.

Rekomandime:

1. Mënyra/forma e organizimit dhe e funksionimit të komisioneve të qendrave të votimit (KQV) të komisioneve zonale të administrimit zgjedhor (KZAZ), si dhe e grupeve të numërimit (GN).

1.1. Administrimi i zgjedhjeve në nivelet e dyta dhe të treta nga administratorë zgjedhor të caktuar, apo të përzgjedhur vetë nga partitë politike, ka cenuar standardin teknik të përgatitjes dhe zhvillimit të proceseve zgjedhore, si dhe besimin në to. ODIHR, por edhe vëzhgues vendas kanë rekomanduar ndryshimin e përbërjes vetëm partiake të komisioneve zgjedhore në këto nivele. KQZ çmon se konsiderimi pozitiv i këtij rekomandimi duke zhveshur partitë, të paktën pjesërisht, nga e drejta absolute për të caktuar administratorët zgjedhorë në nivelet e dyta dhe të treta të administrimit, do të ndihmonte në krijimin e një trupe administratorësh profesionistë, të mirëtrajnuar dhe më integritet. Propozojmë që në këto komisione të ketë prezencë të partive politike por peshën kryesore ta kenë përfaqësuesit e emëruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në çdo rrethanë apo formë duhet të vendoset kusht për personat që do të angazhohen si komisioner duhet të jenë të trajnuar dhe të certifikuar. Procesi mund të administrohet tërësisht nga nëpunës civil, gjithsesi në çdo rast duhet të jetë kusht certifikimi tyre.

2. Sjellja dhe veprimet e institucioneve politike dhe zyrtarëve në fushatë

2.1. Sjellja dhe veprimet e institucioneve politike dhe zyrtarëve të tillë në fushatë, sikurse vlerësohet edhe në raportet e vëzhguesve, janë me ndikim në procesin zgjedhor. Në përputhje me gjetjet dhe rekomandimet e këtyre raporteve KQZ çmon se ka nevojë për përmirësime në kuadrin ligjor zgjedhor aktual në lidhje me këtë aspekt, duke :

- a. Përkufizuar qartë dallimin midis një veprimtarie publike institucionale nga ajo zgjedhore;
- b. Përcaktuar kategoritë e veprimeve, apo akteve që institucioneve publike u ndalohen respektivisht të kryejnë dhe të miratojnë gjatë periudhës parazgjedhore dhe/ose zgjedhore;
- c. Përcaktuar qartë periudhën e ndalimeve etj.;
- d. Përcaktuar kategoritë e funksionarëve publik për të cilët mund të ketë ndalime në zhvillim, apo pjesëmarrjen në veprimtari publike të caktuara.

3. Rregullat për financimin e fushatës zgjedhore

3.1. Standardi i zgjedhjeve është i lidhur drejtpërsëdrejti me rregullat për fushatën zgjedhore dhe financimin e tyre.

Në përputhje me gjetjen dhe rekomandimet e raporteve të vëzhguesve të zgjedhjeve, atyre të ODIHR dhe vendas, KQZ sjell në vëmendjen tuaj se duhet të përmirësohen rregullat aktualë të financimit të fushatave zgjedhore dhe të partive politike, si dhe të miratohen rregulla në lidhje me:

- a. Zhvillimin e fushatës në median online;
- b. Zhvillimin e fushatës në internet dhe në rrjete sociale;
- c. Të ashtuquajturin “Financimi i palëve të treta” dhe zhvillimin e fushatës nga këto subjekte;

3.2. Partitë politike që nuk janë regjistruar në 2 zgjedhjet e fundit dhe që nuk janë financuar nga buxheti i shtetit nuk duhet ti nënshtrohen auditimit. Në shumicën e rasteve partive politike nuk i dihet adresa. Ndërkohë që KQZ angazhon burime njerëzore dhe financiare për auditimin e tyre.

3.3. Partitë që në 3 zgjedhjet e fundit që nuk kanë marrë asnjë mandat duhet të paraqesin listë mbështetësish. Ndërkohë KQZ angazhohet për të kryer procedurat e përcaktuara në ligj për regjistrimin e tyre. Propozohet që nënshkrimet të paraqesin që në momentin që ata paraqesin kërkesën e tyre për regjistrim në zgjedhje.

3.4. Neni 23/1, pika 2, e ligjit “Për partitë politike” bie në kundërshtim me vetë Kodin Zgjedhor, duke parashikuar detyrimin për të bërë publike dhurimin minimal në vlerën 100.000 lekë, ndërkohë që Kodi, në nenin 92/1, pika 5, përcakton të njëjtin detyrim për vlerat e barabarta dhe më të larta se 50.000 lekë.

3.5. Sanksionet e parashikuara në nenin 23/4 të ligjit “Për partitë politike” nuk ruajnë të njëjtën vlerë me atë që parashikon neni 173 i Kodit Zgjedhor.

3.6. Përmirësimi dhe rishikimi i pjesës së XIII të Kodit Zgjedhor “Përgjegjësitë dhe Sanksionet”. Sanksionet janë joproporcionale në raport me shkeljen. Ka shkelje të rënda ndërkohë që Kodi nuk parashikon sanksion administrativ ose sanksioni i parashikuar është i papërfillshëm.

4. Ndryshime në Kodin Zgjedhor.

4.1. Zbatimi në praktikë i disa dispozitave të Kodit Zgjedhor, si dhe në tërësi përgatitja dhe administrimi i proceseve zgjedhore kane treguar se është e nevojshme të rikonsiderohen rregullat mbi:

- a. Ushtrimin e të drejtës së votës për një kategori personash me aftësi të kufizuara, veçanërisht për ata të cilët nuk kanë mundësi të shkojnë në qendrën e votimit;
- b. Përgatitjen e listës së zgjedhësve, si dhe organizimin e qendrave të votimit;
- c. Kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të një partie politike si subjekt zgjedhor;

- d. Porcedurat, kushtet dhe afatet e regjistrimit të kandidatëve për organet e qeverisjes vendore dhe atyre për Kuvendin;
- e. Kushtet për ndalimin për të kandiduar dhe për t'u zgjedhur;
- f. Pasqyrimin e fushatës në radio dhe televizione, publik dhe privat;
- g. Procedurat dhe afatet e numërimit të votave dhe të nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve;
- h. Procedura dhe afati për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvend dhe për organet e qeverisjes vendore;
- i. Procedura, afatet dhe organi, apo organet kompetente të shqyrtimit të ankimeve zgjedhore;
- j. Procedura dhe afati për regjistrimin e vëzhguesve partiak dhe atyre jopartiak;
- k. Të drejtat e vëzhguesve partiakë dhe atyre jopartiak;
- l. Financimin e procesit zgjedhor.